

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28, 29 DHE 30 KORRIK 2004

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 28, 29. I 30. JULA 2004. GODINE

—
GUSHT - AVGUST
2004

T R A N S K R I P T
NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28, 29 DHE 30 KORRIK 2004

Seanca Plenare u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 9,00.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe ju dëshiroj mirëseardhje oficiele në Seancën plenare. Shpresoj se pasqyra televizive, do të jetë vërejtja më e madhe për seriozitetin e deputetëve dhe atyre që i zgjedhin deputetët për punën që duhet ta bëjnë. Mirëseardhje edhe ministrave, të cilët janë në të njëjtën kohë edhe deputetë.

Të gjitha materialet ju janë shpërndarë me kohë dhe besoj se me kohë i keni marrë.

Prandaj, pa humbur kohë, fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

Pika e parë është – Miratimi i Procesverbalit të Seancës së mëparshme.

Kam edhe sygjërim se ka propozim për ndryshim të rendit të ditës. Këtë e sygjeron Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Urdhëroni, zoti Bajrush.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Të Falemnderit zoti kryetar. Ju përshëndes të gjithëve. Mendoj se duhet dhënë një përgjigje shkresës së Qeverisë lidhur me pikën 10 – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e investimeve në Kosovë. Për Inisiativën e deputetit Bedri Selmani, për të cilën inisiativë jam edhe unë si deputet, meqë na ka ardhur kjo shkresë, mendoj se si Qeveri, kërkon një përgjigje.

Mendimi është, për hirë edhe të bashkëpunimit me Qeverinë, meqë ka ardhur kjo shkresë – ku thuhet se është në procedurë në Qeveri edhe një Projektligj i hartuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, mendoj se do t'ishte e rrugës që sponsorizuesi i Projektligjit me sponsorizuesin e Projektligjit të Ministrisë dhe Industrisë – të merren vesh dhe të harmonizojnë qëndrimet deri në seancën e ardhshme dhe të procedojmë ashtu siç na e merr mendja më së miri.

Ky është një propozim dhe s'do të thotë ta pranojmë, por mendoj se e ndiej veten më mirë kështu të jetë, në këtë formë, meqë edhe unë jam në këtë listë të inisiativës. Ju falemnderit.

KRYTARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën profesor Alush Gashi. Urdhëroni.

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mendon se kjo çështje duhet të përgatitet më mirë dhe e pranon sygjerimin e Qeverisë së Kosovës, prandaj ju lus – në emër të Grupit – që nga Seanca e sotme këtë ta tërheqni nga rendi i ditës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë mendoj se kemi arsye të mjaftueshme, sepse janë nga dy grupet më të mëdha parlamentare. Me këtë, do të thotë, heqet pika e rendit të ditës deri sa të harmonizohen qëndrimet dhe të shqyrtohet në seancën e ardhshme.

Bashkë me këtë dua t'ju propozoj se kanë ardhur dhe janë shpërndarë vendimet e panelit të veçantë lidhur me Ligjin për shëndetësi dhe Ligjin kundër diskriminimit.

Prandaj, lidhur me këtë, ju lus – nëse keni mirëkuptim – t'i radhisim në rend të ditës dhe atë në pika të fundit, ose – nëse keni mendim tjetër, grupet parlamentare mund të deklarohen.

Do të thotë pranohet propozimi që të vendosen në rend të ditës dhe kur të vijnë në rend i procedojmë. Ju falemnderit shumë.

E tani shkojmë në shqyrtimin e parë – Miratimi i Procesverbalit nga Seanca e kaluar. Ta zbatojmë ecurinë e rëndomt, ata që kanë vërejtje në Procesverbal, t'i dorëzojnë vërejtjet me shkrim.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës – Shqyrtimi i Rekomandimit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese lidhur me procedimin e amendamenteve në Kornizën kushtetuese.

Para se t'ia jap fjalën profesor Sejdiut, pasi kryetari i Komisionit nuk është këtu, më lejoni t'ju them se vendimi i Seancës së fundit ishte që të kërkohet nga ky Komision që amendamentet, të cilat nuk ishin të harmonizuara, tre amendamente apo katër, sa ishin dhe të bën tentim dhe kryejnë e finalizojnë edhe atë pjesë. Komisioni disa herë ka mbajtur mbledhje dhe në Kryesi është paraqitur një rekomandim. Lidhur me këtë lus profesor Fatmir Sejdiun, që në emër të Komisionit ta paraqesë mendimin.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë dhe ministra,

Vërejtjet që u shtruan janë të tilla, domethënë të qëndrueshme. Komisioni dhe Grupi punues kanë bërë një përpjekje që të vazhdojnë me harmonizimin e atyre amendamenteve sipas rekomandimit edhe të vetë Kuvendit. Ne jemi në proces e sipër, mirëpo ky rekomandim që është dhënë nga Grupi punues dhe Komisioni për legjislacion janë të mendimit se amendamentet e miratuara i konsiderojnë si të përfunduara dhe të procedohet për këtë më tej. Pjesa e mbetur do të jetë pjesë që do bëhet në procesin e ardhshëm dhe një fazë të ardhshme të prezentohen para Kuvendit. Me fjalë tjera, të procedohet më tej si punë e kryer. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Dëgjuam informatën dhe do të procedojmë pikërisht ashtu siç ka rekomanduar Komisioni funksional. Mendoj se të gjithë pajtohemi që të procedojmë në këtë mënyrë. Ju falemnderit.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Në rend dite është: – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për detyrimet.

Urdhëroni Gani. Gani Sadik, e ka fjalën lidhur me pikën e kaluar, më parë të shqyrtuar. Më fal Gani, nuk ju vëreja se e kërkuat fjalën.

GANI SADIK:

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,
Fjalën time e bëra në gjuhën turke dhe në momentin e fundit e dhash në përkthim. Domethënë këtë pjesë do ta lexoj në gjuhën shqipe dhe kërkoj falje nëse gjatë leximit bëj gabime.

Dola në foltore sepse ndiej një obligim moral dhe t'i sqaroj disa gjëra nga mbledhja e kaluar, kur u krijua përshtypja se ne – Grupi i bashkësive të tjera etnike jemi kundër ndryshimeve kushtetuese. Jo. Edhe një herë, po them se ne i përkrahim dhe i votuam ato, dhe në asnjë mënyrë nuk dojmë të ndahemi prej shqiptarëve dhe prej krejt popullit të Kosovës. Kam thënë shumëherë se Kosova është atdheu ynë dhe këtë e kam thënë edhe para zotit Grosman, Hollkeri dhe në të gjitha takimet me ndërkombëtarët.

Zotri kryetar, në mbledhjen e fundit ju e morët fajin. Jo zotri kryetar, për ju nuk ishte faji, sepse e rrespektuat fjalën qysh u morëm vesh para mbledhjes dhe nuk u ndryshua asgjë që prek të drejtat e bashkësive tjera etnike. Por, kryetari i Partisë sime, Mahir Jakxhillar doli jashtë sallës dhe na detyroi edhe ne të dalim.

Gjatë bisedës me ju, dhe me Grupin punues, vërtetuam edhe një herë se amendamentet që prekin të drejtat tona, nuk do të ndryshohen - dhe sikur thatë – nëse nuk mundemi me ua përmirësuar pozitën, kurrsesi nuk do t'ua keqësojmë.

Zotri kryetar, të nderuar deputetë,
Mendoj se tash kam sqaruar gjërat, dhe për ndryshimet kushtetuese do të janë edhe votat tona, sepse edhe ne dojmë që Kosova të jetë shtet i pavarur, e lirë – se kjo është në interes të të gjithë popujve dhe në interes edhe të Evropës.

Zotri kryetar, tash po ju drejtohem juve. Për mrekulli jeni duke udhëhequr Parlamentin e Kosovës. Jeni guximtar. Jeni trim. Unë jam adhures i juaj. Ju dëshiroj punë të mbar, shëndet të mirë. Ju dëshiroj fat. Përshëndetje nga komuniteti turk i Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë zoti shef i Grupit Parlamentar. Unë mendoj se është një prononcim me vlerë, veçanërisht pjesa e parë. Për të dytën, ju falënderohem personalisht, por është ajo pjesa e parë shumë e vlershme dhe kjo pikërisht është rrugë që duhet ta ndjekim të gjithë ne në Kosovë. Edhe njëherë ju falënderoj.

Vazhdojmë me rend dite. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për detyrimet.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 17 qershor 2004.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte e rekomandime si vijojnë:

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për detyrimet ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për detyrimet dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për detyrimet dhe amendamentet e propozuara, nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e deputetes Nerxhivane Dauti dhe të komisioneve parlamentare.

Kalojmë menjëherë në shqyrtimin e amendamenteve.

Amendamenti 1, deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon kush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, deputetja Dauti, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Njëzërit, miratohet amendamenti.

Amendamenti 10, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër?
Abstenime? Ju falemnderit.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.

Kush është për?
 A ka kundër? Nuk ka.
 Abstenime? Nuk ka.
 Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
 Kush është për?
 A ka kundër? Nuk ka.
 Abstenime? Nuk ka.
 Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, deputetja Dauti, me Komisionin funksional.
 Kush është për?
 A ka votë kundër?
 Abstenime?

Mendoj se kam fituar të drejtën praktike, dhe meqë të gjitha amendamentet janë të deputetës Dauti dhe të Komisionit funksional, e për to nuk ka patur asnjë kundër e as abstenime, ju pyes: a mund t'i votojmë të gjitha përnjëherë. Ju falemnderit.

E dij se monitorimi për këtë do t'na bëjë vërejtje, por megjithatë pyes:

Kush është për që të gjitha amendamentet e mbetura, pasi nuk ka vërejtje askush deri më tani, të miratohen. Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.
 A ka ndonjë abstenim? Nuk ka.

Do të thotë njëzërit, me shumicë absolute votash - aprovohen amendamentet.

Tani më lejoni t'ju pyes: kush është për aprovimin e ligjit me amendamentet e miratuara? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.
 A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.
 Konstatohet se u aprovua ligji, me amendamentet e miratuara.

(Duartrokitje)

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For	Të gjithë – Svi - All	
- Kundër – Protiv – Against.....		00
- Abstenime – Uzdržani – Abstained.....		00

Në radhë të rendit të ditës është: Shqyrtimi i amendamenteve në Projektligjin për trashigiminë.

Në vijim jipet lista e amendamenteve sipas renditjes së paraqitur në tekstin e Projektligjit për trashigiminë, të propozuara nga deputetët Nekibe Kelmendi dhe Mehdi Bardhi.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për trashigiminë ka bazueshmërinë juridike në kushtetutën kalimtare – të përkohshme.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për trashigiminë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë impliime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për trashigiminë dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet e propozuara në mënyrë specifike reflektojnë qëndrimin e deputetëve Nekibe Kelmendi dhe Mehdi Bardhi, si dhe të komisioneve parlamentare.

Amendamenti 1, Deputetja Nekibe Kelmendi, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Deputetja Kelmendi, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Para votimit, Hydajeti e kërkon fjalën. Urdhëro Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit zoti kryetar. Kam një vërejtje në këtë nen dhe edhe në ndonjë nen tjetër. Mendoj se është ndryshuar edhe thelbi shpesh edhe i përfshirë në titullin e nenit. Ky Projektligj ka titull të secilit nen. Dhe, për mua, është e kontestueshme sidomos formulimi që është propozuar t'i shtohet ligjit, tekstualisht, ku thuhet: “Mund të trashëgohet secili person fizik”. Vëni re, ju lutem! “Mund të trashëgohet secili person fizik”? Mund të trashëgohet trashëgimia e tij, pasuria e tij dhe jo vetëm pasuria por edhe trashigima, po jo vetë personi. Prandaj, do të ishte ndoshta mirë që vetë autori i amendamentit ta ketë parasysh këtë dhe të korrigjohet. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Çfarë mendimi ka Komisioni funksional dhe propozuesi, apo ndoshta sqarim mundet Nekibja me na dhënë?

NEKIBE KELMENDI:(Ndërprerje e shkurtër)

Unë megjithatë mendoj se nuk ndryshohet asgjë nga esenca, sepse vetëm personat fizik mund të trashëgohen, nuk mund të trashëgohet asnjë institucion shtetror, nuk mund të trashëgohet asnjë subjekt tjetër. Mund të ketë suksesor të subjekteve të tjera, kurse personat fizik mund të trashëgohen. Natyrisht, ata nuk mund të trashëgohen si persona, në kuptimin biologjik të fjalës, por mund të trashëgohet pasuria dhe të drejtat që ata i kanë pasë.

(Ndërhyerje - H. Hyseni: Trashigimia, të lutem!)KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit.

Kush është për amendamentin – Nekibe Kelmendi me përkrahje të Komisionit funksional, ju lutem. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Tre abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Deputetja Kelmendi, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Deputetja Kelmendi, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër?

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.
Hydajeti e dëshiron fjalën. Urdhëroni.

HYDAJET HYSENI:

Falemnderit. Kam përsëri një vërejtje, më shumë është çështje e formulimit, besoj është lëshuar rastësisht. Kërkohej që pas fjalës “gjyshi dhe gjyshja” të shtohet “dhe pasardhësit të tyre”. Në tekst është “dhe paraardhësit të tyre”. Mirëpo, kështu siç është propozuar mbetet pas “gjyshit dhe gjyshes dhe pasardhësit të tyre”. Prandaj do të duhej të kërkohej që ajo së paku të fshihet “paraardhësit” ose fjala “paraardhësit” të zëvendësohet me “pasardhësit”. Përndryshe, kështu ngatërrohet siç është në tekst. Do të kërkoja që autori ta korrigjojë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet të falemnderit. Nekibe?

NEKIBE KELMENDI:

Në nenin 11, paragrafi 1, pas fjalës “gjyshi dhe gjysja” në ligj është shkruar “dhe paraardhësit e tyre”. Mendoj se jam shumë e qartë kur kam thënë të shtohet përveç “paraardhësit” të shtohet edhe “pasardhësit e tyre”. Nuk kam propozuar të fshihet fjala “paraardhësit” por të plotësohet ky paragraf me “dhe pasardhësit e tyre”.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Regjia, ju lus ta aktivizoni mikrofonin e Hydajetit.

HYDAJET HYSENI:

Falemnderit, por mendoj se dy çështje shtrohen me këtë rast. Një, kështu siç propozohet, nuk ka asnjë kuptim, sepse trashëgimia s’mund të ketë bëjë me paraardhësin dhe me pasardhësin, sepse ngatërrohet tërësisht. Dhe, e dyta – në tekstin anglisht dhe në gjuhën serbe nuk është fare “paraardhësit”. Do të thotë është një gabim teknik. Në vend të “pasardhësit” është shënuar “paraardhësit” dhe kjo duhet të zëvendësohet, dhe s’mund të jenë të dyjat. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Kjo tregon se ne nuk mund t’na akuzojë kërkues se jemi vetiak. E shihni – deputetja Kelmendi dhe anëtari i Kryesisë Hyseni nuk flasin për tekstin në gjuhën shqipe, por serbisht dhe anglisht.

Prandaj, kush është për amendamentin e deputetes dhe Komisionit funksional, ju lutem. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Katër abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Deputetja Kelmendi, e përkrahur nga Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër?

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, Deputeti Mehdi Bardhi, pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? Katër për. Mirë shumë!

Domethënë, nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 16, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, Deputetja Kelmendi, me përkrahje nga Komisionit funksional.

Më falni, para votimit Hydajeti e kërkon fjalën – ka vërejtje.

HYDAJET HYSENI:

Kjo vërejtje mund të thuhej edhe për një nen përpara, por kaloi si shpejt, është më shumë terminologjike, por mendoj se është propozuar që të zëvendësohet pa nevojë shprehja “aftësia” që është ekuivalente me tekstin – shprehjen që është përdorur edhe në anglisht “abiliti” me shprehjen shqipe “zotësia” që në gjuhën shqipe nuk e mbulon kuptimin që motohet të mbulohet këtu. Megjithatë, mund të jetë edhe më e përshtatshme fjala “mundësia” në këtë rast, por fjala “zotësia” nuk e mbulon kuptimin së paku në bazë të atyre që i kam konsultuar unë. Mendoj se do t’ishte mirë të mirret edhe mendimi i ekspertëve – juristë, sepse “zotësia” nuk e ka atë kuptim që pretendon autorja. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Nekibe, urdhëroni.

NEKIBE KELMENDI:

Unë këtë term e kam huazuar, apo më mirë me thënë e kam përmirësuar fjalorin juridik të gjuhës shqipe me fjalorin juridik që përdoret në Shqipëri dhe konsideroj se ata më me kompetencë i dijnë dhe i përdorin këto terme. Prandaj, mendoj se duhet të mbetet “zotësia”.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Nekibe, ju falemnderit. Unë nuk do të pajtohesh as me Hydajetin as me ty, sepse ne jemi Parlament i Kosovës, ndërsa asnjë prej nesh nuk kemi çertifikatë se duhet ta përkthejmë bukalisht çdo term. Ju jeni profesioniste, do të thotë praktika ka të bëjë me këtë.

Prandaj, kush është për Komisionin funksional dhe deputeten Kelmendi?

Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Tre abstenime.

Kalon amendamenti.

Më erdhi shumë mirë që prej vetë grupit parlamentar ka kundër, do të thotë po lirohemi nga ajo që nganjëherë s'mundemi me menduar ndryshe nga grupi parlamentar.

Amendamenti 18, Deputeti Mehdi Bardhi, pa përkrahje nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit shumë. Tetë janë për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Një abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21, Deputeti Bardhi, pa Komisionin funksional.

Kush është për? Shumë mirë. Një për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 22, Deputetja Kelmendi, me Komisionin funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Qe, tash i kemi këto tjerat. Të falemnderit Daut.

Të gjitha amendamentet tjera, do të thotë prej 23 deri 33 janë të deputetes Kelmendi, bashkë me Komisionin funksional. Prandaj, për to do të shkojmë në pako, për dhjetë amendamente.

Kush është për? Ju falemnderit shumë.

A ka ndonjë votë kundër? Një kundër. Falemnderit shumë.

A ka abstenime? Një abstenim.

Domethënë miratohen këto amendamente.

Tani, ju lutem të deklarohe mi.

Kush është për aprovimin e ligjit në tërësi, me amendamentet e aprovuara?

Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime. Ju falemnderit shumë.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For	Të gjithë – Svi - All
- Kundër – Protiv – Against.....	00
- Abstenime – Uzdržani – Abstained.....	00

Tani kemi – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konsensionet.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kushtetutë të përkohshme, ka vlerësuar se Projektligji për konsensione ka bazueshmërinë juridike në kushtetutën e përkohshme.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji për konsensione dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për konsensionet dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike, reflektojnë qëndrimet e Komisionit për tregti dhe industri si Komision funksional e raportues dhe të komisioneve parlamentare.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Një votë kundër.
A ka abstenime? Një abstenim.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka kundër? Një kundër.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka kush kundër? Një kundër.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka kush kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka votë kundër? Nuk ka.
Abstenime? Një abstenim.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional.
Kush është për?
A ka kush kundër? Një kundër.
A ka abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional.
Hydajeti ka kërkuar fjalën.

HYDAJET HYSENI.

Falemnderit, kryetar. Në parim, unë mbështes këtë amendament, por mendoj se duhet të ndryshohet formulimi “kërkohet pëlqimi i Kuvendit”. Kuvendi ynë dhe asnjë kuvend nuk jep pëlqime por ose miraton, ose ratifikon dhe duhet të përdoret një shprehje adekuate zyrtare dhe jo shprehje e tillë e papërcaktuar “pëlqim”. Çka do të thotë “pëlqim”? Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Komisioni funksional, lidhur me këtë të jep sqarim.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Pajtohem. Mendoj se më mirë është ashtu siç thotë Hydajeti sesa që ka qenë. Na u ka përvjedhë. Kemi menduar se është mirë, por qe...

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit.

Kush është për këtë amendament, me përmirësimin e propozuar nga Hydajeti?

Falemnderit.

A ka kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti, me atë përmirësim.

Amendamenti 12, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)

Urdhëro? Cili? Trembëdhjetëshi, apo cili?

(Përgjegje – pa kyçje të mikrofonit)

Po, pse s’intervenuat para se të votojmë, o deputet?

(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)

Kërkoj falje, por e kemi votuar. Për shkak të vonesave në teknikë, çone dorën më lartë ata që kërkojnë fjalën, sepse vërtetë nuk po vëreheni.

Amendamenti 13, Komisioni funksional...

Para se ta votojmë Hydajeti e kërkon fjalën. Urdhëro Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Falemnderit. Kam përshtypjen se është përvjedhur një lëshim teknik. Në rreshtin 4 të këtij neni është “këshilli i ministrave”, kështu është edhe në anglisht e në serbisht, besoj se kryetari s’ma përdorë atë që po e përmendi edhe anglishten dhe serbishten...

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Duhet ta përmendi, se s'je as ti as unë ekspert për atë çështje.

HYDAJET HYSENI:

Jo, megjithatë mendoj se ne shqyrtojmë ligjin në tërësi dhe duke patur parasysh faktin se në dispozitat edhe kushtetuese edhe të tjera – teksti në anglisht ka përparësi. Unë mendoj se ne duhet t'i kushtojmë vazhdimisht kujdes sepse po na ndodhë që ne ndryshojmë diçka që në fakt pastaj nuk po korrigjohet në procedurën e mëtejshme. Por sido qo të jetë, meqë nuk është amendamentuar kjo, është një çështje teknike dhe mendoj se do të duhej ta korrigjonim tash. Nuk ka te ne këshill të ministrave as në shqip as në gjuhë tjera, por ka qeveri dhe duhet të jetë qeveri. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Amendamenti 13 – Hydajet e kemi, të fshihet titulli – kreu i dytë “Struktura institucionale” dhe të zëvendësohet me titullin “Agjencia e konsesioneve”. Nuk prek tjetër send.

HYDAJET HYSENI:

Po, por është në tekst “këshilli i ministrave” dhe po sygjeroj që të përmirësohet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po pse e kemi lënë në shqyrtim të tashëm. Unë plotësisht pajtohem, por të reagojmë në kohë. Ti bile nuk priton në kohë me reagu!

Komisioni le ta sqarojë edhe një herë, ju lutem.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju falemnderit. Sa i përket nenit 13, ka të bëjë vetëm me titullin e kreut dy – “Struktura institucionale” zëvendësohet me “Agjencia e konsesioneve”. Ndërsa në nenin 15, mendoj se këtë që thotë Hydajeti, është përfshirë dhe thuhet “Në nenin 13.1 – emërimi i këshillit të ministrave” duhet të zëvendësohet me termin “qeveria”. Do të thotë, pikërisht ashtu siç thotë edhe Hyda. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë që e nxënë Hydajetin!

Kush është për Komisionin funksional? Ju falemnderit.

A ka kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, Komisioni për buxhet.

Nuk po shkruan a është me pëlqim të Komisionit funksional, apo veçmas?

Bajrush?

BAJRUSH XHEMAJLI:

Më falni, por isha në konsultim me ...

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po, po e pash që jeni në konsultim. Amendamenti 15, Komisioni për buxhet. A pajtohet Komisioni funksional?

BAJRUSH XHEMAJLI:

Në të gjitha këto ku Komisioni për buxhet ka dhënë vërejtje, ne pajtohemi, kështu edhe është plotësuar Projektligji. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Komisioni për buxhet.
Kush është për?
Urdhëro, deputet.....

Ilaz Pireva:

Mikrofonin e Mehdi Bardhit, nëse bën. Kështu, konsideroj se nuk ka të drejtë Komisioni për buxhet ta ndërrojë fjalën “ndjek” sepse është shumë më drejt se sa që thuhet “përcjell”. Prandaj, konsideroj se ky amendament nuk duhet të miratohet. Le të mbetet ashtu siç është: “Ndjek gjendjen”, por jo “përcjell”.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj se duhet Komisioni për buxhet të pajtohet me këtë vërejtje? Profesionistët, ju lutem le të ndërhyjnë për ta bërë si është më së miri. Nekibe, mu duket se thatë diçka.

NEKIBE KELMENDI:

Mendoj se është shumë në rregull “përcjell” se “ndjek”.

(Ndërhyrje)

NEKIBE KELMENDI:

Nuk jam, por më pyeti!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, gjuhëtarët e Institutit Albanologjik!

Sala Ahmeti:

Pak më herët, edhe unë kisha domethënë dilema, por kur e shikova tekstin në tërësi, u binda se fjala “përcjell” është më e qëlluar. “Ndjek” më shumë ka kuptimin e ndjekjes penale ose.... Këtu ka të bëjë me përcjelljen e punës – vëzhgimin.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kush është për Buxhetin? Kur e jep profesionisti, s’kemi çka tjetër! Falemnderit shumë.
A ka kundër? Një kundër.
A ka abstenime? Një abstenim.
Kalon amendamenti.

Amendamenti 21, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Një kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22, Komisioni për buxhet.

Nekibe doni të merrni fjalën, a? Për të cilin, për atë që e votuam a?

NEKIBE KELMENDI:

Jo, jo. Për Buxhet, për të 22-shin. Mendoj se formulimi “Vendimi është i plotëfuqishëm” duhet të zëvendësohet me “Vendimi është fuqiplotë”.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë, Buxheti po thotë mirë. Kush është për buxhetin, me përmirësimin e Nekibës që e bëri? Ju falemnderit.

A ka kundër? Dy vota kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23, Komisioni për buxhet.

Urdhëro, Bujar.

BUJAR DUGOLLI:

Dëshiroj të pyes, sepse këtu shihet Komisioni për buxhet, ndërsa nuk shihet se çka ka deklaruar Komisioni funksional. Ne kemi ndjek një praktikë çdoherë me tregue se a është pajtuar apo pajtohet në seancë, sepse kështu edhe mund të bëjmë një shkelje procedurale dhe kërkoj sqarim rreth kësaj çështjeje. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë kërkoja dhe për këtë u deklarua, edhe pse është mirë me shkruar për atë që po thotë Dugolli por Komisioni funksional u pajtua për propozimet e buxhetit, edhe pse më mirë do të kishte qenë ta kishin patur deputetët me material. Ju falemnderit.

Amendamenti 23, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 24, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 25, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 26, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Një është kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 27, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 29, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 30, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 31, Komisioni për buxhet.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Dhe tani – ju ftoj që ta votojmë ligjin në tërësi me amendamentet e aprovuara.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A ka abstenime? Nuk ka.

75 deputetë janë të pranishëm.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë - Svi - All

Kundër – Protiv – Against..... 01

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Para se të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, unë shpresoj se përbërja e re e Parlamentit do ta shfrytëzojë teknikën. Unë kam bërë tentime disa herë, nuk kam patur përkrahje, sepse me këtë e lehtësojmë punën e udhëheqësit të seancës shumë, por më së shumti monitoruesve, sepse po lodhemi duke i numëruar votat – a janë a s’janë – kështu që do ta kishin patur në ekran sa janë “për” – sa “kundër” sa “abstenime” dhe të shkohet më tutje. Ju falemnderit shumë.

Mendoj se koha është për një kafepauzë dhe do të vazhdojmë në orën 11. Ju falemnderit.

(Vijoi pauza)

(Pas pauze, Seanca vazhdoi punën në orën 11).

(Seancën e kryesoi bashkëkryesuesi Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës)

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Para se të fillojmë, ju lus t’i vendosni kartelat të gjithë.

Të nderuar kolegë, vazhdojmë punimet e kësaj Seance.

Në radhë është – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara.

Të nderuar kolegë, siç jeni informuar Projektligji për punimet nga metalet e çmuara është miratuar në parim në Kuvendin e Kosovës më 17 qershor 2004.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamentet që do të procedohen gjatë votimit.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për punimet nga metalet e çmuara ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për punimet nga metalet e çmuara dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ndërkaq, Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Amendamentet që i keni përpara dhe materialet besoj i keni marrë me kohë dhe nëse ka ndokush vërejtje le t’i thotë.

Në mënyrë specifike amendamentet reflektojnë qëndrimet e Komisionit për tregti dhe industri si komision funksional e raportues, me këtë rast.

Lus përfaqësuesit e komisioneve dhe të grupeve parlamentare, apo eventualisht të Qeverisë nëse duan paraprakisht ta marrin fjalën dhe të bëjnë ndonjë vërejtje, koment apo diçka të ngjashme, le të urdhërojnë.

Meqë nuk paraqitet askush, atëherë shkojmë në shqyrtimin e amendamenteve të paraqitura.

Amendamenti numër 1, Komisioni funksional.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se me shumicë votash ose njëzërit aprovohet amendamenti i parë.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Kush është për? Është shumica.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Kush është për?

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4, Komisioni funksional.

Kush është për?

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet njëzërit.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.

Kush është për? Shumica.

A është kush kundër? Një.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

Së pari, a ka kush vërejtje meqë janë 3 pika të këtij amendamenti në vetë amendamentin? Nuk ka.

E vë në votim.

Kush është për? Është shumica.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 7, Komisioni funksional.

Kush është për? Është shumica.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.

Kush është për? Është shumica.

A ka votë kundër? Nuk ka.
 Abstenime? Nuk ka.
 Konstatohet se miratohet.

Amendamenti 9, Komisioni funksional.
 Për?
 Kundër? Nuk ka.
 Abstenime? Nuk ka.
 Miratohet njëzërit.

Amendamenti 10.
 Kush është për? Është shumica.
 Vota kundër? Nuk ka.
 Abstenime? Nuk ka.
 Miratohet.

Amendamenti 11, Komisioni funksional.
 Meqë janë dy-tri çështje që mund të mos jenë të lidhura, a ka ndonjë vërejtje paraprakisht dikush? Nuk ka.
 E vë në votim.
 Kush është për? Është shumica.
 A ka vota kundër? Nuk ka.
 Abstenime? Nuk ka.
 Konstatohet se miratohet.

Amendamenti 12.
 Të gjitha amendamentet janë të Komisionit funksional, prandaj propozoj të mos i përsërisim vazhdimisht.
 Kush është për?
 Më falni, paraprakisht është kërkuar fjala nga deputeti Hasan Meta. Urdhëroni deputet, e keni fjalën.

(Flet pa e kyçur mikrofonin – nuk dëgjohet)

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju lutem kyçeni mikrofonin sepse s'po dëgjohet. Jepjani fjalën – regjia ose kyçjani mikrofonin deputetit Hasan Meta.

HASAN META:

Nëse nuk prishë punë, përpara e patëm fjalën në vend “shënimeve” – “vulosja”. Tash e kemi në vend të “shënimeve” “shenjave”, mos ka diçka këtu, sepse po bjen ndesh me atë të parën.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Përfaqësuesi i Komisionit...? Ju falemnderit zoti Meta.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju falemnderit. Çështja e shënimeve, është thënë në dy funksione, që ne i kemi ndarë. Në fakt më e drejtë është aty ku është “vulosja”, në vend “shënimeve” me qenë “vulosja”, ndërsa tani “e shenjave”, sepse dallojnë “shenjat” – “vuosjet” dhe “shënimet”, por nuk është shti

gjithkund “shënimet” dhe do të thotë ka luajt shumë rolet “shënimet” dhe ne i kemi dalluar pak më mirë dhe më qartë.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falemnderit. Është tani e qartë.

Vë propozimin në votim.

Kush është për amendamentin e propozuar? Është shumica.

A ka vota kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konsideroj se aprovohet amendamenti.

Amendamenti 13.

Kush është për?

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Aprovohet.

Amendamenti 14.

Kush është për?

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Aprovohet njëzërit amendamenti.

Amendamenti 15.

Kush është për? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 16.

Kush është për? Shumica.

Abstenime?

Votë kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 17.

Për?

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 18.

Kush është për? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 19.

Kush është për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 20.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Amendamenti 21.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 22.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Dhe, amendamenti i fundit 23.
Kush është për? Është shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Me këtë përfundon lista e amendamenteve të paraqitura.
Në sallë janë të pranishëm 64 deputetë, do të thotë kemi kuorumin për të votuar.
Urdhëroni, ju lutem. Fjalën e ka kërkuar deputeti Mehdi Bardhi.

MEHDI BARDHI:

Falemnderit shumë zoti kryesues. Unë deshta vetëm në titullin e këtij ligji – Projektligji në realitet. Këtu folet për metalet e çmuara, që do të thotë gjuhësisht, unë nuk jam gjuhtar por kemi këtu gjuhëtarët tjerë, sikur folet për kohën e kaluar sikur kur folet se tani nuk janë të çmueshme. Le të jetë në vendin të çmueshme, një. Dy, të thojmë edhe në materialet më tej, punimet e metaleve fisnike, e jo për shembull metalet e çmueshme. Këto popozime i kam.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit. Në parim Kuvendi mund të shqyrtojë amendamentet që janë paraqitur me kohë dhe kanë ndjekur procedurën e duhur. Megjithatë, është një çështje e shtruar dhe të kërkojmë edhe mendimin e komisionit. Është e vërtetë që në tekst hasen të dy shprehjet – edhe “çmuara” edhe “çmueshme”. Në bazë të asaj që mund të konsultohen fjalorët e gjuhës shqipe, megjithatë përparësi do të duhej të kishte fjala “e çmuar”, sado që duket me vend vërejtja por këtu është propozuar që të jetë “metalet fisnike”. Prandaj, kërkoj mendimin e Komisionit.

E ka fjalën zoti Bajrush Xhemajli. Urdhëroni.

BAJRUSH XHEMAJLI:

U bë, ju falemnderit. Sa i përket asaj “të çmuar” apo të “çmueshme” sigurisht se gjuhëtarët mund ta japin fjalën e tyre më me kompetencë, por sa i përket pjesës së dytë ku ka të bëjë me

amendamentin e zotit Bardhi, ku thotë “në Projektligj mbi metalet e çmueshme të përfshihen edhe metalet fisnike gjegjësisht nikeli” për fat kam qëlluar kësaj radhe metalurg me profesion – inxhinier i metalurgjisë dhe ne do të thotë në metalurgji herë quhen – fjala është për të njëjtat – metale fisnike dhe herë-herë të çmueshme. Tash do të thotë kjo në fakt është e njëjtë, ndërsa nikeli dihet se është në gjashtë metale të çmueshme dhe nuk ka nevojë ta potencojmë që edhe nikeli. Unë e di që zoti Bardhi është prej Drenasit dhe atje ka nikel, ndoshta është i shtyer prej asaj, por në metale të çmueshme bën pjesë edhe nikeli. Kështu që nuk e shoh të arsyeshme ta potencojmë këtu, në gjashtë metalet e çmueshme. Falemnderit.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falemnderit zoti Xhemajli. Urdhëroni zoti Kosumi.

BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit kryesues. Ne edhe në shqyrtimin e parë e kemi theksuar këtë çështje. Titulli i Projektligjit duhet të jetë me “metalet e çmueshme”, do të thotë Projektligji për punimet nga metalet e çmueshme e jo të çmuara. Tjetër kuptim ka fjala “e çmuara” dhe tjetër kuptim ka fjala “e çmueshme”. Po habitem pse nuk është në amendament askund. Deputeti ka të drejtë. Nuk po flas për amendamentin për metalet fisnike – nikelin e tjera, por vetëm për titullin dhe duhet të jetë “Projektligji për punimet nga metalet e çmueshme”. “Çmuara” ka krejt tjetër kuptim. Çdo metal është i çmuar, kurse metalet e çmueshme, dihet cilat janë.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit. Urdhëroni zoti Çerkezi.

SYLEJMAN ÇERKEZI:

Unë kam një propozim, se gjatë muajve të pushimeve deputetët e Kuvendit të Kosovës të ndjekin një kurs gjuhësor prej një muaji dhe të kalojnë njëherë e mirë nga problemet gjuhësore. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falemnderit. Fjalën e ka kërkuar deputetja Sala Ahmeti.

SALA AHMETI:

Sa i përket këtij emërtimi duhet të përdoret mbiemri “e çmueshme” sepse “i çmuar” si pjesore, domethënë ka tjetër kuptim.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Ju falemnderit. Kjo çështje është çështje e lekturës dhe nuk do t’ishte mirë të jetë çështje gjithmonë e debatit parlamentar, se nuk jemi në gjendje këtu ne tash t’i vërtetojmë ato se cili variant është më i sakt e tjera. Unë po përsëris, e kam konsultuar fjalorin dhe megjithatë duke marrë parasysh këto që thuhet, përsëri më del se përparësi do të duhej të kishte “e çmuar”, por nuk jam unë që vlerësoi këtë. Unë propozoj që ne ta miratojmë ligjin siç i kemi miratuar amendamentet.

Lus deputetët që vërejtjet t'i bëjnë me kohë edhe të kësaj natyre dhe t'i bëjnë amendamente. Tani ngatrohët procedura po të vazhdojmë në këtë mënyrë, kurse ne do ta autorizojmë ne pastaj shërbimin adekuat gjuhësor që ta bëjë lekturën përfundimtare. Urdhëroni zoti Baruti.

BLERIM BARUTI:

Falemnderit zoti kryesues. Sa i përket metaleve të çmueshme, konsideroj se për nikelin nuk bëhet fjalë këtu. Bëhet fjalë për argjendin, platinën dhe arin dhe grupin e metaleve të platinës. Prandaj, nikeli nuk ka nevojë këtu të hyjë.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Por, as që ka hyrë.

Vë, me pëlqimin tuaj, Projektligjin në votim, me amendamentet e miratuara nga Kuvendi.

Kush është për? Është shumica.

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi miratoi njëzërit Projektligjin për – tani Ligjin për metalet e çmuara – çmueshme.

(Reagim - pa kyçje të mikrofonit)

Le ta rregullojë këtë çështje lektura, është prandaj çështje e lekturës, sepse edhe më parë janë bërë do korrigjime që në të vërtetë janë prishje dhe jo korrigjim i saj.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against..... 00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Kalojmë në shqyrtimin e ligjit vijues – në radhë është Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet.

Materialet i keni marrë me kohë.

Ju përkujtoj, ose më sakt ju kujtoj se në Kuvend ky Projektligj është shqyrtuar më 17 qershor të vitit 2004.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamentet që do të procedohen gjatë votimit.

Në vazhdim jipen konstatimet e komisioneve relevante.

Komisioni për çështje gjyqësore dhe legjislacion e kornizë kushtetuese ka vlerësuar se ky Projektligj ka bazueshmëri juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve nuk ka dërguar rekomandim por është zotuar se do ta bëjë rekomandimin gjatë seancës. Ndërkohë rekomandimi ka ardhur dhe Komisioni konstaton se ky Projektligj nuk ka shkelje të të drejtave të komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyje nuk përmbajnë implikime të papranueshme buxhetore.

Komisioni për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, si Komision funksional e raportues i rekomandon Kuvendit të Kosovës që ta miratojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për pyjet sipas tekstit të miratuar në shqyrtimin e parë.

Amendamente, edhe pse këtu përmenden, në fakt nuk janë bashkëngjitur... por ju e keni marrë tekstin e propozuar të Komisionit si ndryshim të Ligjit të miratuar nga Kuvendi.

Prandaj, pyes përfaqësuesit e komisioneve, të grupeve apo eventualisht të Qeverisë – nëse duan të marrin fjalën paraprakisht, para se ta hedhim në votim.

Nuk paraqitet askush. Urdhëroni zoti Hajdaraj.

TOMË HAJDARAJ:

Ju lutem, zoti kryesues. Këtu bëhet fjalë për ndryshimin e Ligjit, domethënë për plotësim dhe ndryshim të Ligjit. Këtu janë katër nene të reja tash për ligjin e ri të cilin do ta miratojë sot Kuvendi i Kosovës. Prandaj, unë mendoj që është e qëndrueshme ajo që në bazë të punës që kemi bërë dhe në bazë të rekomandimeve që kemi marrë nga komisionet tjera kryesore në Parlamnet, ky ligj të ndryshohet dhe plotësohet, edhe pse nuk është në tërësi ajo çka ne si Komision kemi menduar por kemi vendos që me datën 25 gusht të organizohet edhe një takim me Ministrinë me kërkesën e tyre në mënyrë që të harmonizohen dhe të definohen disa çështje të paralelizmave edhe në nenet tjera. Sot është fjala vetëm për nenin 36, ku kemi të bëjmë me gjobat dhe mendoj se ajo është plotësisht e qëndrueshme dhe mund të votohet. Falemnderit.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falemnderit zoti Hajdaraj. Por sa për sqarim. Nisma është tani nismë e re për ndryshimin e Ligjit të miratuar nga Kuvendi. Kuvendi – deputetët, komisionet kanë të drejtë të bëjnë amendamente edhe në këtë nismë. Meqë amendamente nuk ka patur, konsiderohet se duhet të shqyrtohet teksti i cili është shpërndarë dhe të cilin e keni patur ju në dispozicion.

Prandaj, vë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet në votim.

Kush është për? Është shumica dërrmuese.

A ka vota kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi njëzërit tani Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për pyjet numër 2003/3. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against..... 00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Vazhdojmë me shqyrtimin e dytë të projektligjit në vijim – është në radhë Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Ju kujtoj se ky Projektligj është miratuar në parim më 9 korrik 2004. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamentet që do të procedohen gjatë shqyrtimit të dytë në vazhdim.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, vlerëson se Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja ka bazueshmërinë juridike në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet vlerëson se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat e komuniteteve, siç është zotuar, do të deklarohet më vonë. Ndërkohë, po ashtu, ka arritur edhe rekomandimi ose raporti i Komisionit, në të cilin thuhet:

“Komisioni shqyrtoi Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe konstatoi se dispozitat e Projektligjit nuk cenojnë të drejtat e interesat e komuniteteve.

Komisioni shqyrtoi amendamentet e Komisionit funksional në Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe vlerësoj se amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.”

Bazuar në tekstin e lartshënuar, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja me amendamentet e propozuara.

Arsyetimin për t’i përforcuar këto rekomandime për Kuvend do ta paraqesë deputeti Mahir Jaghillar, nënkryetar i Komisionit.

Pasi deputeti këtu nuk është, megjithatë pyes përfaqësuesit e grupeve të komisioneve dhe eventualisht të Qeverisë nëse duan t’i drejtohen Kuvendit paraprakisht.

Urdhëroni zonja Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI:

Zoti kryesues, meqenëse kemi vetëm dy-tri amendamente ku paraqiten dy propozime të Komisionit funksional dhe të Komisionit për buxhet, nga amendamentet po del se nuk kanë këto divergjenca në mes veti. Kishte me qenë mirë - për ta lehtësuar punën edhe tuajën, por edhe tonën, që këto dy komisione të deklarohen – Komisioni funksional konkretisht – a e mbështetë amendamentin e Komisionit për buxhet, në mënyrë që të shkohet në pako.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Të falemnderit zonja Kelmendi. Unë mendoj se, megjithatë, duhet të rrespektojmë procedurat dhe amendamentet t’i shqyrtojmë një nga një me përjashtim kur ato janë një grup amendamentesh të një përmbajtjeje, siç është edhe në Rregullore. Nuk kemi shumë dhe është projektligj i fundit që ta shqyrtojmë në seancën e sotme. Prandaj, dëshiroj të kenë mirëkuptim. Fjalë ne ka kërkuar deputeti Naim Maloku. Urdhëroni zoti Maloku.

Lus regjinë t'ia mundësojë të flasë me kartelën e deputetit Mahmut Bakalli, dhe doi t'i sygjeroja deputetët që me rastin kur iu mungon kartela, le ta shfrytëzojnë foltoren e Kuvendit.

NAIM MALOKU:

Ju falemnderit zoti kryesues. Të nderuar deputetë, më lejoni që të jap mendimin në lidhje me amendamentet e propozuara nga Komisioni për buxhet. Flas në emër të Komisionit funksional. Ne i mbështesim amendamentet e Komisionit për buxhet, çka do të thotë se në amendamentin 29 ku janë dy propozime, më lejoni ta tërheqin variantin nën a) – pra të mbetet i Komisionit për buxhet dhe më lejoni që të jap mbështetje edhe të gjitha amendamenteve tjera që i ka propozuar Komisioni i buxhetit. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falënderojmë deputetin Maloku. Unë, megjithatë, mendoj se duhet t'i shqyrtojmë amendamentet një nga një. Tek vetëm pas shqyrtimit ne do të shohim nëse vërtetë janë krijuar kushtet për t'i miratuar të gjitha ose jo. Më lejoni që në fillim të përsëris një vërejtje që është përsëritur sa e sa herë Qeverisë për mosharmonizimin e teksteve. Ju lutem vëni re që – jo vetëm që në krye të Projektligjit në shqip është “proozim” si zakonisht, në anglisht “draft”, në serbisht “nacrt”, që nuk janë e njëjta gjë dhe ne po shqyrtojmë dokumente të cilësisë së ndryshme. Madje, në vetë titullin, në shqip është “Projektligj për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, në anglisht është vetëm projektligj për mbrojtjen e ajrit, kurse më vonë në tekst keni shumë mospërputhje. Ta zëmë, në shqip thuhet “të sillen standarde”, në anglisht “harmonizohen standardet” që nuk është e njëjta çështje. Prandaj, le të jetë vërejtje për sponsorizuesit e ligjit dhe t'i harmonizojnë tekstet siç janë të obliguar ta bëjnë edhe me Kornizën kushtetuese. Kurse, ne vazhdojmë me shqyrtimin e amendamenteve një për një.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Kush është për? Është shumica.

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Mund të deklaroj se të gjitha amendamentet deri në numrin 28 janë të Komisionit funksional.

Kush është për? Është shumica.

Votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 6.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
Për? Shumica.
Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 14.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 15.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 16.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 17.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 18.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 19.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 20.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 21.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 22.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 23.

Kam një vërejtje për ta thyer ndoshta edhe monotoninë, do të ishte mirë që Komisioni të bëjë një sqarim. Ka një kontraditë midis pikës së parë – Planifikimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja bazohet në strategjinë për mbrojtje të ajrit nga ndotja; – Programit kosovar të veprimit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; - Programit lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, e tjera.

Mendoj se do të jetë një lëshim teknik, prandaj do të ishte mirë që Komisioni ta sqarojë këtë.

NAIM MALOKU:

Është bërë lëshim teknik këtu. Janë a), b), c) d). Bazohet në a) Strategjinë për mbrojtje të ajrit nga ndotja; b) Programi kosovar të veprimit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; c) Programe lokale dhe d) Raportet për zbatimin e planeve dhe programeve të mbrojtjes së ajrit nga ndotja. Kështu janë dhënë amendamentet, por besoj se janë bërë lëshime teknike. Ju falemnderit.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Në dakord. Atëherë e vë në votim me sqarimin e dhënë nga përfaqësuesi i Komisionit.

Kush është për? Shumica.

Kundër? Një votë.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 24.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 25.

“Fshihet në nivel vendi” thuhet. E kam vështirë ta kuptoj, por e vë në votim.

Kush është për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 26.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 27.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 28.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 29, kemi dy propozime: Është sqarimi që u dha, do të thotë të hiqet amendamenti.

Vë në votim amendamentin e Komisionit për buxhet, tani me mbështetje të Komisionit funksional.

Meqë janë disa çështje të amendamentuara, pyes paraprakisht a ka ndokush vërejtje parimore në këtë formë të paraqitjes së amendamentit? Nuk ka.

Prandaj e vë në votim.

Kush është për amendamentin e Komisionit për buxhet, do të thotë amendamentin nën b), meqë amendamenti tjetër është tërhequr. Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se miratohet amendamenti.

Amendamenti 30, i Komisionit të buxhetit, me përkrahje të Komisionit, po e theksoj.

Personalisht kam një vërejtje sepse është kërkuar këtu të fshihet pjesa e parë dhe të zëvendësohet me pjesën e dytë të amendamentit. Për mendimin tim, nuk ka nevojë të fshihen se ato nuk e përjashtojnë njëra tjetrën por përkundrazi duhet të jenë të dyat.

Lus Komisionin për mendim, nëse konsideron se vërtetë duhet të fshihet pjesa e kërkuar që të fshihet apo jo.

Meqë nuk paraqitet askush, vë në votim propozimin kështu siç është.

Kush është për amendamentin? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se miratohet amendamenti.

Amendamenti 31, Komisioni funksional.

Për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 32, Komisioni funksional.

Vëni re, ju lutem. Kërkohej ose propozohet që në titull “aktet nënligjore” që nuk është në versionet tjera dhe nuk është adekuate me përmbajtjen, thuhet të zëvendësohet me “dispozitat përfundimtare”, kurse nuk është fjala për dispozita përfundimtare. Prandaj, unë mendoj se është mirë që Komisioni ta rishikojë dhe të japë një përgjegje, sepse në fakt prishet përmbajtja e tekstit.

Pyes Komisionin ose përfaqësuesin e Komisionit a ka arsyetim për këtë.

NAIM MALOKU:

Ka të bëjë me kreun 10 – Sanksionet ndaj ndotësve të ajrit dhe aktet nënligjore. Pra kreu i dhjetë përfshin sanksionet dhe kemi menduar që në vend këtu te aktet nënligjore është “Dispozitat përfundimtare të ligjit”.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Por është më shumë fjala për aktet ligjore, do të thotë që rregullojnë çështjen e sanksionimit. Një që nuk janë dispozita përfundimtare, siç propozohet dhe e dyta – nuk janë akte nënligjore, që të mos fusim një shprehje që s’është e qëndrueshme, prandaj do të ishte mirë të jipet mendimi edhe i ekspertëve – juristëve.

(Konsultime me Kryesinë e punës)

Urdhëroni. Fjalën e ka kërkuar deputeti Sejdiu.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryesues. Me mënyrën si është shtruar këtu, vërtetë nuk përputhet dhe Komisioni funksional ka të drejtë që në aktet nënligjore e ka heqë nga formulimi. Por është një problem i mëvonshëm se deri në 27-shin te cilësimi i akteve nënligjore te kjo materie – “ngarkohet Qeveria”. Këtu megjithatë kjo shkon në kuadër të dispozitave të mëvonshme, mund të jetë me dispozita përfundimtare, sepse është ngarkesë e drejtëpërdrejt që bie në barrë dhe janë ato që Qeveria do të veprojë në bazë të vendimeve të saj dhe për procedimin përkatësisht për zbatimin e këtij ligji. Kështu, në këtë version si është dhënë, ka diçka që duhet të dalë përpara, ta zëmë çështja e gjuhës. Absolutisht është ndërrimi i vendeve të materies, por mendoj kjo mënyrë megjithatë është e përputhshme dhe s’ka nevojë në 27-shin pastaj të figurojë “aktet nënligjore” fare.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Dhe, propozimi?

FATMIR SEJDIU:

Propozimi është: të mbetet në këtë variantë, vetëm të hiqet atje “aktet nënligjore” më vonë.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Pyes përfaqësuesin e Komisionit funksional – a pajtohet me këtë propozim apo formulim?

NAIM MALOKU:

Po në rregull, mbetet formulimi jonë pastaj, në bazë të sygjerimeve, mbetet formulimi dhe mbetet amendamenti 32... Vetëm 27-shi hiqet.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Mirë, a mund të formulohet - do të thotë kështu. Që në kreun 10, “aktet nënligjore” të zëvendësohen me “dispozitat...”, dhe neni 27 të zëvendësohet me “dispozitat përfundimtare”, siç është. Po, titulli i nenit. Mirë, atëherë mbetet çështja e formulimit, sepse është fjala për ligj. Do të thotë neni 27 – titulli zëvendësohet me “dispozitat përfundimtare” kurse “aktet nënligjore”....

(Konsultim me Kryesinë e punës - D. Beqiri: Janë dispozitat përfundimtare, çështja e akteve nënligjore, gjuha dhe hyrja në fuqi – janë një nëntitull, domethënë që përfshinë dispozitat përfundimtare. Besoj se mirë është. Formulimi i amendamenteve është me vend. Dispozitat përfundimtare përfshijnë këto tri pjesë: aktet nënligjore, gjuhën dhe hyrjen në fuqi.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

E kapitulli i dhjetë?

(Nga Kryesia e punës – D.Beqiri: Kapitulli i dhjetë i përfshinë sanksionet – që janë nën 26-shin. Domethënë zëvendësohen në shqip, anglisht dhe serbisht. Teksti ka të bëjë për të tri gjuhët).

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Urdhëroni zoti Maloku.

NAIM MALOKU:

Mendoj se pas krejt kësaj, duhet ta tërheqim amendamentin dhe mbetet siç është në ligj. Propozoj ashtu...

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Falemnderit. Urdhëroni zoti Sejdiu.

FATMIR SEJDIU:

Jo, në ligj nuk është mirë. Dhe, Naimi nuk ka të drejtë në këtë rast. Intervenimi i tyre për të futur në dispozitat përfundimtare është okej. Tjetër është ndoshta në frymën e idesë që ju e jipni në dispozitat përfundimtare të jetë e ndarë nga pjesa e sanksioneve. Dhe s’ prishë punë, por aktet nënligjore më vonë në 27-shin s’ mund të figurojë asisoj.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Duhet të jetë në dispozitat përfundimtare?

FATMIR SEJDIU:

Natyrisht.

BASHKËKRYESUESI HYDAJET HYSENI:

Prandaj, propozimi është që të titulli i nenit 27 – “Aktet nënligjore” të zëvendësohet me “Dispozitat përfundimtare” dhe pjesa tjetër të mbetet ashtu siç është.

Vë në votim këtë formulim.

Kush është për? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi aprovoi amendamentin e propozuar.

Amendamenti 33, Komisioni funksional.

Kush është për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 34.

Kush është për? Shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Amendamenti 35, ka disa nënamendamente.

A ka ndonjë vërejtje paraprake? Nuk ka.

Kush është për? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se miratohet amendamenti.

Dhe, amendamenti 36 – i fundit.

Kush është për? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Aprovohet.

Me këtë përfundon lista e amendamenteve të paraqitura.

Vë ligjin në tërësi, bashkë me amendamentet e miratuara, në votim.

Kush është për? Është shumica.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi njëzërit Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja – numër 2004/27. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against..... 00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Me kaq po i japim fund Seancës së sotme. Seanca e ardhshme mbahet nesër në orën 9, me rend të miratuar të ditës. Ka mendime të ndryshme për fillimin e seancës. Arsyeya është puna e vapës – ngrohjes, por meqë është korrigjuar dhe t honë është rregulluar, ka reagime – a pajtoheni të jetë në orën 10? Atëherë le të mbetet në orën 10.

(Seanca ndërpreu punën, për t'u vazhduar të nesërmen)

(Seanca vazhdoi punën të nesërmen në orën 10)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes. Mirëseardhje të gjithë deputetëve dhe ministrave në vazhdimin e seancës së rregullt të djeshme. Unë shpresoj që është një hepening i mirë që kemi mjaft ministra sot në Seancë me ne. Të shpresoj se kjo traditë e mandatit përfundimtar do të jetë si rregull për mandatin e ardhshëm përfaqësues. Prandaj, ju dëshiroj punë të mbarë të gjithëve.

Në rend dite është – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shpalljen e Kompleksit memorial Adem Jashari me interes të veçantë nacional.

Ky Projektligj, i hartuar nga Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kushtetutë, është i përkrahur nga Qeveria e Kosovës, iu është shpërndarë deputetëve më 6 korrik 2004, kështu që janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim, konform Rregullës 32 pika 1.

Ftojme anëtarin e Komisionit, deputetin Nerxhivane Dauti, që në emër të Komisionit legjislativ, para deputetëve ta prezentojë këtë ligj. Foltorja është e juaja, profesoreshë.

NERXHIVANE DAUTI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë, kam nderin që në emër të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese....

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Nerxhivane, meqë është prezentim i ligjit, urdhëroni në foltore, të lutem.

NERXHIVANE DAUTI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Kam nderin që në emër të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese të paraqes arsyetimin me rastin e leximit të parë të Projektligjit për shpalljen e Kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz, me interes të veçantë nacional.

Padyshim familja Jashari dhe Kompleksi i Jasharve, e ndërruan hitorinë politike të Kosovës dhe paraqesin simbol të rrezistencës, sakrificës dhe sublimimit për interesin e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Miratimi i këtij ligji, shënon një moment historik sepse me anë të këtij ligji krijohet baza ligjore për institucionalizimin e Kompleksit Adem Jashari dhe ngritjen e tij në nivel të tempullit nacional.

Shpallja e këtij Kompleksi me interes nacional, është një borxh që ky Kuvend dhe Kosova pa ia kthejnë kësaj familje atdhetare.

Me këtë Projektligj përcaktohet statusi i Kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz, kujdesi ndaj këtij Kompleksi, mbrojtja nga ndikimet politike dhe detyrimet e institucioneve të Kosovës.

Qëllimi i këtij Projektligji është shpallja e Kompleksit Adem Jashari zonë me interes të veçantë nacional për Kosovën.

Sipas këtij Projektligji Kompleksi përkujtimor Adem Jashari në Prekaz ka rëndësi ontologjike, antropologjike, historike, kulturore e qytetare për Skenderajn, Drenicën, Kosovën dhe tërë kombin shqiptar.

Duke e ngritur në nivel të institucionit nacional, Projektligji ndalon shprehimisht politizimin e tij, duke ndaluar tubimet dhe manifestimet partiake brenda hapësirës së tij.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fund, më lejoni të apeloj që ta përkrahim në parim këtë Projektligj të propozuar. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Hap debatin parimor. E merr fjalën profesor Alush Gashi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zëvendëskryetar i Grupit Parlamentar.

ALUSH GASHI:

I nderuari kryetar, zonja dhe zotrinj deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrah në parim këtë Projektligj dhe do ta japë kontributin e vet në punën e mëtutjeshme që kjo çështje të zgjidhet me ligj në mënyrë të duhur. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Berat Luzha, në emër të Grupit Parlamentar të PDK. Urdhëroni Berat.

BERAT LUZHA:

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përshëndet procedimin e Projektligjit për Kompleksin përkujtimor Adem Jashari në Prekaz dhe mendojmë se ky ligj duhet të përshpejtohet pasi konsiderojmë se edhe deri tash është vonuar shumë, dhe shprehim edhe një herë kënaqësinë që ky ligj po procedohet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Berat, ju falemnderit. Unë dua të reagoj. Në Parlament askush nuk e ka prolonguar këtë. As Kryesia, as kryetari, asnjë grup parlamentar. Herën e kaluar, jo pa arsye, unë ndërhyra në një fjalë të këtillë. Unë lus Parlamentin që të mos mundohemi të plarizohemi atje ku nuk ka asnjë arsye, asnjë dallim në qasje. Projektligji ka arritur me vonesë, dhe menjëherë – menjëherë i është shpërndarë deputetëve dhe është futur në procedurë. Megjithatë, ju falemnderit për përkrahje.

E ka fjalën Gani Sadik.

GANI SADIK:

Falemnderit zoti kryetar. Në emër të Grupit të të Tjerëve – turqëve, boshnjakëve, goranëve, hashkalinjëve, romëve dhe egjiptasëve përkrahim inisiativën dhe e mbështesim dhe do të votojmë për të. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Bujar, kërkoj falje, por nuk ju pash se jeni lajmërue. Urdhëroni.

BUJAR DUGOLLI:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë,
Që nga miratimi i Rezolutës për luftën çlirimtare të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi muaj më parë kur unanimisht u përkrah nga ky Parlament, ka qenë shumë e kuptueshme dhe e nevojshme që sa më shpejt të përgatitet edhe infrastruktura ligjore që kategoritë e dalura nga lufta por edhe monumentet kulturo-historike siç është parku kombëtar Adem Jashari në Prekaz të mbrohet me ligj të Kosovës.

Prandaj, edhe pse Qeveria ka ngecë sa i përket hartimit të këtyre ligjeve, vlenë të përmendet dhe përhëndetet nisma e Komisionit parlamentar për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kushtetuese që para nesh ka sjell sot këtë Projektligj me 9 nene, që janë shumë domethënëse për këtë çështje.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i jep mbështetje parimore këtij ligji dhe normalisht do ta japë kontributin e vet edhe në procedura të mëtejshme parlamentare. Ju falemnderit.

KRYETAR I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Për fjalë është lajmëruar deputeti Gani Koci. Urdhëroni, foltorja është e juaja.

GANI KOCI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë,
Megjithatë, unë konsideroj dhe duhet të mohoj se nuk ka patur pengesa në Kuvend dhe institucionet tjera rreth kësaj çështjeje. Pikërisht në këtë Kuvend dhe në këtë sallë është shtruar kjo çështje që statusi i familjes Jashari dhe i kompleksit memorial Adem Jashari të rregullohet me ligj, por ajo sikur është tejkualuar me njëlehtësi shumë të madhe. Megjithatë thonë më mirë vonë se kurrë dhe unë konsideroj se edhe pse vonë ky Projektligj është mëse i domosdoshëm, mëse i domosdoshëm për vetë faktin se ne shpeshherë dijmë të thirremi në

vlera dhe ato vlera ne akoma nuk i kemi institucionalizuar dhe është rast i parë që një vlerë të tillë vërtetë ta ketë përkrahjen institucionale, mbrojtjen institucionale dhe institucionalisht një përkujdesje rreth kësaj çështjeje. Kjo është mëse e nevojshme kur dihet edhe fakti se mbi një milion njerëz në vit vizitojnë atë Kompleks memorial dhe kur kihet parasysh ky fluks – kjo lëvizje njerëzish brenda një viti në një vend të tillë, konsideroj se të gjitha institucionet e Kosovës dhe ne si deputetë në këtë çështje jemi të vonuar, dhe përveç kësaj konsideroj se pas këtij Projektligji do të duhej që me një urgjencë shumë të madhe të rregullohet edhe statusi i familjes Jashari, sepse konsiderojmë se ne në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë nuk kemi autoritet tjetër moral më të madh dhe kombëtar se sa familjen Jashari dhe kur dihet se këtë familje brenda ditës vetë familjen e vizitojnë dhjetra delegacione të ndryshme, konsideroj se përveç kësaj do të duhej me ligj të rregullohet edhe statusi i familjes Jashari. Vetëm atëherë, ne do të mund ta kryenim obligimin që kemi ndaj familjes Jashari, ndaj Jasharajve në përgjithësi dhe ndaj gjithë asaj sakrifice që është bërë në luftën e fundit të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë prap po e theksoj. Nuk kam në përmbajtjen e fjalës të deputetit ndonjë kundërshti, por për hirë të dokumenteve që jesis të shkruara, Parlamenti dhe Kryesia e dijnë shumë mirë, dokumentet janë - letrat janë, kur janë në rend dite këto çështje në Parlament dhe në organet e tij nuk ka patur asnjë kundërshti. Nevoja që partitë politike mundohen para zgjedhjeve me bë marketing, është në rregull, në çdo Parlament, por mos u mundoni, unë po ju them vazhdimisht t'i përkeqësoni rrjedhat normale, dhe mendoj se keni të drejtë kur thoni jemi të vonuar, jemi të vonuar për shumëçka, por jo në Parlament dhe jo në Kryesi të Parlamentit dhe jo as kryetari, as deputetët jo. Prandaj, ju lutem le të adresohen problemet gjithmonë në burim, atje ku janë dhe mund të shfrytëzojmë të gjithë dokumentacionin fjalë për fjalë dhe të bindeni në këtë. Ka vite më parë kur publikisht dikush i ka cekur këto gjëra. Prandaj, të vazhdojmë me punën. Ju falemnderit për kontribut. Është paraqitur Fadil Geci, e pastaj Edi Shukriu.

FADIL GECI:

Falemnderit. I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, Projektligji për shpalljen e Kompleksit përkujtimor Adem Jashari në Prekaz është me një rëndësi të veçantë për Kosovën. Është mirë që tani veç është bërë e kuptuar se Drenica është interes i veçantë i kombit. Familja Jashari, më në fund, po lirohet nga individët dhe po kuptohet drejt se kjo familje më së paku ka qenë e tyre. Është mirë që familjet e Jasharajve po hyjnë në mbrojtje të shtetit të Kosovës për të cilën kanë kontribuar më së shumti.

I kam lexua me vëmendje këto nene të pakta – konkrete dhe për mua neni 4 ishte i paqartë, është i gjerë dhe duhet të konkretizohet hapësira për të cilën është bërë rezistenca e armatosur, dhe për disa – familja Jashari, e Jasharajve, Jasharajt në kuptimin e gjerë.

Mendoj se ligji është i mirë, duhet të përkrahjet në parim, duke llogaritur se edhe komisionet do ta kryejnë punën e vet dhe sa më shpejt ky ligj të bëhet i fuqishëm. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Edi Shukriu, pastaj le ta merr fjalën Ramush Haradinaj.

EDI SHUKRIU:

Ju falënderohem zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë,
Ju drejtohem si deputete, po ju drejtohem si kryetare e Komisionit për kulturë, rini dhe sport,
por edhe si një prej ekspertëve të Kosovës për trashigimi.

Në qoftë se më lejohet, në fillim të them se populli që rrespekton vlerat e veta dhe din t'i
prezentojë këto vlera, qoftë historike, kulturore, shkencore e të tjera – tregon se është popull
që ka ardhmëri.

Shpallja e Kompleksit memorial Adem Jashari me interes të veçantë nacional është një prej
projektligjeve mendoj më të çmuara dhe një prej ligjeve që besoj shpejt do të aprovohet dhe
që mund të marrë ky Kuvend.

Kontributi historik dhe mbinjerëzor i komandantit Adem Jashari dhe sakrificat e familjes
Jashari na obligon të gjithë neve të përkujdesemi me pietet për trashigiminë e çmuar të
historisë sonë bashkëkohore.

Mendoj se ky Kompleks duhet të jetë në krye të komplekseve të tjera që duhet po ashtu të
krijohen dhe të jenë në nivel të prezentimit më të denjë bashkëkohor për përkujtimin dhe
rrespektimin e vlerave të çmuara historike e kombëtare. Kur mendoj kështu, them jo vetëm të
nivelit kombëtar, por edhe të nivelit ndërkombëtar. Besoj se do ta arrijmë bashkërisht këtë.

Vetë arritja e Projektligjit në Kuvendin tonë, pra në vendin ku është meritë për ta bërë këtë,
mendoj se është edhe një hedhimit për tentime të përvetësimeve të ndryshme.

Më lejoni në fund të përkujtoj se menjëherë pas luftës ka patur tentime që këto të ngriten në
nivelin e Kosovës, ka patur tentime për përvetësime, prandaj më lejoni të shpreh kënaqësinë
time që në vendin më meritë po tregohet rrespekti për vetë komandantin, familjen e tij, por
shpresojmë së shpejti në mënyrë institucionale për të gjithë si një vlerë trashigimore shumë e
çmuar e Kosovës por edhe më gjerë. Ju falemnderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ:

Falemnderit zoti kryetar. Të nderuar, deputetë,

Mendoj se sot në Parlamentin e Kosovës po kryhet një veprim i duhur. Ne si Parlament kemi
shpreh këtë gatishmëri që të shkojmë më tutje me aprovimin e Rezolutës për vlerat e luftës.
Mendoj se sot institucionet e Kosovës po japin një provim, një provim e quaj shumë të
rëndësishëm dhe kështu edhe më tutje po dëshmojmë vendosmërinë tonë që të avancojmë
qëllimin e popullit të Kosovës për vetëvendosje.

Kalimi i debatit për një çështje të këtillë dhe përdorimi i këtij debati për çfarëdo qëllimi tjetër,
mendoj se nuk i bën nderë ligjit dhe çështjes për të cilën ne sot po debatojmë dhe unë kisha
lutur kolegët deputetë që të kursehen nga shumëçka që kanë menduar dhe veçanërisht të
bëhemi gati për votimin në parim të këtij ligji sepse kështu e kërkon nderi i çështjes të cilën e
trajtojmë dhe vetë veprimi që do të ndodhë sot në Parlamentin e Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju ftoj që ta përkrahim në parim këtë ligj.

Kush është për? Ju falemnderit. Njëzërit.
 Megjithatë, për shkak të procedurës pyes a ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.
 A ka abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All
Kundër – Protiv – Against.....00
Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimtarinë blektorale.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 3 qershor.
 Debati i sotëm është në parim.
 Para se të kalojmë, sigurisht se keni tjetër çështje. Urdhëroni, e ka fjalën Bedri Selmani.

BEDRI SELMANI:

Zoti kryetar, zonja e zotrinj deputetë,
 Kërkoj falje që mu dasht të lajmërohem dhe vetëm po lajmërohem për një vërejtje të Seancës së djeshme kur në rendin e ditës – në pikën 10 – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e investimeve në Kosovë është shty me insistimin e një letre që e ka shkruar Ministria për Tregti dhe Industri dhe pa të drejtë, pasi që është proceduar e tërë procedura që i duhet një projektligji me kaluar në Sekretarinë e Kuvendit, dhe ky propozim të vjen nga Kuvendi. Pra është fjala për propozimin tim rreth këtij Projektligji, i cili Projektligji i plotëson të gjitha standardet. Ata në këtë rast e shohin si të panevojshme, por në tërë procedurën e tyre nuk është problemi pse u shty për seancë të ardhshme por unë kam vërejtje te Ministria për Tregti dhe Industri se ata e shohin si të panevojshme. Për këtë arsye insistoj që kjo pikë e rendit të ditës, në qoftë se nuk prishë punë, të procedohet sot dhe të shkojë në miratim të parë.

Edhe një çështje tjetër, është që po e përsëris me përgjegjësi morale dhe profesionale se ky ligj i përmbushë të gjitha standardet ndërkombëtare dhe profesionale. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Përhirë të procesverbalit dhe të dokumentacionit, dhe të opinionit: Projektligjin të cilin e përmendi deputeti në fjalë, është proceduar sipas Rregullores në fuqi. Kryesia e ka përkrahur nismën e deputetit Bedri Selmani dhe është lejuar puna për këtë Projektligj, sipas normave me të cilat funksionon Parlamenti ynë. Edhe kur ka ardhur me futë në rend të ditës, ju e keni pa si deputetë – Kryesia ka proceduar konform rregullave me të cilat punon – është vendosë.

Megjithatë, vendimet e Seancës plenare nuk mund t'i korrigjojmë, t'i korrigjojë deputeti ose Qeveria. Dje, me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, të mbështetur nga Grupi Parlamentarë të LDK është heq nga rendi i ditës, me rekomandim të caktuar që të shikohet bashkërisht me Qeverinë. Do të thotë unë nuk vlerësoj se është hudhë Projektligji, të cilin e keni punuar ju dhe Grupi i ekspertëve, por Seanca e ka pa të arsyeshme që ndoshta një sintezë e përbashkët ose një punë e bashkuar dhe e kombinuar me Qeverinë

mund të japë një cilësi më të lartë. Në të kundërtën, unë mendoj se mund të procedohet dhe Seanca e ardhshme ta bëjë këtë kur të vjen në rend dite. Prandaj, është hequr nga rendi i ditës me këtë arsye. Në qoftë se Grupi juaj parlamentar ose deputetët e grupeve tjera parlamentare, në ndonjë mbledhje të ardhshme... Për këtë mbledhje, nuk është seancë e re, është vazhdim i punës së djeshme, prandaj nuk mundemi në të njëjtën seancë ta anulojmë vendimin tonë, zoti deputet. Nëse ka ndokush mendim tjetër...? Nuk ka. Ju falemnderit.

Vazhdojmë me pikën e cekur: – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimtarinë blektorale.

Ftohet minsitri Ethem Çeku që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezentojë Projektligjin. Urdhëroni ministër.

ETHEM ÇEKU:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë, Blektoria, si degë e ekonomisë, është një nga prioritetet e strategjisë zhvillimore të Kosovës. Prandaj, Qeveria e Kosovës, ka vlerësuar se nxjerrja e një infrastrukture ligjore për këtë veprimtari është e domosdoshme.

Projektligji për prodhimtarinë blektorale, të cilin e keni sot para veti, paraqet rregulla dhe standarde në sektorin e blektorisë të cilin e përafrojnë këtë sektor me strukturën ligjore të Bashkësisë Evropiane, duke marrë në konsideratë implikimet e mundshme sociale dhe ekonomike.

Ky Projektligj ka për qëllim të krijojë bazën ligjore për çështje që konsiderohen të rëndësishme dhe me prioritet nga lëmia e blektorisë, siç janë: mbarshtimi i kafshëve, ushqimi i kafshëve, standardet e kualitetet dhe klasifikimi i produkteve blektorale të prodhuara në fermë dhe të cilët i shiten industrisë përpunuese si dhe standardet zooteknike për mbajtjen e blektorisë.

Blektoria është një sektor me rëndësi të veçantë për ekonominë bujqësore të Kosovës dhe përfshin aspektet sociale të rëndësishme. Aktualisht, këtë sektor e dominojnë fermat e vogla për shkak të ndryshimeve të përgjithshme ekonomike në vend.

Prodhimtaria blektorale në Kosovë aktualisht është orientuar në rritjen e gjedhave për qumësht dhe atyre për prodhimin e mishit, të kafshëve të imta për mish apo për qumësht, si dhe mbajtjen e shpezëve.

Përpunimi i prodhimeve blektorale përfshihet në përpunimin e qumështit dhe përpunimin e mishit. Paraprakisht, sektori i përpunimit është mbështetur në fermat e sektorit shoqëror, të cilat janë shkatërruar dhe nuk funksionojnë. Ndërkaq, ekonomitë e vogla familjare kanë prodhuar për qëllime ekzistenciale.

Si pasojë e këtyre zhvillimeve, prodhimet me origjinë shtazore - në përqindje të madhe zëvendësohen nga importi.

Ligji aktual i blektorisë daton nga viti 1974 dhe nuk është më ai i aplikueshëm në sistemin e ekonomisë së tregut në Kosovë pikërisht për shkak të ndryshimeve të përgjithshme ekonomike. Ky ligj ka qenë i bazuar kryesisht në ekonominë e planifikuar, në pronën dhe ndërmarrjet shoqërore. Prandaj si i tillë nuk mund të aplikohet në sistemin e farmingut aktual në Kosovë, si dhe ndaj fermerëve të vegjël, të cilët aktualisht e dominojnë sektorin. Kjo ka bërë që të krijohet një zbrastësi e cila rezulton me zvogëlimin e produktivitetit të

prodhimtarisë si dhe mungesën e kontrollit të mbarshtrimit të kafshëve, të ushqimit dhe kualiteteve të prodhimeve ushqimore.

Gjatë hartimit të këtij Projektligji është koordinuar puna në mënyrë të veçantë edhe me Shërbimin Veterinar të Kosovës për të siguruar koherencën dhe përputhshmërinë e këtij ligji me ligjin e veterinarisë, sidomos lidhur me medikamentet, ushqimet e kafshëve dhe shërbimet veterinare gjatë fazës së identifikimit të kafshëve – proces ky i cili është në vijim.

Projektligji për prodhimtarinë blektorale përmban pesë kapituj.

Në kapitullin e parë, janë përfshirë dispozitat që kanë të bëjnë me mbarshtrimin.

Sipas këtij Projektligji, ky aktivitet rregullohet përmes librave amzë të bazuara në regjistrin e mbarshtrimit, regjistrin e performancave dhe analizat e definuara laboratorike, në mes tjerash edhe në materialet mbarshtruese, prodhimin blektoral dhe vetë kafshët. Prejardhja dhe vlerat e mbarshtruesit e një kafsheje, janë të cekura në çertifikatën përkatëse.

Sipas dispozitave të kësaj pjese të këtij Projektligji, mbarshtruesve të blektorisë duhet t'i sugurohen bazat për përkujdesjen sa më të mirë për të kryer këtë veprimtari, si dhe për të përmirësuar prodhimtarinë, tregtimin e lirë të kafshëve dhe materialeve gjenetike.

Me anë të programeve të miratuara nga Ministria, me qëllim të ruajtjes së popullacioneve të vogla të kafshëve që kultivohen në Kosovë, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të kërcnuar nga zhdukja, është paraparë miratimi i programeve për mbrojtjen e tyre.

Programet do të kenë synimin e ruajtjes së gjeneve të tyre, si dhe ndihmesën për përkujdesje dhe për mbarshtrim.

Ushqimi i kafshëve, është përfshirë në kapitullin e dytë. Ushqimi i kafshëve si dhe aditiva përfshin materialin ushqimor blektoral të regjistruar. Ushqimet e përbëra, aditivat e aprovuara, si dhe përzierjet ushqimore blektorale që tregtohen, të cilat duhet të jenë të pajisur me etiketa e që deklarojnë parametrat e caktuar të standardeve si dhe shpjegimet për përdorim.

Qëllimi i këtij Projektligji është të sigurojë që ushqimi i kafshëve, që janë në qarkullim, janë të kualitetit të mirë dhe iu përgjigjen standardeve të përcaktuara.

Në kapitullin e tretë, përfshihen dispozitat që kanë të bëjnë me përcaktuar standardet e cilësisë.

Në këto dispozita janë të shtruar çështjet që sigurojnë se prodhuesit blektoral, si dhe industria e përpunimit të prodhimeve blektorale kanë marrëveshje të qarta për çmimet e dorëzimit dhe të cilësive, të cilët mundësojnë që të caktohet baza për planifikimin e aktivitetit të biznesit në këtë lëmi.

Standardet zooteknike janë të përfshira në kapitullin e katërtë. Në këtë kapitull të Projektligjit, parashihet sigurimi i standardeve të nevojshme zooteknike në sektorin e blektorisë, duke vendosur standarde minimale për mbajtjen dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe minimizimin e dëmeve që mund t'i shkaktohen ambientit si pasojë eventuale e përcjelljes.

Ndërkaq, në kapitullin e pestë dhe të fundit, ky Projektligj përmban dispozitat ndëshkimore, përkatësisht sanksionet për shkelje eventuale të këtij ligji, të cilat janë të përfshira në pjesën e

pestë të këtij Projektligji, sipas të cilit është përcaktuar qartë zbatimimi përmes kontrollit dhe sanksioneve.

Të nderuar deputetë,

Duke patur parasysh rëndësinë e normimit të fushës për prodhimtarinë blektorale, si dhe nevojën për ndërtimin e një kornize përkatëse ligjore lidhur me këtë lëmi, me aprovimin e këtij ligji do të krijohet baza juridike për zhvillimin e sektorit të blektorisë – që është një sektor i rëndësishëm i bujqësisë. Ju falënderoj për vëmendjen tuaj.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Për fjalë është paraqitur Sebahate Krasniqi. Fjala është e juaja.

SEBAHATE KRASNIQI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra, Projektligji për prodhimtarinë blektorale, është projekt të cilit duhet t'i ndërrohet titulli apo emri, ose më mirë me thënë materia – sepse shumë ka të bëjë me prodhimtarinë blektorale, meqë prodhime blektorale janë mishi, qumështi, vezët, peshqit e tjerë – këto përmenden vetëm te standardet dhe kategorizimi i cilësisë së prodhimeve blektorale.

Prandaj, konsideroj se ky duhet të quhet “Ligji për blektorinë”.

Megjithatë, në këtë projekt, trajtohen shumëmirë çështjet që kanë të bëjnë me mbarshtimin e kafshëve, çertifikimin e personave që meren me këtë çështje, ruajtjen e racës së pastërt, asaj hibride, materialin gjenetik, e sidomos trajton hollësisht çështjet që kanë të bëjnë me ushqimin e kafshëve që përfshin ushqimin me origjinë bimore dhe aditivët, e në veçanti trajton shumëmirë aditivët të cilët ndikojnë në majmërinë dhe shtimin e prodhimeve blektorale.

Gjithashtu, në bazë të ligjit, është i paraparë krijimi i komisionit të mbarshtimit, komisionit për ushqimin e kafshëve, për dhënien e licencave personave që plotësojnë kushtet për inspektim dhe kështu themelohen mekanizmat implementues të ligjit.

Mirëpo, edhe këtu – si në shumë projekte të tjera të cilët kanë qenë më parë e që janë miratuar deri tash – vërehet një centralizim i pushtetit. Ministria trajton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me paketimin, tregtimin, kontrollin e cilësisë së ushqimit të kafshëve, në veçanti bën analizat e aditivëve tjerë, cakton standardet për prodhimtarinë blektorale dhe zooteknike.

Dhe, meqë ky Projektligj, bashkë me Ligjin për veterinarinë – të miratuar para pak ditësh në Parlament – janë komplementar dhe rregullojnë një fushë të rëndësishme të bujqësisë, unë – bashkë me Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duke patur parasysh që t'i përmirësojmë vërejtjet të cialt edhe i përmenda më lartë, përkrahim miratimin në parim të këtij Projekti. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit. E ka fjalën Tomë Hajdaraj, le të përgatitet Berat Luzha.

TOMË HAJDARAJ:

Falemnderit zoti kryetar. Kolegë deputetë, të nderuar ministra prezent, Meqenëse sot kemi një materie të rëndësishme për ekonominë e Kosovës, unë mendoj që, duke filluar nga titulli që duhet të bëhet ndryshim, e përmendi edhe zonja Grajçevci por unë e kam një përmirësim tjetër se duhet të quhet “Ligji për blektorinë e Kosovës” dhe mendoj është i qëndrueshëm dhe deri te masat përfundimtare, domethënë të kontrollit dhe inspeksionit – ka vend për të ndërhyrë. Terminologjia nuk është adekuate dhe konform asaj që duhet të jetë. Për shembull, kemi termin “kafshë bujqësore”. Unë falënderoj ministrin Çeku që bëri prezentimin, sepse sikur të mos kishte qenë sigurisht kishim me humb edhe në kohë, në materie dhe në vëllim dhe atëherë Parlamenti do të mbette si fajtor për mosrealizimin e detyrave të veta sipas programit. Por, më në fund qeveria ka vendos që çojë nga një përfaqësues dhe të bëjë prezentimin, gjegjësisht paraqitjen në parim të rregullativës bujqësore në tërësi dhe të ligjit që e kemi sot përpara. Por, mendoj që – për shembull termet “kafshë bujqësore” duhet të ndryshohen. “Racat”, ku është..., “popullsitë” e tjera, e tjera. Pastaj “mbrojtja e racave” është gati si paralelizëm me ruajtjen e racave, e tjera, e tjera, por sigurisht Komisioni gjatë punës së amendamentimit do të bëjë përmirësimin.

Po ashtu edhe te ushqimi i kafshëve, domethënë duke u nisur prej prodhimit e deri te aditivet, testimet dhe marrjen e mostrave ka mangësi, por mendoj se bashkë me specialistët të cilët i kemi nga Fakulteti i Bujqësisë dhe institutet tona referente do të bëjnë përplotësimin dhe në të ardhmen do ta kemi një ligj të miratuar komplet, konform rregullativës së Bashkësisë Evropiane dhe më gjerë dhe më vjen mirë që për herë të parë na është dhënë rasti të mbrojmë edhe racat tona me ligj, sepse deri më tash racat autoktone të Kosovës, për të mos thënë edhe ilirike, janë sjellë andej e këndej tregjeve të ndryshme të Ballkanit dhe më gjerë, duke dëshiruar që të përfitohen nga të tjerët dhe mendoj se është momenti më i pikërisht sidomos i mbrojtjes së tri llojeve dhe racave, siç kemi “Bardhoken ilire”, kemi “Bushën” dhe kemi edhe “Delatarin ilir” – qenin e Sharrit për të cilin para disa javëshs u organizua edhe tribunë ndërkombëtare për ta përvetësuar për shembull në Maqedoni, por prapëseprapë erdhi radha që të zbatohen edhe programe dhe projekte të cilat ideator të ndryshëm kanë paraparë që të njëjtat të futen dhe të mbrohen në mënyrë që të kemi edhe ne atë satisfaksionin tonë shumë pozitiv. Për dikë, ndoshta jo aq të rëndësishëm, por mendoj se me të vërtetë e kanë vendin. Ne si Grup Parlamentar dhe si Komision do ta përkrahim dhe do të japim kontributin tonë në përpilimin e amendamenteve. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Tomë, falemnderit. Berat Luzha, le të përgatitet Hasan Meta.

BERAT LUZHA:

Thënë përgjithësisht, është një ligj mjaft i mirë, i përgatitur mirë me gjuhë të qartë. Nuk ka frazeologji, sikur kanë shumica e ligjeve që na vijnë nga Qeveria. Janë disa vërejtje, të cilat mendoj se mund të përmirësohen gjatë procedurës në komisione dhe në amendamentimin e ligjit.

Këtu, qysh në krye të ligjit, është një pasaktësi e madhe ku thuhet “Kuvendi i Kosovës”, pastaj anglisht “Assambly of Kosovo” dhe pastaj “Vllada Kosova” në serbisht – domethënë Qeveria e Kosovës. Tash, a e kemi fjalën për Kuvendin apo për Qeverinë? Me siguri është ndonjë gabim teknik.

Këto pasaktësi vërehen edhe në vetë titullin në tri gjuhët, që nuk janë të njëjta gjithmonë dhe mendoj se duhet të hiqet neni 29 – ligji i aplikueshëm, për shkak se ne i kemi tejkaluar ato ligje të aplikueshme.

Në një vend quhen “kafshë bujqësore” në vend shtëpiake, e kështu me radhë. Mendoj se megjithatë është një ligj i mirë, por me disa korrigjime të vogla. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Hasan Meta, le të bëhet gati Mehdi Bardhi.

HASAN META:

Falemnderit zoti kryetar. Të nderuar ministra, të nderuar deputetë, Unë, me të vërtetë, e vlerësoj këtë ligj dhe si të domosdoshëm për ekonominë e Kosovës, për çka u fol mjaft. Por, reagimi im ishte në lidhje me “kafshët bujqësore”, dhe Toma ma grabiti që është shumë më afër tyre me profesion natyrisht po mendoj dhe mbeta tash pa tekstin që deshta ta them.

Me të vërtetë është shumë interesante që kur e kam lexuar si “kafshë bujqësore” nuk dija për çka bëhej fjalë. Në shkollë fillore i ndajshim të buta e të egra, të dobishme e të padobishme. Por, kjo Qeveria e Kosovës, me të vërtetë është një Qeveri si duket hibrid i bukur dhe thash mos mendojnë në do kafshë që e kanë rrënjën e bimës e trupin e kafshës, ku ta dij për çka dhe besoj se në të ardhmen do të kenë kujdes më shumë për këto terme, i cili term është gjatë tërë tekstit të Projektligjit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe Mehdi Bardhi. Urdhëroni...

MEHDI BARDHI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Zotri ministra, zotri deputetë, Në parim, që në fillim, përkrah këtë ligj, Projektligj në realitet, për përkrah edhe Tomën edhe Grajçevci lidhur me titullin e këtij ligji, për arsye se brendia e këtij ligji nuk bërthen këtë në atë ligj.

Ne çdoherë mendojmë dhe mundohemi që të bëjmë ligje të mira, por në realitet gjithëherë duhet të kihet parasysh sa mund të aplikohet. Ne me një bujqësi, të them ekstensive në Kosovë, e cila është bazament për rritjen e baktisë, apo të kafshëve – të quhen si të doni, në daç bujqësore, në daç shtëpiake si të doni të quhen... Por, në realitet unë do të thosha që për mbrojtjen e kafshëve po përmendi një rast që ndoshta nuk dihet se në fshatin Negroc komuna e Drenasit, është shfaqur borculoza e cila, për shembull, mund të kalojë edhe te njerëzit, kurse Qeveria nuk ka patur mjete apo nuk ka dasht, apo s’e di pse, nuk ka marrë kurrfarë mase për arsye se do të asgjasohej gjithë ajo bagti e në realitet bujku duhet të kompensohet.

Ne kemi bërë ferma, ferma të cilat për shembull bujqësore, por në realitet nuk kemi kurrfarë mbështetje ndaj fermerëve për ato ferma. Unë do të thosha që është shumëmirë që po e bëjmë tani një ligj ku do të mbrohen fermerët, por edhe për shembull bagtia e Kosovës.

E përkrah në parim këtë ligj. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit.

Ftoj të deklarohe mi. Kush është për përkrahjen në parim të Projektligjit?

Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka as abstenime.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For Të gjithë – Svii – All

Kundër – Protiv – Against..... 00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Lus deputetët që mos ta lëshojnë Seancën, sepse s'i po e kryejnë diskutimin, po e lëshojnë Seancën. Unë kuptoj nevojën e marketingut politik, por ne duhet të punojmë, prandaj mos ta rrezikojmë substancën dhe kuorumin.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspeksionin e arsimit.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 3 qershor dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj minisitrin Rexhep Osmani, që ta arsyetojë Projektligjin. Urdhëroni ministër.

REXHEP OSMANI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Kam nderin që para jush sot të paraqes një ekspozë të shkurtër lidhur me Projektligjin mbi inspeksionin e arsimit.

Ky Projektligj është i treti me radhë që aprovet për ngritjen e bazës ligjore në fushën e edukimit dhe të arsimit në Kosovë.

Minsitria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, intensivisht është duke punuar për përgatitjen e bazës ligjore dhe nënligjore për avansimin e procesit edukativo-arsimor në frymën e integriteteve rajonale, evropiane dhe më gjerë.

Arsyeja e nxjerrjes së këtij ligji:

Reformat në fushën e arsimit, janë duke ecur me një ritëm shumë të mirë. Mirëpo, shtrohet nevoja e aftësimit të të gjithë stafit menaxhues të arsimit, para të cilit po dalin detyra dhe obligime të reja. Kjo na ka obliguar që të ngrisim një staf inspektues. Stafi inspektues do të përcjellë rrespektimin e ligjshmërisë në të gjitha nivelet arsimore, menaxhimin në arsim dhe do të bëjë transparente formën, mënyrën dhe shkallën e realizimit të detyrave.

Arsimit në Kosovë, në kushtet e transicionit, i duhet rrugë zhvillimore e cila i mundëson një shtrirje më cilësore, përkatësisht një organizim që nxjerr në pah vlera e rezultate më të avancuara.

Format e një kontrolli të përhershëm mbi rrjedhat e sistemit shkollor, qofshin ato në kompetenca të sistemit publik apo privat, kushtëzojnë zbatimin e ligjshmërisë. Në këtë përkushtim është vënë në përpilim edhe Projektligji i inspeksionit të arsimit i Kosovës, i cili mundëson krijimin e kushteve për funksionimin e rregullt dhe ligjor të procesit edukativo-arsimor në Kosovë.

Ky Projektligj ka të bëjë me mbikëqyrjen, zbatimin e ligjeve dhe të rregullave, të akteve nënligjore në edukimin dhe arsimin publik e privat, për edukimin dhe arsimin parashkollor, arsimin fillor, të ulët e arsimin e mesëm, të lartë, arsimin e lartë universitar, arsimin special, aftësimin profesional dhe strehimet e organizuara të fëmijëve, nxënësve e të studentëve, çerdhet e fëmijëve dhe konviktet e nxënësve dhe të studentëve dhe arsimin në diasporë.

Çështjet e adresuara përmes këtij ligji, janë se ligji do t'u adresohet punëve të drejta dhe detyrave, autorizimeve dhe sanksioineve në të holla.

Ligji përmban tre kapituj, në të cilët do të përfshihen: dispozitat e përgjithshme, dispozitat ndëshkuese dhe dispozitat kalimtare.

Në dispozitat e përgjithshme, do të trajtohen çështjet, si: qëllimi, fushëveprimi, organizimi e tjera.

Me këtë ligj përcaktohen punët, të drejtat, detyrat, autorizimet, përgjegjësitë dhe mënyra e punës së inspeksionit të arsimit.

Ky ligj ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në edukimin dhe arsimin publik e privat.

Inspeksioni i arsimit është organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës e të Teknologjisë.

Inspeksionin e arsimit e përbëjnë: inspektori i përgjithshëm, zyrtarët e zyrave të inspektimit, inspektorët e zyrave rajonale të arsimit.

Inspektori i arsimit kontrollon, inspekton dhe nxjerr vendime meritore në përputhje me rregullativën ligjore për të gjitha çështjet dhe rastet kontestuese në institucionet arsimore; inicon ngritjen e procedurave adekuate administrative në mbrojtje të ligjshmërisë dhe rregullsisë në funksionimin e institucioneve të arsimit.

Inspektorët e arsimit, punët dhe detyrat i kryejnë përmes inspektimeve të rregullt, informativës speciale, kontrolluese dhe emergjente; organizimin e punës dhe të veprimtarisë së institucionit arsimor në harmoni me aktin e themelimit dhe me aktin e licencimit; kushtet, harmonizimin e akteve, funksionimin e organeve vetëqeverisëse e profesionale të institucionit arsimor.

Pas inspektimeve të kryera dhe përpilimit të procesverbalit mbi gjendjen faktike, dhe nëse konstatohen lëshime e parregullsi në punë - përmes rekomandimeve dhe sygjërimeve të parashtruara përcakton afatin e rivendosjes së ligjshmërisë në punë. Për raste të caktuara të inspektimit, inspektori i arsimit ka të drejtë të angazhojë ekspertë të fushës së caktuar.

Nëse inspektori është në dijeni se në institucionin e caktuar arsimor ka shkelje të ligjshmërisë dhe nuk merren masa për mënjanimin e parregullsive, atëherë merr masa. Nëse gjatë

inspektimit konstaton parregullsi në punën e inspeksionit, të institucionit arsimor merr masa dhe mban përgjegjësinë ligjore. Është fjala – nëse nuk merr masa.

Dispozitat ndëshkuese apo dënimet në të holla, të cilat do të ndërmerren në rast të moszbatimit të këtij ligji.

Dispozitat kalimtare do të përfshijnë të drejtën e Ministrisë për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, shfuqizimin e dispozitave të mëparshme në këtë fushë dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Deri tani ka qenë në fuqi “Ligji mbi inspeksionin e arsimit Nr. 011/3/79, datë 17.03.78 i KSA të Kosovës” i cili ka patur elemente të mangëta dhe elemente të sistemit të kaluar.

Prandaj, kërkoj nga Parlamenti i Kosovës që në parim ta miratojë këtë ligj, ndërsa në Grupin parlamentar për arsim, shkencë – mund të pasurohet edhe me ndonjë amendament të ri ose të bëhen korrigjime të duhura. Ju falemnderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër ju falemnderit. Profesor Alush Gashi është paraqitur për fjalë.

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar. Ju falemnderit për mundësinë e dhënë dhe do ta shfrytëzoj për një minutë lidhur me një çështje tjetër, nëse më lejohet. Ju falemnderit.

Duke ju falënderuar për mundësinë e dhënë, ju drejtohem në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe në konsultim me Partinë Demokratike të Kosovës dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Zoti kryetar, ditë më parë, përfaqësuesit e institucioneve demokratike të shumicës së shqiptarëve në Luginën e Preshevës na janë drejtuar për ndihmë lidhur me shkollim universitar.

Duke kuptuar të drejtën në shkollim, si një nga të drejtat themelore të njeriut, e konsiderojmë legjitime kërkesën e tyre dhe angazhohemi në realizim të plotë të saj.

Duke njohur të drejtën e qeverisë së një vendi që të interesohet për të drejtat njerëzore të minoritetit të tyre në një vend tjetër, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës që në kuadër të aktivitetit të saj ndërkombëtar të kërkojë nga bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria e të cilës shqiptarët e Luginës së Preshevës i paguajnë taksat – që të përmbushë këtë të drejtë njerëzore themelore dhe të krijojë kushte për shkollim universitar në gjuhë amtare.

Kërkojmë pra që në Luginën e Preshevës të ketë universitet në gjuhën shqipe.

Deri në realizim të kësaj të drejte themelore, duke rrespektuar parimin e mosndërhyerjes në vendime akademike të Universitetit të Prishtinës, kërkojmë nga Ministria e Arsimit që të eksplorojë mundësitë ligjore për t’iu dalë në ndihmë në këtë fazë të zhvillimit. Ju falemnderit në vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Vetëm ministri sepse do të debatojmë për ligjin, pastaj do të përcaktohem. Ju falemnderit.

REXHEP OSMANI:

Unë vetëm dola këtu për ta bër një sqarim lidhur me disa shkrime në opinion dhe kërkesa lidhur me planin e regjistrimit të studentëve në Universitetin e Prishtinës, të përcaktuar numrin e studentëve nga Ministria e Arsimit sipas Ligjit mbi arsimin e lartë dhe për të thënë se institucionet e Kosovës dhe Ministria e Arsimit me kujdesje të plotë po shikon kërkesat dhe interesimet e të gjithë atyre që shfaqin dëshirë të regjistrohen në Universitetin e Prishtinës, në kuadër të mundësive që ka Universiteti i Prishtinës dhe në kuadër të të drejtave të të gjithë studentëve kosovar dhe të tjerëve për t'u regjistruar dhe për të marrë një indeks në Universitetin e Prishtinës. Presionet janë të mëdha dhe numri i madh i maturantëve që kanë përfunduar shkollën e mesme në Kosovë është shumë i madh dhe gara për një indeks në Universitetin e Prishtinës është shumë e madhe.

Prandaj, duke patur parasysh të gjitha këto, ne nuk jemi ngutur dhe me kujdesje po shikojmë edhe kuotat të cilat i kemi përcaktuar për studentët jashtë Kosovës që ka qenë kërkesë e përfaqësuesve të shqiptarëve të Preshevës e të Bujanocit dhe kemi ra në kontakt me ta dhe jemi në proces të zgjidhjes së mundësive për t'u lehtësuar atyre, por edhe për t'u siguruar vende studentëve kosovar të cilët e kanë universitetin më pranë. Dhe, lidhur me këtë, në një seancë tjetër apo me një letër tjetër që mund ta dërgojë Ministria, mund të sqarojë detaje rreth kësaj. Jemi në proces të bisedës edhe me kryetarin e Parlamentit, edhe me përfaqësuesit. Prandaj, nuk kisha dëshiruar që të polemizohet kjo çështje dhe të politizohet me letra e peticione, sepse askush në Kosovë nuk vë obstrukcione kur është fjala për t'i ndihmuar gjithë ata që kanë nevojë për t'i ndihmuar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. T'i ndajmë çështjet. Unë mendoj për atë që profesor Gashi e paraqiti në emër të tri grupacioneve më të mëdha politike në Parlament, si deklaratë ad hok e paraqitur, të miratohet dhe pastaj kalojmë në procedimin e ligjit.

Kush është për deklaratën e profesor Gashit, bashkërisht me ato grupet tjera parlamentare? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një kundër!

(Reagim pa kyçje të mikrofonit: Jo, jo - s'jam kundër por po e kërkoj fjalën)

Jo, jo. Fjalën nuk ua dhash. Deputeti Meta, fjalën nuk ua kam dhën.

(Ndërhyerje – pa kyçje të mikrofonit)

Po tash për votë po të lus – nuk je kundër? Unë ju luta, sepse nuk kemi hap debat për këtë, se e kemi ligjin, por lidhur me këtë janë marrë grupet parlamentare. Falemnderit shumë. Unë edhe e kuptova ashtu. Meqenëse asnjë deputet nuk është kundër, të gjithë jemi “për” por rregulla e kërkon me pyet.

A ka ndonjë abstenim? Nuk ka.

Ju falemnderit. Miratohet njëzërit.

Kalojmë në procedimin e ligjit. Për fjalë është paraqitur, në emër të Grupit Parlamentar të LDK Nimon Alimusa, po më duket. Urdhëroni Nimon. Le të përgatitet Drita Statofci, në emër të Grupit Parlamentar.

NIMON ALIMUSA:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë,
Nuk ka dyshim se teksti i këtij Projektligji që sot e kemi në lexim të parë është ndër tekstet e rralla që na del i realizuar mirë, madje do të thosha shumëmirë...

(Ndërprerje)

Gjatë këtij mandati nuk kemi pasë shumë raste të tilla që qysh në lexim të parë të na dalë një tekst përafërsisht i përkryer. Ligji përfshin të gjitha sferat e arsimimit, madje edhe arsimimin në diasporë dhe shtëpitë korrektuese dhe burgjet.

Ligjin e karakterizion konciziteti, qartësia dhe saktësia, karakteristika këto kryesore për një ligj të mirë. Si duket, kësaj radhe praktika gjuhësore e ka rrespektuar shkencën, prandaj edhe gjuhësisht ligji ka dalë përafërsisht i realizuar mirë, ndonëse nuk u ka shpëtuar disa gabimeve.

Ne si Grup Parlamentar, nuk do të flasim për anë pozitive të tij, as për domosdoshmërinë e pasjes së këtij ligji, sidomos tash kur dihet se në çfarë kushtesh dhe rrethanash organizohet dhe zhvillohet procesi i arsimimit në Kosovë. Këtë rol, pra rëndësinë e tij më duket se e luajti mjaft me sukses ministri Osmani.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me dëshirën që ligji të jetë sa më komplet, sa më gjithpërfshirës, sa më praktik dhe sa më i zbatueshëm në jetë është marrë me anën tjetër të ligjit dhe ka evidencuar disa të meta.

Një. Në pjesën hyrëse të Projektligjit thuhet: “Kuvendi i Kosovës, duke u bazuar...” pika pika, të mos e citoj plotësisht “miraton dispozitat e përgjithshme”. Mendojmë se duhet të thuhet: “miraton ligjin për inspeksionin e arsimit”.

Dy. Te qëllimi i ligjit, anashkalohet mënyra e organizimit të inspeksionit të arsimit.

Tre. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke patur parasysh rolin dhe rëndësinë aq të madhe të këtij institucioni, mendon se inspektorin e përgjithshëm, si dhe inspektorët e tjerë duhet t’i zgjedhë Kuvendi i Kosovës e jo Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Katër. Të precizohet se cilës lëmi duhet të jetë përvoja e punës për tri vjet si kusht për t’u zgjedhur inspektor i arsimit.

Pesë. Të sqarohet se çka nënkupton me dokument të veçantë, mendohet me një dokument identifikimi apo për ndonjë dokument tjetër.

Gjashtë. Inspektori i përgjithshëm dhe inspektorët e tjerë, për punën e tyre duhet t’i japin raport dhe t’i përgjigjen – mendojmë – Kuvendit të Kosovës.

Dhe shtatë. Edhe në këtë ligj, mungesa herë-herë e një tabelimi të mirë ka bërë që ndonjëherë të kemi dispozita pak të gjata dhe prozaike.

Zoti kryetar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës përkundër vërejtjeve të paraqitura, e përkrah plotësisht në parim këtë Projektligj të ofruar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zonja Statofci, le të bëhet gati Dugolli.

DRITA STATOVCI:

I nderuari kryetar, të nderuar të pranishëm, Projektligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë pretendon rregullimin e kushteve të mira për jetë dhe për funksionim të pranueshëm të procesit edukativo-arsimor në Kosovë. Për këtë qëllim dhe me një teknikë të mirë juridike, ky Projektligj i adresohet me vend e me rend të drejtave, detyrave, autorizimeve por edhe përgjegjësive që duhet t'i ushtrojë dhe t'i realizojë inspeksioni i arsimit.

Projektligji sanksionon inspeksionin e arsimit si organ mbikëqyrës të procesit edukativo-arsimor në Kosovë dhe të njëjtin e përcakton si organ që funksionon në kuadër të Ministrisë si Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Harmonizimi i këtij Projektligji me legjislacionin e Unionit Evropian dhe përshtatja e domosdoshme me kushtet dhe rrethanat në Kosovë i japin këtij Projektligjit dimensionin e pëlqyeshëm për rrjedhat tona shoqërore.

Me të gjitha këto elemente pozitive, në punën e mëtejshme dhe me amendamente, ky Projektligj mund të fitojë strukturë juridike edhe më të mirë. Në këtë kontekst shfaqet e dëshirueshme të vendosen drejt raportet dhe nivelet akademike edhe në fushën e inspeksionit. Po ashtu, duhet patur kujdes për formulime të caktuara që imponojnë saktësi më të holluar. Për shembull, inspeksioni i arsimit, nuk do të inspektojë vendstrehimet e organizuara të fëmijëve e as shtëpitë korrektuese dhe burgjet në ndonjë kuptim tërësor institucional por do të inspektojë veprimtarinë e caktuar përkatësisht segmentin edukim dhe arsimim në këto institucione. Ose, në asnjë rast nuk duhet lejuar paqartësi në përdorimn e foljeve dhe të kuptimeve “me zgjedhë” dhe “me zgjidhë” sepse marrin konotime fare të paqarta.

Megjithatë, si tërësi, ky Projektligj ka bazueshmëri ligjore të pranueshme dhe mund të plotësohet në procedurën e mëtejshme. Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës shpreh përkrahjen dhe mbështes në parim këtë Projektligj tok dhe tok me kontributin e deputetëve të Kuvendit i dëshiroj ndërtim sa më të mirë. Mu falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Dugolli, le të përgatitet Gjylshen Berisha.

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit zoti kryetar. Po ashtu edhe ne i bashkëngjitemi vlerësimit se ky ligj është me rëndësi për sistemin tonë edukativo-arsimor në Kosovë dhe do t'i kontribuojë mbarëvajtjes së punës sa më të suksesshme të kësaj lëmie shumë të rëndësishme.

U thanë shumë, nga parafolësit, anë pozitive të këtij ligji, që edhe ne i bashkohemi, por u dhanë edhe disa vërejtje që nuk dëshiroj tash t'i përsërisim edhe ne, por i bashkohemi atyre

vlerësimeve që duhet në leximin e dytë gjatë konsultimit në Komisionin për arsim dhe shkencë t'i bëjmë në formë të amendamenteve.

Mendoj që diçka që nuk u tha dhe që është vërejtur nga ne, është kur flitet për kompetencat dhe autorizimet e inspektorit të arsimit, konkretisht neni 5.3, neni c) dhe d), ku thuhet “zgjatja e vitit të arsimit për lëndën e caktuar mësimore nëse konstatohet se nuk është realizuar planprogrami i arsimit dhe anulimi i notave të nxënësve, studentëve nëse konstatohet se gjatë procedurës së vlerësimit nuk janë rrespektuar kriteret profesionale të vlerësimit”. Ne mendojmë se kjo nuk mund dhe nuk duhet të jetë drejtë e inspektorëve. Inspektorët nuk mund ta bëjnë as zgjatjen e vitit mësimor, por as anulimin e notave dhe mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet në Komision me amendamente dhe nuk duhet t'i jipet inspektorit një e drejtë apo që të urdhërojë apo anulojë nota, sepse mendoj se nuk është kompetencë e tyre.

Po ashtu, kërkoj që gjatë kohës së amendamentimit, tash e tutje – edhe ky tekst i Projektligjit, por edhe i projektligjeve tjera të harmonizohen në bazë të ndryshimeve kushtetuese që janë bërë dhe terminologjia e çdo ligji që aprovohet në Kuvendin e Kosovës pas datës së ndryshimeve kushtetuese të mos figurojë më si në të vjetrin por të figurojë në bazë të vendimeve të Kuvendit që janë marrë në Seancën e kaluar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Gjylshen Berisha, le të bëhet gati Muhamet Kelmendi.

GJYLSHEN BERISHA:

Falemnderit. I nderuari kryetar, minsitra dhe deputetë të nderuar,
E përshëndes hartimin e këtij Projektligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë si pasurim i infrastrukturës ligjore të arsimit, meqë plotësohet një zbrastësirë ligjore në funksion të mbikëqyrjes së funksionimit normal të procesit edukativo-arsimor.

E kam lexuar me vëmendje këtë Projektligj. Është një Projektligj i hartuar mirë, i harmonizuar me standardet evropiane dhe ka kaluar në diskutim publik në institucionet arsimore që është mjaft me rëndësi dhe si anëtare e Komisionit për arsim, mendoj se Komisioni për arsim si Komision funksional përmes amendamentimit do të kontribuojë në pasurimin dhe korrigjimin e vërejtjeve eventuale qofshin teknike, siç është te neni 3, pika 3, alineja h) dhe në vërejtjet përmbajtësore siç është neni 5 pika 5. Andaj, mendoj se edhe deputetët tjerë, duke mos përjashtaur Komisionin e arsimit mund të kontribuojnë dhe i thërras që ta aprovojë dhe mbështesim këtë Projektligj në parim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit Muhamet Kelmendi, le të bëhet gati Fetije Këpuska.

MUHAMET KELMENDI:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj,
Është shumëmirë që ne sot kemi një Projektligj, i cili mendoj do të kontribuojë shumëmirë në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm dhe të kualifikimit të mëtejshëm të arsimit në Kosovë në përgjithësi, në drejtim të asaj që ne të ecim drejt reformimit të arsimit në përgjithësi në

Kosovë duke u mbështetur në Kuvendin e Bolonjës dhe të asaj që ne të jemi kontabilitibil në arsimin i cili organizohet në vendet e Perëndimit në përgjithësi.

Prandaj ky Projektligj, i cili në të ardhmen, pas intervenimeve të cilat duhet t'iu bëhen disa pjesëve të veçanta për të cilat ne në diskutimin e parë nuk mendoj se duhet të futemi në të, besoj se i plotëson të gjitha kushtet dhe do të kontribuojë në drejtimin e tillë. Megjithatë, unë dua të tërheq vërejtjen në dy çështje, që mendoj se janë shumë-shumë të rëndësishme.

Zoti ministër naë tha këtu sot se reforma është duke ecur mirë. Unë mendoj se kemi ngecje në reformë në përgjithësi në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë dhe kërkoj si deputet i këtij Kuvendi nga Minsitria, në veçanti nga minsitri, që të vazhdojë më tutje me reforma në mënyrë intensive në mënyrë që ne brenda periudhës së shkurtër të arrijmë tek ajo që sipas Kuvendit të bolonjës të kemi një arsim tamam në gjendje të njëjtë sikurse është në Perëndim, në mënyrë që qytetarët tanë të cilët kanë diplomuar këtu të kenë mundësi të barabarta për të konkuruar në të gjitha universitetet e Perëndimit pa iu nënshtruar provimeve plotësuese në fusha të veçanta, apo me shkuar edhe deri atje që ne të kemi rikthim të disa viteve mbrapa siç ka ndodhur në shumë raste të tjera për të cilat kam qenë edhe unë vet nga sistemi i vjetër.

Së dyti. Në qoftë se ne shkojmë kah dhënia e kompetencave shumë të mëdha inspeksionit të tillë, natyrisht se mund të luajë një rol negativisht, për arsye se intervenimet e tilla janë shumë të ashpra – shkojnë deri atje sa që edhe mendohet, siç u deklarua këtu, ka mundësi të anulohet... Këtu mendoj se duhet një diskutimin e ardhshëm të anulohen dhe të mos i jipen mundësi të tilla sepse ka mundësi dhe rreziqe që në terren të krijohen fërkime të ashpra dhe të pësojë arsimi.

Së treti. Duhet ta lus Ministrinë e Arsimit, Kuvendi dhe në përgjithësi qytetarët, të cilët me rren me arsim, Qeverinë në përgjithësi, që të shkohet kah përmirsimi i kushteve të arsimit dhe në veçanti të personelit arsimor, sepse çfarëdo projektligji që të sjellim, çfarëdo inspeksioni që të fusim në veprim, çfarëdo lligji që të kemi në fuqi – në qoftë se nuk i përmirësojmë kushtet e arsimit, nuk mund të kemi kualitetin e duhur të cilin e pret shoqëria jonë e që do të jetë e aftë për të konkuruar me ata të cilët janë në Perëndim.

Prandaj, duhet që të punojmë shumë në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës, të të ardhurave personale të personelit të arsimit, në mënyrë që me të vërtetë ata të kenë mundësi për t'u aftësuar vetë dhe një arsimtar i cili jeton me 170-180 euro të ketë mundësi pastaj të dalë e të merret me veprimtari tjera, kur nuk ka mundësi të aftësimit të tij, të ndjekjes së shkencës, të kulturës, të arsimit në përgjithësi në perëndim dhe pastaj atë ta bartë tek nxënësit, studentët e kështu me radhë. Prandaj besohet se ky projektligj do t'i ndihmojë çështjes së tillë, por me kusht që ne të ecim në drejtime të tilla dhe të arrijmë me të vërtetë kah ndërtimi i një arsimit publik dhe privat mbi baza të shëndosha dhe duke u mbështetur në Kuvendin e Bolonjës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fetije Këpuska, le të bëhet gati Hasan Meta.

FETIJE KËPUSKA:

Falemnderit zoti kryetar. Të nderuar ministra, kolegë deputetë, Parimisht duhet përkrahur Projektligjin për inspeksionin e arsimit në Kosovë, për të cilin po debatojmë në këtë Seancë.

Mendoj se projektdokumenti i prezentuar është i kompletuar pasi që ka përfshirë të gjitha subjektet, nivelet, fushat e shtrirjes dhe situatat e mundshme.

Zbatimi i këtij ligji duhet të rezultojë me funksionimin normal, të rregullt e të papengueshëm dhe të suksesshëm të procesit edukativo-arsimor në Kosovë.

Unë kam dy sygjerime, të cilat konsideroj se janë në interes që të përfshihen në tekstin përfundimtar. Janë dy çështje rreth të cilave do të fokusohem. Këto dy çështje për të cilat do të flas janë evidentuar në Projektligj, por jam e mendimit se ato duhet të theksohen akoma më shumë, më saktësisht dhe më konkretisht.

E para. Në dokumentin e propozuar janë evidentuar fushat dhe çështjet në të cilat bëhet inspektimi, që nga organizimi i punës, kushtet në të cilat organizohet procesi edukativo-arsimor, aktet normative, orari i provimeve, realizimi i programeve mësimore, vlerësimi, evidenca, dokumentacioni, masat disiplinore, të drejtat, obligimet e të gjithë të të përfshirëve në këtë lëmi, të drejtat e intervenimit të inspektimit e tjera. Ky aspekt – aspekt formal, material, teknik, legjislativ – i funksionimit të sistemit edukativo-arsimor - është pikënisje si parakusht i funksionimit normal të sistemit shkollor në të gjitha nivelet. Por kjo është njëra anë e medales – kontekst material e ligjor.

Është po ashtu me rëndësi kapitale edhe përcjellja e cilësisë dhe e efekteve të punës edukativo-arsimore, si dhe ato mësimore. Ky aspekt - arritja e cilësisë, efektet, rezultatet dhe sukcesi i punës edukativo-mësimore, duhet theksuar akoma më shumë dhe më fuqishëm në këtë Projektligj.

E dyta. Janë temë shumë e përfolur rastet e faljes së notave, aq më keq edhe të kushtëzimit apo shitjes së notave nga disa profesorë. Gjithnjë e më shpesh flitet për raste të shpërdorimeve dhe të abuzimeve nga disa profesorë dhe drejtues shkollash.

Në ligj është përmendur si fenomen korrupsioni, por mendoj se krahas masave të tjera, preventivisht duhet potencuar akoma më shumë këtë aspekt, duke i sanksionuar ashpër këto raste, që fatkeqësisht po shndërrohen në dukuri shumë brengosëse. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Hasan Meta, le të bëhet gati deputetja Zyhrije Maloku, a s'e dij qysh ma kanë shkruar.

HASAN META:

Zoti kryetar, të nderuar ministra, të nderaur deputetë,
Mund të shpreh kënaqësinë për paraqitjen e këtij Projektligji në Kuvendin e Kosovës dhe duke patur parasysh që arsimit, si shtyllë themelore e zhvillimit të shoqërisë, ka nevojë edhe për një projektligj të tillë, por duke plotësuar parakushtet e përparshme të parapara me reformën arsimore dhe nxitjen permanente të saj, të përmirësimit të sistemit edukativo-arsimor, sepse kushtet në çfarë ishim dhe çfarë jemi ende nuk janë të tilla që e mundësojnë një sistem të tillë zhvillimor arsimor dhe besoj që ky ligj, me ato përmirësimet e duhura, do të inicojë më në fund edhe punën e inspeksioneve në arsim, të cilat duhet të jenë efikase.

Dhe, e kam një pyetje, e cila – ndoshta duket teknike, por inspeksioni që do të kryejë punën jashtë, me çfarë pashaportash do ta kalojë kufirin, ju lutem?

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Deputetja Maloku, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

ZYHRIE MALOKU:

I nderuari zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë, Projektligji për inspeksionin e arsimit që sot po shqyrtohet në leximin e parë, ligj ky i cili begaton fushën e legjislacinit, e me theks të veçantë në fushën e arsimit. Ky ligj ka qenë dashur të vijë kaherë në Kuvend, menjëherë pas miratimit të Ligjit të arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë. Edhe pse na ka ardhur pak me vonesë, mund të them se është një ligj që është përgatitur mirë.

Projektligji për inspeksionin e arsimit, paraqet një bazë themelore dhe të përgjithshme për trajtimin e problemeve në fushën e inspeksionit të arsimit dhe paraqet një risi në krahasim me ligjin e mëparshëm në kuptim të përputhjes me standardet evropiane. Është i përpiluar me kujdes, i qartë, i shkurtë, me gjithsej 10 nene.

Gjatë leximit të Projektligjit, krijova përshtypjen se ekziston mundësia që të janë bërë lëshime, siç ndodh edhe me ligje të tjera.

Mendoj se në nenin 3, ku përfshihet organizimi i inspeksionit të arsimit, ka qenë mirë të përfshihen edhe inspektorët komunal. Them kësaj, sepse më duket që inspektorët rajonal do të kenë më vështirë t'i kryejnë të gjitha obligimet e secilës shkollë - të secilës komunë të Kosovës. Andaj, inspektorët komunal do të jenë në lidhje dhe kontakt më të shpeshtë me shkollat e komunave përkatëse.

Pastaj, në nenin 4 pika 9, ku thuhet se “Inspeksioni i arsimit është i detyruar të bëjë inspektimin informativ të çdo institucioni arsimor së paku një herë në vit”, mendoj se inspektimi informativ dhe ai kontrollues duhet të bëhet më shumë se dy herë në vit, domethënë një herë në fillim të vitit dhe një herë në mbarim të vitit shkollor.

Pastaj në nenin 5 te Kompetencat dhe autorizimet e inspeksionit të arsimit, pika 3 paragrafi c), thuhet se “Inspektorët e arsimit urdhërojnë zgjatjen e vitit mësimor për lëndë të caktuara nëse konstatohet se nuk është realizuar plani dhe programi mësimor”. Këtu parashtrahet pyetja: – si mund të zgjatet viti shkollor vetëm për disa lëndë mësimore? Ministria duhet të gjejë forma të tjera që mësimdhënësi i cili nuk ka realizuar planprogramin t'i kompensojë orët e humbura e jo në këtë formë sepse nxënësi po viktimizohet pa fajin e tij. Dihet se fajin e ka mësimdhënësi i papërgjegjshëm dhe i pazellshëm, kuptohet vetëm atëherë kur nuk ka arsye.

Ligjin e përkrah dhe e votoj në parim, por mendoj se gjatë fazës së amendamentimit do t'ishte mirë që të angazhohen dhe konsultohen ekspertë profesional në mënyrë që Projektligji të jetë sa më i plotë dhe gjithpërfshirës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ramadan Kelmendi, le të bëhet gati deputetja Remzije Nimani.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra, si dhe të pranishëm tjerë, Pas miratimit të Ligjit mbi arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, ishte dhe është e domosdoshme dhe e arsyeshme që të kemi edhe ligjin mbi inspeksionin e arsimit për të mbikëqyrë, në radhë të parë, dhe për të përcjellur procesin arsimor-edukativ në Kosovë. Për periudhën e shkuar, mendoj se ky ligj është veç tani i vonuar paksa. Por, fillimisht shtrohet nevoja e përcaktimit të të drejtave, detyrave dhe autorizimeve që i jep ky propozimligj inspektorit të arsimit, si dhe kriteret profesionale të inspektorëve të arsimit për ta zbatuar ligjin dhe rregullat në arsimin publik privat, duke përcjellur inspektorët e përgjithshëm dhe inspektorët profesional.

Vlerësoj se ky propozimligj lë anash përfshirjen edhe të inspektimit të qendrave të aftësimeve profesionale, shkollave të zanateve dhe shumë shkollave të trajnimeve që bëhen nga organizatat joqeveritare në Kosovë pa kurrfarë planprogramesh dhe kriteresh.

Si punëtor shumëvjeçar i arsimit, vlerësoj se kategorizimi i inspektorëve të arsimit në inspektorë të përgjithshëm, zyrtar të zyrës së inspektorëve dhe zyrtarë të zyrës rajonale të inspektimit, nuk është adekuat dhe krijon konflikte të kompetencave në mes të këtyre tri kategorive në realizimin e këtij ligji.

Në të njëjtën kohë, zyrtarët rajonal të inspektimit të arsimit nuk i përgjigjen fare drejtorive të arsimit të komunave nga se po ashtu edhe tani i kemi kompetencat e paqarta në mes këtyre zyreve dhe drejtorive të arsimit komunal dhe ky propozimligj në inspektim lë po ashtu zbrastësi të komentimeve të ndryshme dhe të konflikteve në inspektim, nga se askund inspektorët nuk i përgjigjen drejtorive komunale të arsimit.

Vlerësoj se edhe kategorizimi i këtyre niveleve të inspektimit nuk është adekuat me qëllimin e përmirësimit të cilësisë në arsim. Inspektorët duhet të vlerësojnë procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet, por nuk përcaktohet se inspektori çka kërkon në radhë të parë nga edukatori, arsimtari, profesori, për planprogramin, përgatitjen e përditshme, planin vjetor, mujor dhe tjera. Mungesa e këtyre krijon prapë konflikte në zbatim.

Kompetencat e inspektorëve të arsimit, ndër të tjera, në inicimin apo fillimin e procedurës disiplinore, si duket në paraqitje, nuk janë të drejta. Kujt t'i paraqiten? Drejtorit të shkollës apo komisionit disiplinor, i cili është komision për të dhënë përgjegjësinë e moskryerjes së punëve nga personi i autorizuar në procesin edukativ, dhe çfarë është roli i sindikatave.

Dhe, në veçanti, me asnjë dispozitë nuk mund të sanksionohet që të anulohet nota nga inspektorët, pushimt dhe shtimi i afatit.

Megjithkëto vërejtje parimore, mendoj se ky propozimligj jduhet të shkojë në procedurë të mëtutjeshme kuvendore. Ju falemnderit për dëgjim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Deputetja Remzije Nimani, e ka fjalën.

REMZIJE NIMANI:

Zotri kryetar i Kuvendit të Kosovës, ministra të nderuar, zonja dhe zotrinj deputetë, Projektligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë mundëson që përmes organit të veçantë mbikëqyrës siç është inspeksioni i arsimit të krijojë kushte normale për funksionim të rregullt dhe të papenguar të procesit edukativo-arsimor në Kosovë.

Projektligji i adresohet të drejtave, detyrave, autorizimeve dhe përgjegjësiqe që ka inspeksioni i arsimit në procesin edukativo-arsimor në Kosovë në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Përmes këtij Projektligji, inspeksioni i arsimit në Kosovë ka autorizim të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në arsimin publik dhe privat.

Ky Projektligj rregullon me përpikëri strukturën organizative të inspeksionit të arsimit.

Në veçanti ky Projektligj fuqizon rolin e inspeksionit të arsimit, mirëpo konsideroj se kompetencat e inspektorit të përgjithshëm, zyrtarit të zyrës së inspeksionit dhe zyrtarit rajonal të arsimit - nuk i sqaron sa duhet.

Përvoja ime shumëvjeçare në arsim më lejon që të konkludoj se detyrat dhe përgjegjësitë e inspeksionit të arsimit duhet të jenë të qarta, të definuara mirë dhe të përcjellura me kompetenca për realizim.

Njëherit vlerësoj se inspeksioni i arsimit duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë edhe me drejtorinë e arsimit komunal, e që nuk është përfshirë në këtë Projektligj.

Konsideroj se Projektligji nuk sqaron sa duhet dhe si duhet procedurat dhe përgjegjësitë disiplinore ndaj mësimehdhënësve dhe punëtorëve të tjerë, të cilët nuk i kryejnë punët dhe detyrat e përcaktuara me rregulla të institucionit dhe me ligj.

Përkundër vërejtjeve dhe sygjerimeve të parashtruara, konsideroj se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka bërë një punë të madhe që ka hartuar këtë Projektligj, i cili krijon kushte optimale për funksionimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e arsimit dhe si i tillë vlenë të përkrahet dhe të miratohet në parim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju ftoj të votojmë.

Kush është për përkrahje në parim? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against..... 00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Para se të kalojmë në shqyrtimin e Projektligjit kundër korrupsionit, për dy çështje teknike duhet të shkojmë në pauzë – sistemi ka rënë, teknika duhet ta ristartojë dhe ministri Krasniqi nuk është i pranishëm, prandaj nuk mund të vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës. Tani do të bëjmë një orë pauzë.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem t'i zëmë vendet. Kemi kuorum për me filluar punën dhe me debatuar, nuk kemi kuorum për vendimmarrje. Prandaj, shpresojmë se në ndërkohë do të plotësohet kuorumi dhe vendimmarrja do të jetë e plotëfuqishme.

Në rend dite është – Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit. Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 3 qershor 2004, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Fjalën hyrëse apo arsyetimin e Projektligjit do ta ketë ministri Jakup Krasniqi. Foltorja është e juaja zoti ministër.

JAKUP KRASNIQI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,
Ligji është përgatitur nga zyra ligjore e kryeministrit dhe unë përmes televizorit të RTK-ës mësova se duhet ta paraqes këtë ligj sot këtu. Prandaj, nuk isha në pjesën e parë...

Është mendim i një numri të madh autorës se nuk ka shoqëri në të cilën nuk është prezente dukuria e korrupsionit. Dëmet të cilat shkaktohen nga kjo dukuri janë të mëdha dhe përfshijnë segmente të ndryshme të shoqërisë si ato politike, ekonomike, sociale por para se gjithash zbehin besimin e qytetarëve tek institucionet demokratike dhe sundimi i ligjit në një shoqëri. Një konkluzion i tillë ka rrjedhur edhe nga Konferenca ndërkombëtare antikorrupsionit, e mbajtur në Lima të Perusë më 1997, ku pjesëmarrësit e saj e kanë trajtuar korrupsionin sikurse terrorizmin dhe krimin e organizuar për shkak të përmasave, shtrirjes së tij dhe pasojave të shumëfishta në të gjitha vendet bashkëkohore, e në veçanti në vendet që gjenden në periudhën e transicionit.

Në këtë aspekt, strategjia antikorrupsionit e shpallur nga Qeveria e Kosovës – nënkupton planin afatshkurtër dhe afatgjatë për luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie negative. Për të zhvilluar një luftë të tillë dhe më të suksesshme Qeveria e Kosovës ka ndër nevojën e formalizimit të kësaj strategjie që nënkupton nxjerrjen dhe aprovimin e ligjit kundër korrupsionit, të cilin – të nderuar deputetë – ne sot po e parashtrijmë para jush për miratim.

Rëndësia e madhe që ka aprovimi i këtij Projektligji shihet edhe nga fakti se ky Projektligj është pjesë e strategjisë legjislativë të Qeverisë së Kosovës dhe po ashtu pjesë e planit të implementimit të standardeve për Kosovën.

Ligji kundër korrupsionit është ndërtuar në tri shtylla kryesore:

- Baza legislative e sanksionimit në norma;
- Baza ekzekutive që nënkupton themelimin e agjencionit kundër korrupsionit, dhe
- Harmonizimi i këtij ligji me normat dhe standardet ndërkombëtare e posaçërisht me ato të Bashkimit Evropian.

Ky Projektligj përbëhet nga gjithsej 55 nene dhe është i strukturuar si vijon:

Kreu i parë – Dispozitat e përgjithshme, ku përfshihen nga neni 1 deri në nenin 8;

Kreu i dytë – Agjensioni Kosovar i antikorrupsionit – nenet 9 – 24;

Kreu i tretë – Konflikti i interesave – nenet 25-33;

Kreu i katërtë – Pranimi i dhuratave – nenet 34-37;

Kreu i pestë – Mbikëqyrja e pasurive – nenet 38-44;

Kreu i gjashtë – Mbrojtja e të dhënave, ruajtja, mbajtja e shënimeve dhe fshehtësia e informacionit – nenet 45-47;

Kreu i shtatë – Dispozitat ndëshkimore – neni 48; dhe

Kreu i tetë – Dispozitat kalimtare dhe të fundit – nenet 49-55.

Në kreun e parë, kryesisht parashihen dispozitat e përgjithshme të këtij Projektligji; përkufzimi i nocioneve; ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dhe të detyrës zyrtare, si dhe pavalshmëria e punëve juridike që rezultojnë nga korrupsioni.

Në kreun e dytë parashihet themelimi i agjencionit kosovar të antikorrupsionit, mënyra e udhëheqjes së tij; mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit të bashkëdrejtorëve; përfaqësimi i agjencionit; obligimi i organeve publike; autoriteteve lokale, si dhe personave zyrtar për të bashkëpunuar me agjencionin përkitazi me inspektimin e dokumentacionit relevant; pavarësinë e personave zyrtar që merren me luftimin dhe me parandalimin e korrupsionit; mënyra e themelimit të udhëheqjes si dhe veprimtarinë e këshillit të agjencionit.

Në kreun e tretë rregullohen rastet e konflikteve të interesave të personave zyrtar; pamundësinë e ushtrimit të funksioneve të tjera që janë në inkompatibilitet me funksionet e tyre si dhe obligimin e tyre që nëse janë duke ushtruar këto funksione të japin dorëheqje.

Në kreun e katërtë rregullohen ndalimi i personave zyrtar në pranimin e dhuratave përveç atyre formale dhe dhuratave të rastit me vlerë të vogël, duke përcaktuar rastet se kur dhuratat përbëjnë një dhuratë formale e kur një dhuratë me vlerë të vogël.

Në kreun e pestë rregullohen mbikëqyrja e pasurive të personave zyrtar, të lartë dhe personave që janë në marrëdhënie të afërtë me ta në bazë të informatave të dhëna prej tyre dhe në një formular të posaçëm të përcaktuar nga agjencioni. Pastaj, evidentimi i rasteve të ndryshimit të këtyre pasurive, pasojat e mosdorëzimit të informatave në lidhje me gjendjen e pasurive të personave të alrtë zyrtar, e tjerë.

Në kreun e gjashtë rregullohet obligimi i personave të punësuar në agjencion për të ruajtur si sekret informacionet e marrura gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare, por edhe pas pushimit të marrëdhënies së punës në afat prej 15 vjetësh; obligimin e agjencionit që për

periudhën prej 15 vitesh të mbajnë shënimet e rasteve të korrupsionit, shënimet për personat zyrtar dhe personat në marrëdhënie të afërt me ta.

Në kreun e shtatë parashihen dispozitat ndëshkimore ku parashihen dënimet me gjobë për rastet kur subjektet kontraktuese me tenderët publik shkulin rregullat e parapara me ligj.

Në kreun e tetë dhe njëkohësisht të fundit parashihen dispozitat kalimtare dhe të fundit, në të cilat parashihen obligimet e institucioneve ku punojnë personat zyrtar që të dorëzojnë listën e personave zyrtar dhe personave të afërt me ta dhe obligimin e këtyre të fundit që të dorëzojnë informacionet rreth pasurisë së tyre në agjencion. Pastaj, fillimi i funksionimit të agjencionit pas emërimit të bashkëdrejtërove, mënyrën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, e tjera.

Dhe, krejt në fund, të nderuar deputetë, sipas vlerësimit të Qeverisë – aprovimi i këtij Projektligji bën një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të luftimit dhe të parandalimit të korrupsionit në Kosovë.

Për këtë, ju ftojme që ta aprovoni këtë Projektligj, në mënyrë që tërë kjo veprimtari të vendoset në suaza të kornizës aktuale ligjore. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër, ju falemnderit. Ju lutem ata që kanë ardhur në ndërkohë t'i vendosin kartelat.

Hap debatin, i cili është vetëm në parim. Fatmir Sejdiu, shpresoj në emër të Lidhjes Demokratike. Urdhëroni profesor.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryetar. Ne dëgjuam ekspozenë e ministrit Krasniqi, që bëri përpjekje të japë elementet themelore të motivit dhe të vetë normës së parashtruar në këtë projekt në luftën që i nevojitet Kosovës kundër korrupsionit, një fenomen jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe i dëmshëm për shoqërinë kosovare, posaçërisht të themi që nga faza e fillimit – kujtoj edhe në fazat që mund të vijnë.

Janë dy-tre çështje që mendoj janë esenciale që të shihen në punën e mëtejshme për begatimin e këtij projekti për të marrë një natyrë finale të një ligji të mirë. Është nevoja e përpunimit të tij, siç tha edhe ministri, me vetë standardet evropiane. Nuk e di se në plotni a është arritur ky qëllim, megjithatë forma themelore ofron gjasa të mira.

Çështja e ngritjes së strukturave të reja, siç është agjencionin kosovar kundër korrupsionit dhe roli i tij në relacion me institucionet e tjera të Kosovës, duke patur parasysh përbërjen e tij në një plan nga struktura shtatëanëtarëshe duke filluar prej Kuvendit – organeve ndërkombëtare, prokurorisë, gjykatave etj.-etj., mendoj se duhet të përpunohet më mirë relacioni i mëvonshëm i këtij trupi pikërisht me ato organe që kanë për borxh thjesht ndjekjen efektive të këtij fenomeni apo të kësaj dukurie kriminale.

Çështja e dytë, është relacioni i tashëm dhe mendoj se duhet të bëhet një veprim i drejtpërdrejt nga ana e institucioneve të Kosovës në ristrukturimin e komisionit për emërime të larta, i cili, siç dihet – nga momenti i themelimit e deri tash eksoficion i ka kaluar mandati. Do të thotë nja dy vjet çfarë ka qenë nuk e di përbërjen e tanishme që është, por megjithatë duhet të ndërmerren veprime që ky të jetë konform trendeve të reja dhe të përmbajë gjithë atë strukturë të nevojshme të njerëzve që duhet ta bëjnë.

Një element tjetër i posaçëm është elementi në relacionin depolitizues, anipse ka këtu ndonjë nga normat që parashohin këtë efekt, me fjalë tjera mospërfshirjen e personave që në një mënyrë apo në mënyrë tjetër janë të implikuar në rrjedhat politike, apo që reprezentojnë formacione politike, sepse në këtë mënyrë ne nuk do të arrijmë një qëllim që e kemi objektiv themelor.

Dhe, së fundi, është pjesa ndoshta e lëshimeve teknike në fazën finale tek hyrja në fuqi, nëse s'parashihet ndryshe ajo, besoj se nuk ka nevojë që të figurojë si e tillë, por ajo dihet – një proces normal i miratimit të ligjeve.

Dhe, do të dëshiroja të përfoli vetëm pak – të themi me mahi – këtë shkresën fillimtare të Qeverisë, që ky ligj kundër korrupsionit mos të jetë ligj kundër kurrëopsionit, e keni një shkresë kësisoj. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit shumë. Në emër të Partisë Demokratike Ismajl Kurteshi. Urdhëroni zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

Kryesi e nderuar ...

(Ndërprerje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem t'ia aktivizoni mikrofonin Ismajl Kurteshit.

ISMAJL KURTESHI:

Shpesh kur po e kërkoj fjalën e s'po e marr, po e fajësoj kryetarin, por s'e ka fajin përherë kryetari, shpesh po, por ndonjëherë edhe teknika! Falemnderit.

Kryesi e nderuar, të nderuar kolegë deputetë, Sindromi i quajtur korrupsion, i përhapur në të gjitha vendet e botës paraqet një sfidë serioze për njerëzimin me pasoja të veçanta për ekonominë, por në Kosovë korrupsioni përveç dëmit që i sjell ekonomisë sjell edhe dëm politik, efekte negative të së cilës janë shumëfishë më të mëdha krahasuar me pasojat negative për vende tjera.

Prandaj, hartimi, aprovimi e sidomos zbatimi në jetë i ligjit antikorrupsion, jo vetëm që është i nevojshëm, por edhe i vonuar kur kemi parasysh se korrupsioni po hyn pothuaj në të gjitha portet e jetës dhe po bëhet pengesë serioze e zhvillimit të vendit dhe se shumë bartës të posteve publike të të gjitha niveleve vendor e ndërkombëtar po akuzohen shpesh për implikimin e tyre në afëra korruptive.

Janë të shumta rastet kur tenderët e financuar nga buxheti i Kosovës jepen në shpërputhje të plotë me procedura të parapara, po flitet shumë e bile edhe shpesh po argumentohet se

korruptionin e kanë përfshirë edhe fusha të tjera të jetës, si gjyqësinë, shëndetësinë, doganat, administratën, arsimin e institucione tjera të të gjitha niveleve.

Pasi që me korruption nënkuptohet çdo formë e shkeljes së detyrës së personave zyrtar ose përgjegjës në subjektet juridike, themelimi i agjencionit të Kosovës kundër korruptionit si organ i pavarur me qëllim të hetimit dhe ndjekjes së akterëve të veprave të korruptionit, ashtu siç parashihet në Projektligj, është i domosdoshëm.

Ky Projektligj, i cili pas amendamentimit do të shërbejë si një bazë solide për të luftuar korruptionin i ka edhe të metat e tij të cilat duhet në procedurën në vazhdim të korrigjohen.

Për shembull, në nenin 48, pika 2, thuhet: “Personat përgjegjës të subjekteve kontraktuese, që marrin pjesë në tenderët publik, janë të detyruar të paguajnë një gjobë nga 1.000 deri 10.000 euro nëse konstatohet se ata kanë kryer shkelje të ligjit.” Shtrohet pyetja – a luftohet korruptioni me masa aq joadekuate kur kemi parasysh se mundësia për të keqpërdorur shuma shumë më të mëdha të mjeteve janë reale.

Hartuesi dhe komisionet që do të trajtojnë këtë Projektligj duhet të shqyrtojnë me kujdes edhe nenin 38 që ka të bëjë me mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve si dhe nenin 34 që ka të bëjë me vlerat e lejuara të dhuratave të cilat për kushtet e Kosovës janë të larta.

Zonja dhe zotrinj,

Gabimet e natyrës gjuhësore dhe të përkthimit janë prezente edhe në këtë Projektligj. Për shembull, në nenin 2, ndër të tjera thuhet: “Përgjegjen ndaj një shpërblimi që drejtpërdrejt ose indirejtpërdrejt” që në shqipe kjo fjalë është në zbulim dhe marrë prej anglishtes “dajrektli or indajrektli”. Gabime të tilla ka edhe në pjesë të tjera të këtij Projektligji me të cilat do të duhej të mirreshin lektorët dhe përkthyesit, kurse me këto dhe vërejtjet tjera që do të vijnë nga komisionet dhe deputetët – shpresojmë se ky Projektligj që do të bëhet ligj do të mundësojë luftë të suksesshme kundër korruptionit dhe bartësve të këtij fenomeni sa të ulët aq edhe të dëmshëm, por që në Kosovë është luftuar pak deri më tani.

Sido që të jetë, Grupi Parlamentar i PDK në parim përkrah këtë Projektligj dhe beson se korrigjimet e nevojshme do të vijnë me kohë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Naim Maloku, le të përgatitet Fadil Kryeziu.

NAIM MALOKU:

Falemnderit. Zoti kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë, Korruptioni si fenomen dhe dukuri është i rrezikshëm për të gjitha shoqëritë mirëpo shoqëritë të cilat kanë kaluar fazën e konfliktit siç është shoqëria kosovare dhe shteti i Kosovës dhe shtetet në transicion, posaçërisht kanë qenë të goditura në përhapjen e fenomenit të korruptionit. Padyshim, ky fenomen ka ndodhë edhe në shoqërinë kosovare.

(Ndërprerje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Rikycjani mikrofonin Naim Malokut lus regjinë.

NAIM MALOKU:

Falemnderit zoti kryetar. Unë, personalisht duke përkrahur këtë Projektligj në parim, kisha me dhënë vetëm një sygjërim që agjencia kosovare kundër korrupsionit të jetë vërtetë apolitike dhe e pavarur, se vetëm në atë mënyrë kishte me kryer funksionin e përcaktuar me këtë Projektligj.

Më lejoni që ta përkrah këtë Projektligj në parim dhe të lus deputetët të japin mbështjeten për të. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën Fadil Kryeziu, le të bëhet gati Smajl Latifi.

FADIL KRYEZIU:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, zonja dhe zotrinj deputetë,
Para se t'i them dy-tri fjalë për këtë Projektligj që na është proceduar në Parlament, ndihem në njëfarë mënyre i obliguar që të falënderoj RTK që po kryen një emision të vetin, tonin e ndoshta edhe të Qeverisë – t'i njoftoj ministrat që të jenë të pranishëm.

E dyta, natyrisht jam i kurajuar për gjetësinë e minsitrit që përgatiti arsyetimin shumë shpejt për këtë Projektligj shumë të rëndësishëm.

Dhe, e treta – jam tejet i kurajuar nga gatishmëria e kryeministrit për të përgatitë këtë Projektligj dhe me çdo çmim që të luftohet kjo dukuri e cila pothuaj se – ose gati-gati në të gjithë botën është e paluftueshme, por megjithatë angazhimi për këtë Projektligj dhe për të përcjell ligjin në fuqi nxit transparencën e punës së institucioneve dhe shërbimeve të shtetit, të them – që janë në shërbim të qytetarëve, edhe pse në shkresën përcjellëse ose memorandumin përcjellës neve nuk na – ose decidivisht na është thënë se nuk është llogaritur kostoja e implementimit të këtij ligji.

Megjithatë, edhe theksova, që me çdo çmim duhet të luftohet një dukuri e tillë në drejtim që institucionet tona të rrisin edhe ofiçencën e tyre dhe transparencën e punës së tyre.

Unë do të ndalësha në dy pika konkrete, siç u potencua edhe më herët nga parafolësit – çështja e apolitizimit të agjencionit, siç edhe theksohet diku – zgjedhja apo formimi i këtij institucioni në nenin 10, do të t'hosha. Menoj se emërimi i njërit prej bashkëdrejtërore do të duhej t'i kalojë në kompetencë Kuvendit të Kosovës dhe jo të mbetet në Komisionin për emërtimet e larta publike, sepse kjo do të ndihmonte në këtë drejtim dhe çështja e dytë – në nenin 48 potencohen gjobat prej 1.000 deri në 10.000 dhe nuk theksohet se ku shkojnë, ku derdhen ato mjete, domethënë në qoftë se vihet deri te ato gjoba eventualisht ndaj atyre që shkelin ligjin e që sanksionohen me këtë Projektligj.

Personalisht e mbështes fuqishëm këtë Projektligj dhe shpresoj shumë që komisionet gjegjëse do të kontribuojnë në versionin definitiv të këtij Projektligji. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se ta merni Smajl fjalën, unë shpresoj për atë që tha deputeti Kryeziu. Besoj se Parlamenti i ardhshëm nuk do të pranojë qeveri që nuk e jep betimin në parlament.

Prandaj, shpeshherë kemi pasë propozime brenda ligjeve, që me çdo kusht dhe jo vetëm në një sektor anashkalohet Parlamenti. Edhe kjo që ishte, unë i kërkoj falje ministrit Krasniqi, por Parlamenti nuk e bën renditjen kush i arsyeton ligjet, sa për dokumentacion. Fjalën e ka Smajl Latifi, le të bëhet gati Haki Shatri.

SMAJL LATIFI:

I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë, Duke u bazuar vetëm në mediat por edhe në realitetin që po jetojmë në Kosovë, mund të konkludojmë thjesht se ka korrupsion dhe për këtë besoj se të gjithë jemi të njoftuar se ka korrupsion në të gjitha fushat. Se ky fenomen i ka përfshirë edhe institucionet e Kosovës, po ashtu besoj se të gjithë jemi në dijeni. Se ky lluks e komoditet ka bërë që të ngjiten në majën e piramidës në mënyrë të egër, të pandershme, të pamoralshme një pjesë e njerëzve, madje edhe politikanë – biznismenë dhe kanë krijuar e profilizuar qartë një shtresë skajshmërisht të kamur dhe kjo është e vërtetë. Se kjo shtresë e kamur ka eliminuar shtresën e mesme dhe i ka hapur shteg zgjerimit dhe rritjes së shtresës së varfër me tendencë kah varfëria ekstreme – edhe kjo, po ashtu – është e vërtetë. Se ky lluks e komoditet i faturohet shtresës e cila po e dëmton në vazhdimsi rënd qytтарin e Kosovës, duke ia vrarë shpresat atij, edhe pse nuk kanë kaluar pesë vjet nga lufta e përgjakshme çlirjimore e popullit shqiptar kundër pushtetit serb, po ashtu edhe kjo është e vërtetë.

Tashmë është shumë e njohur për të gjithë ne politika e tenderëve, e ndarjes së tyre, e përfitimit në emër të tyre të një numri tejet të vogël, pra shumë të vogël të njerëzve. Është shumë interesante se ky fenomen i rrezikshëm ka shkuar deri aty sa zoti Nebojsa Çoviq deklaroi para mediave se në Kosovë korrupsioni ose mafia është zhvilluar e ecë në baza multietnike – pra në funksion të ruajtjes së vllazërim-bashkimit. Pra, është edhe ky një fakt që tregon se deri ku ka shkuar dhe deri në ç'shikallë është ngritur e ngjitur korrupsioni.

Kumaritë e vjetra e të reja me armiqt tanë janë aktualizuar dhe theksuar vetëm pesë vjet pas luftës në Kosovë dhe këto veprime të çoroditura por të organizuara janë bërë gangrenë që po u kushton qytetarëve të Kosovës dhe vetë pozitës së saj. Këto veprime të organizuara kanë bërë që të pasurohen një shtresë njerëzish të cilët me veprimet e tyre e kanë ndihmuar dhe i ndihmojnë vetëm atyre qarqeve të huaja që ta dëmtojnë interesin vital të Kosovës dhe të qytetarëve tanë.

Por, UNMIK-u po ashtu, është mekanizmi që mbanë përgjegjësinë kryesore. Pra UNMIK-u është mekanizëm po ashtu tërësisht i korruptuar dhe kujdeset për ruajtjen e jetëgjatësisë së këtij fenomeni, sepse nga kjo dukuri pra përfiton në radhë të parë ai dhe të gjithë të tjerët që janë pas tij.

Megjithatë, është me interes të qartësohemi para se gjithash me vetëveten. A jemi të bindur ne se do të miratojmë ligj kundër korrupsionit, apo do ta legjitimojmë fenomenin e korrupsionit që po e brenë në mënyrë të organizuar shoqërinë tonë tani e sa kohë. Është me interes që ta kemi një seancë ku do të duhej të silleshin të gjitha informacionet, në mënyrë që të dihet mirë se kush janë të korruptuarit, kush e ushqen fenomenin e korrupsionit. Dhe do të ishte mirë që të demaskohen të gjithë të korruptuarit, në mënyrë që t'i sheh edhe opinioni ynë i brendshëm për të bërë dhe të pabërat e tyre. Është mëse e qartë se korrupsionin nuk mund ta luftojnë kurrë të korruptuarit. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Haki Shatri, le të bëhet gati Sebahate Krasniqi.

HAKI SHATRI:

Ju falemnderit zoti kryetar. Të nderuar të pranishëm,

Kërkova fjalën që duke shpresuar se me aprovimin e këtij ligji dhe zbatimin e tij në praktikë dhe me funksionalizimin e institucioneve që të ndërtohen mbi baza të këtij ligji nuk do të ndodhë sikur me rregulloren për themelimin e zyrës së revizorit dhe vetëfunksionalizimin e zyrës së revizorit, e cila para dy vitesh u themelua nga zoti Shtajner dhe ende nuk kemi rezultate as fryte të punës së saj.

Me shpresë se nxjerrja e këtij ligji do të ndikojë në parandalimin e dukurisë së korrupsionit dhe posaçërisht në institucionet publike, promovimin e demokracisë dhe mbizotërimin e ligjit e përkrah aprovimin e këtij ligji në parim. Po ashtu përkrah edhe përmbajtjen e ekspozesë së zotit ministër dhe kam vetëm dy-tri gjëra të shkurtëra që i kam vërejtur në lexim për këtë periudhë të aprovimit të ligjit.

E para, është se lidhet me agjencionin, që është paraparë të themelohet me ligj, e sipas dispozitave të tanishme të këtij Projektligji, ky agjencion merr kompetenca pak të predimensionuara dhe që dalin edhe në fusha tjera, siç janë rastet e ndjekjeve penale, të cilat në forma të ndryshme janë rregulluar në akte tjera ligjore të cilat janë aprovuar në këtë Kuvend. Prandaj, kjo pikë, besoj se duhet të rregullohet në procedurë të mëtejshme.

Pastaj, problemi i dytë, ka të bëjë me spektrin e ligjit, i cili kryesisht iu drejtohet keqpërdorimeve në pozita zyrtare. Jam plotësisht i vetëdijshëm se mund të kenë dhe ekzistojnë edhe raste tjera të korrupsionit, jo vetëm këto që janë përshkruar në këtë Projektligj.

Dhe, në fund, ligji përmban vetëm një nen në lidhje me ndëshkimet, dhe ai i përket personave kontraktues me tenderët publik, kurse të gjitha dispozitat në lidhje me konfliktin e interesit, pranimin e dhuratave, zbulimin e pasurive financiare, e tjera – duhet po ashtu të jenë dispozita të cilat paraqesin dispozita ndëshkimore ndaj këtyre dukurive.

Duke përkrahur këtë Projektligj në këtë fazë, ju falënderoj për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Sebahate Krasniqi, le të bëhet gati Gani Prekopuca.

SEBAHATE KRASNIQI:

Falemnderit zoti kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, Projektligji kundër korrupsionit plotëson një vakum ligjor të domosdoshëm dhe mundëson krijimin e sistemit modern të qeverisjes së mirë, të ndershme, konkurrencë të mirëfillt, rritje ekonomike dhe besueshmëri në institucione. Gjithashtu, duke patur parasysh se korrupsioni është çështje globale, edhe në këtë Projekt trajtohet si tillë. Në bazë të këtij Projektligji themelohet mekanizmi zbatues, gjegjësisht agjencionin kundër korrupsionit dhe meqë është autokratik, është vështirë të kontrollohet vetë rregullsia e agjencionit, sepse përveç raportimit në institucione nuk parashihet dhënia e përgjegjësisë për parregullsitë eventuale. Përndryshe janë mjaft mirë të trajtuara interesat e palëve, mbikëqyrja e pasurisë, pranimi i dhuratave, fshehtësia e informatave, mbrojtja ligjore e denoncuesit të korrupsionit, e cila gjë në ligjet e mëparme nuk kanë qenë, ndëshkimet e tjera.

Megjithkëtë, kam disa vërejtje tenike dhe përmbajtësore.

Një, për shembull pëdoret fjala “indrejtpërdrejt” në vend të “jodrejtpërdrejt”.

Dy, në nenin 4.2 ku flitet për përgjegjësinë për korrupsion, konsideroj se këtë duhet ta konstatojnë zyrtarët e agjencionit me qëllim që në këtë nen të mbyllet një shteg i mundshëm i korrupsionit.

Në nenin 6, afati prej 60 ditësh për të marrë përgjegje për verifikimin e vendimit të marrë si rezultat i korrupsionit, konsiderojs e është afat tepër i gjatë.

Pataj, në nenin 10.3, ku mandati është 5 vjet për bashkëdrejtorët me mundësi të riemërimit, po ashtu është mandat tepër i gjatë.

Në nenin 12c thuhet “nëse shkilen ligjet pozitive” është e papranueshme, sepse nuk duhet as të hartojmë e as të zbatojmë ligje negative, gjë që prejudikohet sipas tij.

Pastaj, duke qenë se këshilli i agjencionit përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët zgjedhet kryesuesi dhe zëvendësi i tij dhe gjithashtu anëtarët e këtij këshilli janë edhe bashkëdrejtorë të agjencionit, në këtë Projektligj është mjaft konfuz roli i bashkëdrejtorëve, i kryesuesit dhe zëvendësit të tij.

Shtatë, meqë ligji merr në mbrojtje denoncuesit e veprave të korrupsionit, duhet patur parasysh edhe marrjen e masave ndaj dëshmitarëve të rrejshëm.

Dhe së fundi – tetë, në nenin 52, është dashur të përmendet që pas pushimit të funksionit të bashkëdrejtorit të emëruar nga UNMIK-u me rastin e përfundimit të mandatit të UNMIK-ut në Kosovë agjencioni do të udhëheqet nga një drejtor.

Të nderuar delegatë, këto janë disa nga vërejtjet e mia lidhur me këtë Projektligj, që është i hartuar në përgjithësi mjaft mirë, është mjaft i qartë dhe gjatë përpunimit në komisione do të kontribuojmë që ta amendantojmë dhe t'i eliminojmë të metat eventuale të tij.

Prandaj, unë dhe Grupi Parlamentar i Aleancës e miratojmë në parim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën Gani Prekopuca, le të bëhet gati Ibush Jonuzi.

GANI PREKOPUCA:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë, Se është i nevojshëm ligji kundër korrupsionit, nuk ka dilema. Se është një ligj që është ofruar me konditat ashtu-kështu relativisht të mira, edhe aty nuk ka dilema. Nuk ka dilemë edhe pse bisedojmë për korrupsionin sot, e cila dukuri i ka përfshirë edhe vendet më të zhvilluara, shumë më herët sesa neve. Por, unë që në fillim dua të them se jam skeptik se mund të bëjmë diçka në këtë drejtim, për arsye se nuk ekzistojnë kushtet për një realizim të tillë. Në radhë të parë, ato globale barem. Nuk kemi kushtet, nuk kemi kontrollim të kufijve, nuk kemi legjislacion të vërtetë, nuk kemi kompetenca për pjesën e UNMIK-ut, KFOR-it dhe organizatave joqeveritare që veprojnë në Kosovë, bashka këto tonat.

Prandaj, hulumtimi i këtyre dukurive mund të jetë vetëm hulumtim, por kurrë edhe e arritjes si duhet.

Kush do ta bajë, për shembull, hulumtimin e korrupsionit apo antikorrupsionit në organizatën Habitat. Kush do ta bëjë hulumtimin e korrupsionit apo antikorrupsionit në organizatat publike ku menagjmentët i ka emëruar UNMIK-u, siç është PTK, Aeorporti, hekurudhat, mediumet e ndryshme të cilat marrin donacione nga jashtë, institutet e quajtura private dhe joprivate tek ne. Kush i financon ato?

Mua nuk më brengosë shumë puna e tenderëve, atje ku shihet. Çka t'i bëjmë korrupsionit i cili është jo i tejdukshëm? Ai është më i rrezikshmi. Kam dëgjuar debat në një shtet fqinj rreth korrupsionit. Edhe njerëzit më eminent kanë thënë ishalla nuk futet korrupsioni edhe në ushtri, në kreun ushtarak. Po qe se futet në kreun ushtarak, atëherë i kemi la duart. Tek ne, nuk e di kush do të mund ta ndjekë, meqë kreun ushtarak nuk e kemi. Polici vendore, e cila është kompetente për këto punë - nuk kemi, gjyqësi vendore kompetente për këtë punë nuk kemi, prandaj është mirë që edhe ne të shprehim vullnetin dhe dëshirën për këtë, por korrupsionin për ta luftuar do të duhet kohë, mund dhe vendosmëri. Ishalla njëra prej këtyre do të realizohet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë ju kuptova që e përkrahni, por shqetësimet janë konkrete. Fjalën e ka Ibush Jonuzi, le të përgatitet Hasan Meta.

IBUSH JONUZI:

Falemnderit zoti kryetar. Kryesi e punës, deputetë të nderuar, ministra dhe ju të pranishëm në këtë Seancë të Parlamentit.

Projektligji kundër korrupsionit që po e debatohet sot, në parim unë mendoj është një prej projektligjeve vërtetë më të rëndësishëm, por edhe shumë i ndieshëm sepse vetë emërtimi i tij jep për të kuptuar se kemi të bëjmë me një dukuri e cila në çdo shoqëri dhe për çdo vend është e ndieshme dhe e rrezikshme, sepse dihet çka ndodhë me atë vend ku depërton korrupsioni.

Projektligji i propozuar kundër korrupsionit synon të krijojë një sistem modern dhe funksional të mbrojtjes së rendit ligjor, qeverisjes së mirë, ndershmërisë dhe drejtësisë. Prandaj mendoj se me rastin e hartimit të tij është dashur mjaft mirë të mendohet dhe analizohet se a mund të aplikohen në praktikë këto rregulla të cilat e luftojnë një dukuri që - në çdo vend që paraqitet - sjell shkallë të lartë të rrezikshmërisë, e që është e barabartë me krimin e organizuar ose e ndihmon krimin.

Ky projektligj parasheh masat ndëshkimore për të gjithë ata që lidhen në rrjetin e korrupsionit, e që mendoj se këto masa duhet të jenë shumë rigorozë. U thanë, por dua t'i them vetëm disa çështje dhe për t'i mos i përsërit, mendoj se disa gjëra duhet të parashihen në formë tjetër.

Për shembull, në nenin 19, ku thuhet se “në bazë kërkesës të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës apo me inisiativën e tij Agjencioni dorëzon raportin e punës së tij të aprovuara nga këshilli i agjencionit së paku një vit...”. Duke ditur ndieshmërinë dhe peshën që ka kjo materie, duhet çdo vit kalendarik e ndoshta edhe më shpesh, agjencioni t'i paraqet raport Kuvendit për punën dhe problematikën me të cilën ballafaqohet gjatë punës së vet, sepse natyra e Projektligjit është çështje shumë e ndieshme dhe delikate.

Pastaj, te formimi i organeve të agjencionit, këtu në aspektin profesional dhe funksional duhet të precizohen gjërat më qartë dhe në mënyrë më konkrete, sepse në bërëndësi të ligjit ka

mangësi të cilat në praktikë pastaj do të sjellin kokëq këtë Projektligj.

arje tjera. Në parim e përkrahu

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit E ka fjalën Hasan Meta.

HASAN META:

Zoti kryetar, të nderuar ministra, a të nderuar deputetë,

Mendoj se korrupsioni si dukuri që është prezent në gjithë shoqërinë, që janë të organizuara mirë dhe jo të organizuara mirë, e don një trajtim të posaçëm dhe diskutimet çfarë janë këtu në Kuvendin tonë për këtë çështje, duke përdorur fjalën luftë kundër korrupsionit - mendoj se nuk mund t'i bëjmë një qasje serioze dhe sa duhet.

Kjo dukuri që është karcinom për shoqëri, duhet patur mundësi të luftohet me një qëllim që të vëhet nën kontroll të shoqërisë dhe institucioneve të shoqërisë. Është e pamundur të luftohet tërësisht korrupsioni, por këtu duhet ta vëmë theksin që të vëhet nën kontroll ky korrupsion, korrupsioni që ekziston apo që do të paraqitet.

Besoj se kjo është e mirë që ka ardhur ky Projektligj në Kuvend por dua ta them një gjë. Një fjalë popullore thotë: “kali i shumë shtëpive ngordh nga uria”. Kosova, siç e dini, është korridor që udhëhiqet nga shumë shtëpi dhe atë, mos të themi sa shumë janë ato shtëpi që e udhëheqin Kosovën. Edhe pse ne nganjëherë vetit i bëjmë qef që kemi shtet, kemi kushtetutë, kemi institucione të pavarura në letër - por letra duron çdo gjë.

Duhet të them se këtu, përveç atyre fakteve që u thanë përpara se e dëmtojnë ekonominë e tjera-e tjera, korrupsioni është dukuri që më së shumti e dëmton moralin e një shoqërie. A, të jemi pak a shumë të sinqertë: në shoqërinë kosovare nuk qëndrohet bash mirë me moral, dhe besoj se nëse bazohemi edhe në atë që deri më sot përgjegjësia e individëve të fajshëm në vende kyçe institucionale nuk është në mënyrë adekuate e trajtuar do të thotë me ndonjë dorëheqje apo me diçka të tillë e që ndodhë me shoqëritë moderne dhe të organizuara, e vërtetë është që skepticizmi ka vend këtu për një gjë të tillë që të mund të hyjë në veprim ky ligj pas miratimit, si edhe shumë ligje të tjera. Por unë e përkrah këtë dhe besoj se bile-bile gjatë kësaj periudhe për një legjislacion tjetër të Kuvendit të gjithë njerëzit të mendojnë për këtë çështje nëse ia dojnë të mirën Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dëgjuam të gjitha debatet. Shpresoj se puna në komisione për këtë do të jetë e suksesshme.

Kush është për aprovim në parim? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush? Nuk ka abstenime. Ju falemnderit.

Konstatohet se në parim është aprovuar Projektligjit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi – All....

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Kuorum për vendimmarrje kemi, prandaj vazhdojmë me Shqyrtimin e parë të Projektligjit për lojërat me fat.

Projektligji iu është shpërndarë depretëve më 3 qershor 2004, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftohet ministri për ekonomi e financa, zoti Ali Sadriu ta marrë fjalën në emrin e vet dhe të Qeverisë.

ALI SADRIU:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë kur më jipet rasti të bëj prezentimin e parë të këtij Projektligji.

Organizimi i lojërave të fatit cilësohet si veprimtari shumë specifike dhe tejet e ndieshme nga institucionet evropiane, si Parlamenti Evropian, Fkëshilli i Ministrave të UE, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si dhe nga aligjet e vendeve anëtare të UE.

Për këtë arsye, në përpilimin e këtij Projektligji jemi shërbyer nga shembuj dhe përvoja të vendeve të BE dhe nga vlerësimet e institucioneve të lartpërmendura si dhe rekomandimet e Organizatës së Lotarive Shtetërore Evropiane.

Meqenëse synimi ynë është integrimi i Kosovës në një të ardhme në UE, kemi parë të arsyeshme dhe të domosdoshme që të shërbehemi me përvojat e UE, e me këtë rast na ka shërbyer shumë dokumenti i dalur nga mbledhja e përfaqësuesve të Parlamentit Evropian dhe UE me Organizatën e Lotarive Shtetërore Evropiane në Bruksel – të mbajtur në mars të vitit 2002, që më tepër njihet si “Letra e bardhë e Brukselit”.

Për një funksionim më të mirë dhe me një transparencë më të madhe të lojërave të fatit si dhe të vetë Lotarisë së Ksoovës, është e nevojshme nxjerrja e ligjit mbi lojërat e fatit.

Me këtë ligj, lojërat e fatit, Logaria e Kosovës dhe subjektet tjera juridike të regjistruara dhe tli ëiçencuara do të vëhen në mbikëqyrje dhe kontroll për të mos lënë hapësirë për mashtrime dhe keqpërdorime të ndryshme.

Problemet të cilat i përcjellin lojërat e fatit janë evidente, prandaj është nevojë imediate që përmes këtij Projektligji të evitohen këto probleme dhe dallime.

Me këtë Projektligj lojërat e fatit do të vëhen në sistemin institucional dhe në një mbikëqyrje të përhershme dhe rigoroze të Qeverisë përmes Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrisë për Tregti dhe Industri.

Ky Projektligj ka 8 kapituj dhe 63 nene, në të cilat përcaktohen dhe rregullohen kushtet dhe subjektet të cilët organizojnë lojërat me fat, llojet e lojërave me fat, principet themelore të rregullave mbi ndarjen e të hyrave nga lojërat me fat, pastaj themelimi, pozita juridike,

drejtimi dhe menaxhimi i Lotarisë së Kosovës, kompensimi për kryerjen e veprimtarisë së lojërave me fat, mbikëqyrja, dënimet për kundërvajtje, si dhe çështjet tjera me rëndësi për organizimin e lojërave me fat në Kosovë.

Veprimtaria e lojërave me fat në territorin e Kosovës realizohen përmes Lotarisë së Kosovës si dhe subjekteve tjerë juridik të regjistruar dhe liçencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Si lojëra me fat me këtë ligj nënkuptohen lojërat me të cilat pjesëmarrësve iu ofrohet mundësia e fitimit në të holla, pastaj fitimi i sendeve ose të drejtave në atë mënyrë që rezultati përfundimtar i lojërave të varet nga dijenia dhe shkathtësia e pjesëmarrësit në lojëra, por edhe nga rasti i rezultatit të panjohur.

Fsipas këtij Fprojektligji, lojërat me fat janë radhitur në tri grupe: a) lojërat klasike me fat; b) lojërat e veçanta me fat dhe c) lojërat tjera elektronike.

Kur përmendim lojërat klasike, për ndryshim nga ato klasike me fat në të cilat marrin pjesë numër i madh i pjesëmarrësve, me qëllim të fitojnë fitimin kryesor ose shpërblime tjera të përcaktuara me fondin fitues, në lojëra me fat të llojeve të ndryshme, individit i kundërvëhet organizatorit dhe pret fitimin, në varësi prej lartësisë së depozitit të tij në lojërat me fat.

Mirëpo, në grupin e lojërave elektronike bëjnë pjesë lojërat të cilat zhvillohen përmes internetit dhe telefonisë mobile.

Lotaria e Kosovës është subjekti juridik dhe si i tillë është i regjistruar në Ministrinë për Tregti dhe Industri. Leja për kryerjen e veprimtarisë së lojërave me fat dhe organizimi i tre jipet nga Ministria për Ekonomi e Financa.

Qeveria është përgjegjëse për të gjitha obligimet e themeluesit të Lotarisë së Kosovës.

Në kreun 2 përkatësisht nenet 12-16 rregullohet veprimtaria e Lotarisë së Kosovës, e cila në përbërjen e saj ka Këshillin drejtues dhe drejtorin. Lotaria e Kosovës do të nxjerr statutin me të cilin do të rregullohen të rejtat dhe obligimet e Lotarisë së Kosovës.

Në kapitullin 3, respektivisht nga neni 17 deri 30 rregullohen lojërat klasike të fatit. Në këto nene rregullohet logaria, loto, keno dhe varianta e lojërave të tjera, prognoza sportive, sistemi i automatëve, tv-tombolla, bingo – tërheqja e fitimeve, fondi i fitimeve dhe pagesat e shtypja e tiketave dhe fletzave të ndryshme.

Në kapitullin 4, respektivisht nenin 31 deri në nenin 55 rregullohen lojërat e veçanta të fatit, si lojërat në kazino, lojërat e automatit dhe klubet e veçanta, basti dhe të gjithë ajo që lidhet me këto lojëra.

Në kapitullin 5, respektivisht nenet 56 deri 57 rregullohen kompensimet për ushtrimin e lojërave të fatit. Këtu parashihen shuma të pagesës që duhet të bëhen për marrjen e lejes.

Kapitulli 6, respektivisht neni 58 rregullon mbikëqyrjen e cila do të bëhet nga Ministria për Ekonomi e Financa.

Kapitulli 7, rregullon dispozitat ndëshkimore ku neni 57 parasheh që subjektet ekonomike të organizojnë lojërat e fatit pa leje, varësisht prej llojit të lojës së fatit të cilët do të gjobiten nga 35.000 deri në 70.000 euro.

Dhe kapitulli 8, rregullon dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Të nderuar deputetë, duke vlerësuar si çështje të domosdoshme dhe të nevojshme rregullimin e kësaj sfere përmes një ligji të tillë shumë specifik dhe me qëllim të ndërprerjes së organizimeve ilegale të këtyre veprimtarive, kërkojmë nga ju që të jepni përkrahjen për nismën e këtij Projektligji, i cili sigurisht se përmes mekanizmave të Kuvendit do të pësojë ndryshimet specifike për të cilat Kuvendi do të deklarohet. Ju falemnderit për vëmendjen tuaj.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër ju falemnderit. Ramadan Kelmendi, besoj në emër të LDK? E keni fjalën Ramadan.

RAMADAN KELMENDI:

Ju falemnderit kryetar. I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe minsitra, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar dhe analizuar propozimligjin mbi lojërat e fatit dhe mbështetur në përmbajtjen që ofron ky propozimligj ka konkluduar se Lidhja Demokratike, ndonëse ka disa vërejtje dhe sygjerime parimore, propozon që në fazën e parë të shqyrtimit ta përkrahë dhe përmes shqyrtimeve në komisionin funksional të Kuvendit do të paraqesë amendamente me qëllim të begatimit të tij më të mirë.

Njëherit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, vlerëson se është mirë që institucionet e Kosovës sjellin në Kuvend propozimligjin për lojërat e fatit, me qëllim që përmes ligjit të parandalohet mashtrimi, lajthimi, gënjeshttrat dhe format tjera të krimit të organizuar, përmes lojërave jashtligjore dhe jashtëpërcjellëse nga ana e institucioneve të Kosovës.

Ajo që na brengosë është fakti se sa do të arrihet në eliminimin e këtyre dukurive me këtë propozimligj në mungesë të zbatimeve të ligjeve praktike dhe mekanizmave aplikuese për realizimin e tij. Është e ditur se çdo përfitim që arrihet pa punë, pa djersë, pa angazhim, është i ndaluar dhe në kundërshtim me ligjet e ekonomisë së tregut dhe shumë ligje të aprovuara në këtë Kuvend. Dhe vetë fakti se shqyrtimi i propozimligjit mbi lojërat e fatit shtron pyetjen se a kemi të drejtë që qytetarët në këtë gjendje të rëndë ekonomike të orientohen në fat të pafat, në këtë sistem manipulues profiter të lojërave të fatit. Ajo që e mbron dhe brengos është fakti se propozimligji në fjalë nuk përcakton në mënyrë të drejtë metodat e përcjelljes së fondit, xhirollogarive të lojërave të fatit, në cilat fonde derdhen ato mjete, si bëhet regjistrimi i tyre, sa paguhet tatimi në fitim, në pronë, në depozit, cilat janë kriteret e shpërndarjes së fitimeve, e tjera.

Për të gjitha këto pyetje, në procedurë të amendamentimit do të përcaktohen edhe përgjegjësitë. Në veçanti statusi i lojërave të Kosovës në këtë propozimligj është i përcaktuar si i mangët dhe se përgjegjësit dhe mënyrat e zgjedhjes së bordit të drejtorëve është mjaft i paqartë. Në propozimligj ka formulime të dykuptimta që lënë mundësi të keqpinterpretimeve, si për shembull – “lojërat mund të jenë” në vend se “lojërat është e definuar” dhe të gjitha këto në lojërat e fatit për shumicën sjellin pafat dhe mashtrim.

Vlerësojmë se mbikëqyrja e lojërave të fatit, që nga procesi i themelimit, financimit, inkasimit të mjeteve të bëhen nga Ministria për ekonomi e financa, e cila do të kishte kompetenca shumë më të mëdha në këtë drejtim për zbatimin e këtij ligji.

Ndonëse nuk kemi ligj mbi mediat, do të ishte mirë që lojërat e fatit mos të reklamohen e as emitohen në TV e shtyp, sepse në këtë mënyrë nxitet ajo që quhet fat mashtrues dhe është i ndëshkueshëm me të gjitha ligjet e mirëfillta botërore.

Së fundi, Grupi Parlamentar i LDK, duke përkrahur në parim propozimligjin për lojërat e fatit, do të paraqesë amendamentet me të cilat do ta begatojë dhe pasurojë këtë propozimligj. Ju falënderoj për dëgjim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit shumë. Në emër të partisë Demokratike shpresoj Berat Luzha. Urdhëroni Berat.

BERAT LUZHA:

Qysh në fillim theksojmë se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike miraton në parim këtë Projektligj. Megjithatë, kemi disa vërejtje, dhe sidomos mendojmë se jemi të rezervuar në lojërat kazino dhe bixhozet tjera, të cilat nuk do të duhej të kishin vend këtu në Kosovë, për shkak se në këtë rast njerëzit nuk i humbin gjysmë euro apo një euro por humbin edhe shtëpinë. Këtu do të ishte mirë që të shikohet në komisione dhe të bëhen amendamente për heqjen e disa pjesëve.

Në nenin 42, kemi një pasaktësi ku thuhet se “shtatë ditë pune në të cilat nuk punohet” kurse në anglisht dhe në serbisht nuk e kemi këtë formullim – vetëm thuhet “shtatë ditë”. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Naim Maloku, pastaj Haki Shatri.

NAIM MALOKU:

Falemnderit zoti kryetar. Të nderuar ministra, kolegë deputetë, Mendojmë se është mirë që para nesh sot gjendet ky Projektligj për faktin se lojërat e fatit, të formave dhe mënyrave të ndryshme janë organizuar menjëherë lojërat pas përfundimit të konfliktit në Kosovë, pra këto pesë vitet e kaluara dhe është mirë që më në fund Qeveria e Kosovës, Ministria përkatëse – ka vendosur që këto lojëra praktikisht të vëhen në korniza ligjore dhe të sanksionohen edhe me ligj, për shkak se ka hapësirë për dyshime në krejt format e organizimit të këtyre lojërave në pesë vitet e kaluara.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK të jap dy sygjerime.

Në nenin 12, nën 1, ku thuhet “lotaria e Kosovës është subjekt juridik publik me interes të veçantë për Kosovën” mendojmë se duhet të hiqet kjo “me interes të veçantë për Kosovën” – mos t’i jipet një trajtim aq i rëndësishëm për Kosovën i lojërave të fatit.

Dhe sygjerimi tjetër, apo vërejtja – te nenet që kanë të bëjnë me fondin e fitimeve. Fondi i fitimeve, siç është i përcaktuar me këtë ligj, është nga 50 deri në 70% nga shuma e cila është e inkasuar nga biletat lapo pjesëmarrja në lojërat e fatit. Shumë shtete në këto lojëra të fatit pasurohen edhe fondet për përkrahje të kategorive të shoqërisë që kanë kërkesa të veçanta, siç janë shoqatat e të verbërve, pastaj të të hendikepuarve. Pra, kategoritë e shoqërisë të cilat kanë nevojë dhe kanë kërkesa të veçanta.

Mendoj se me këtë Projektligj nuk janë paraparë fonde të tilla dhe ne si Grup Parlamentar i AAK mendojmë se është mirë që një përqindje nga shuma e inkasuar e përgjithshme nga lojërat e fatit të sanksionohet me ligj që të ndahen për ato kategori të veçanta të shoqërisë, sepse kishte me qenë kontribut humanitar, pra për ato kategori të shoqërisë.

Dhe, në fund – përkrahim në parim miratimin e këtij Projektligji dhe lusim komisionet parlamentare, si atë funksional, ashtu edhe të buxhetit që ta kenë parasyshë këtë sygjërim tonin për ndarjen e një fondi të veçantë për këto kategori. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se ta marrë fjalën Shatri, lus deputetët të cilët janë në hol, të kthehen në sallë, sepse vazhdimisht jemi në greminë të kuorumit, dhe pas votimit do të marrim një vendim tjetër. Urdhëroni Shatri. Le të bëhet gati Hasan Meta.

HAKI SHATRI:

Falemnderit zoti kryetar. Në fillim dua të shpreh përkrahjen time për Projektligjin dhe të përkrah edhe fjalën – ekspozenë e zotit ministër lidhur me materien që po e diskutojmë.

Që në fillim, parimisht desha t'i them dy-tri gjëra, të cilat mendoj se duhet të kihen parasysh gjatë punës në komisione.

Si kryesues i Komisionit për buxhet, më shqetëson një gjë, e cila në ligj nuk është qartësuar mjaft. Thuhet se 60% e parave do të ndahen në fondin e fitimit të fituesve që do të marrin pjesë në lojërat e fatit, kurse 40% duhet të përdoren për qëllime sociale, si për invalid të luftës, të të drejtave të njeriut, aktiviteteve kulturore sportive e tjera, dhe se kjo materie do të rregullohet me një vendim të ministrit të financave se si dhe në çfarë shume dhe kujt do t'i ndahet.

Unë mendoj se kjo mënyrë e ndarjes duhet të bëhet në Projektligj, të jetë decidivisht e qartë se 40% që buron nga lojërat e fatit kujt do t'i ndahen.

Çështje tjetër, e cila po ashtu është shqetësuese dhe se duhet të korrigjohet gjatë punës, është çështja e organit menaxhues. Ne këtu kemi një bord dhe një drejtor menaxhues. Për ne është shumë më e pranueshme dhe më e qartë dhe më afër logjikës së pranimit bordi i cili edhe pse ka mjaft kompetenca të gjera shpërndahet përgjegjësia dhe atë e marrin më shumë njerëz, dhe mundësia për të keqpërdorur ose për të vepruar në mënyrë të njëanshme është më e vogël. Por, në bazë të parimit që është shfrytëzuar deri më tash në punën e Kuvendit kur kemi vendos për themelimin e bordeve, mendoj se edhe në këtë rast Kuvendi duhet të përcaktohet për formën praktike të deritashme. Bordi të propozohet nga Qeveria dhe të miratohet nga Kuvendi, meqenëse përgjegjësia është shumë e madhe dhe ky bord duhet të përgjigjet para tërë popullit të Kosovës e jo vetëm para një ministrie të caktuar ciladoqoftë ajo.

Dhe, çështja e fundit, që është propozuar në projektligj e që ka të bëjë me regjistrimin dhe licencimin e lojërave të fatit, më duket se ka mbetur pak e paqartë dhe me dilema. Diku përmendet regjistrimi te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, pastaj vendimin do ta marrë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Është krejt në rregull, por mendoj se duhet të jetë shumë më e qartë procedura e regjistrimit si do të shkojë.

Duke e përkrahur, ju falënderoj për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe zoti Hasan Meta.

HASAN META:

Ju falemnderit, zoti kryetar. Unë mbështes çdo ligj që vë gjërat, dukuritë e ndryshme nën kontroll dhe sidomos lojërat e fatit, që si duket është degë kryesore ekonomike në Kosovë, ku participojnë shumica e qytetarëve të Kosovës!

Më kujtohet, herë te kam dëgjaur prej pleqve – buxheti i një mreti, diku atje, nuk është plotësuar, kanë thënë që qytetarët janë shumë të pasur e çka të bëjmë... Mreti u ka thënë hapni kafene. Është e mirë, por siç e dini të gjithë, edhe përpara ata njerëz që me të vërtetë kanë probleme ekzistenciale e provojnë edhe fatin në lojëra të ndryshme. Kjo dukuri nuk është vetëm te ne, por ne po dojmë të hyjmë në shoqëritë moderne dhe është e mirë që ta kemi nën kontroll këtë lëmi.

Në anën tjetër, premtime të dhëna nga garuesit për pushtet dhe qeverisje demokratike në Kosovë nuk janë plotësuar në asnjë aspekt. Është mundësia që qytetarët e Kosovës, pasi që kanë papunësi të madhe të pasurohen me lojëra të fatit. Dhe nga këtu mund të them se qytetarit i mbetet vetëm që të gërvishet dhe të fishkëllon. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit shumë. Unë ju ftoj, i kam të regjistruar të pranishëm 62 deputetë, të deklarohe mi.

Kush është për aprovim në parim? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Nuk ka asnjë kundër.

A abstenon ndokush? Nuk abstenon askush.

Prandaj, konsideroj se futet në procedurë të mëtejshme.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained.....00

Para se të vazhdojmë, është bërë një konsultë e vogël këtu në Kryesi të punës. Jam i mendimit të propozoj, nëse pranoni se i kemi edhe gjashtë pika në rend dite, po humb cilësia e punës, ta ndërprejmë dhe nesër në ora 9, ju lutem për shkak të asaj që është e premtë të vazhdojmë. Pasi po propozoni, atëherë e lëmë në orën 10, mirë e keni.

(Seanca ndërpreu punën për të vazhduar të nesërmen)

(Seanca vazhdoi punën të nesërmen në orën 10,00)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Vazhdojmë punën e Seancës plenare me rendin e caktuar të ditës.

Mirëseardhje deputetëve dhe ministrës për shëndetësi.

Fillojmë me – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 7 korrik 2004, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Ftoj ministreshën e shëndetësisë, doktor Resmije Mumxhi që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve ta prezentojë Projektligjin. Foltorja është e juaja, ministreshë.

RESMIE MUMXHI:

E nderuara Kryesi, i nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë, Përshëndes hapjen e procedurës në Parlament për miratimin e ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, dokument tejet i rëndësishëm ligjor për kujdesin shëndetësor të qytetarëve, për sektorin shëndetësor dhe për Kosovën në tërësi.

Fillimisht dua të theksoj se të kuptuarit e kontekstit aktual të shëndetësisë paraqet faktorin esencial me rastin e marrjes së vendimit për fillimin e punës në këtë Projektligj. Është arritur përparimi në të gjitha fushat e kujdesit shëndetësor duke siguruar kujdesin shëndetësor të vazhdueshëm dhe pa pagesë për të gjithë qytetarët. Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u mbështetur në ruajtjen dhe përparimin e gjendjes së tërësishme shëndetësore mbi baza të arritura bashkëkohore mjekësore dhe sigurimit të kushteve për sendërtimin e tyre në praktikë. Janë arritur rezultate të konsiderueshme në përparimin e shëndetit. Megjithatë dhe përkundër këtyre të arriturave, sektori përballlet me një mori vështirësish të natyrës objektive dhe subjektive dhe mund të them se në përgjithësi nuk po sigurohen kushtet themelore për përmirësimin e konsiderueshëm të nivelit të kujdesit shëndetësor që do të cilësohet me satisfaksion të duhur të qytetarëve. E gjithë kjo reflektohet me humbje graduale të besimit të qytetarëve në sistemin publik të kujdesit shëndetësor.

Disa qasje dhe dukuri të skajshme në sektorin po e ashpërsojnë edhe më tepër këtë situatë. Përpilimi i legjislacionit gjithpërfshirës në lëmin e të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve në kujdesin shëndetësor përkon me synimin e Qeverisë së Kosovës për të siguruar rrespektimin e plotë të të drejtave të njeriut në kuadër të sistemit të kujdesit shëndetësor.

Legjislacioni ekzistues nuk ka siguruar kornizë të qëndrueshme ligjore për ta realizuar këtë qëllim. Si rezultat i kësaj, kemi qenë dëshmitar të sjelljeve të palejueshme të të drejtave të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Njëkohësisht, përgjegjësitë e qytetarëve gjatë këtij procesi nuk kanë qenë qartë të përcaktuara. Kjo ka rezultuar me shpërndarjen e barabart të përgjegjësi ndërmjet ofruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.

Projektligji që gjendet para jush, përnanga natyra dhe globalizmi i çështjeve do të sigurojë qëndrueshmëri dhe mbështetje për një sistem efikas dhe ligjor në lëmin e rrespektimit të të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve brenda sektorit të shëndetësisë.

Projektligji ka ngjall interesim të duhur dhe ka siguruar mbështetje të gjerë në diskutimin publik. Draftprojektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor krijon bazën e domosdoshme ligjore për mbështetje e zbatim të ligjit për shëndetin në Kosovë, rrespektimin e konventave relevante ndërkombëtare në lëmin e të drejtave të njeriut, si dhe reformat e filluara në sektorin e shëndetësisë.

Projektligji sliguron hapësirë ligjore për përfshirje të gjerë të shoqërisë civile në procesin e sigurimit të të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe me këtë paraqet hap të rëndësishëm kualitativ në përmbushjen e standardeve më demokratike të një shoqërie të përparuar.

Është shumë e qartë se arritja e standardeve më të larta ndërkombëtare në këtë lëmi imponon nevojën e përparimit të mëtutjeshëm sistematik të gjendjes së përgjithshme në sektorin e shëndetësisë.

Sipas vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtar, me këtë ligj Kosova vendoset në kreun e shteteve evropiane sa i përket rregullimit ligjor të të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve në kujdesin shëndetësor.

Zonja dhe zotrinj,

Objektiva që mbështet Ministria e Shëndetësisë me këtë Projektligj, si dhe qëndrueshmëria, efikasiteti dhe ligjshmëria e sistemit do të sigurohet nëpërmjet:

- a) përcaktimit të të drejtave të qytetarëve në kujdesin shëndetësor, si vijon: e drejta në kujdesin cilësor shëndetësor; e drejta e zgjedhjes; e drejta në denjëtetin njerëzor; e drejta e komunikimit; e drejta e largimit nga institucioni; e drejta për të qenë i informuar; e drejta e vendimit personal; e drejta e refuzimit të dhënies së pëlqimit; e drejta e qasjes ndaj dokumentacionit shëndetësor dhe e drejta e ruajtjes së sektorit dhe aspektit privat;
- b) përcaktimit të përgjegjësi të qytetarëve në kujdesin shëndetësor si vijon: rrespektimi i dispozitave ligjore në kujdesin shëndetësor; bashkëpunimi i plotë me punëtorët shëndetësor në mënyrën qartë të përcaktuar; rrespektimi i plotë i të drejtave të punëtorve shëndetësor dhe të qytetarëve tjerë me të cilët vijnë në kontakt gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor; dhe
- c) sigurimit të zbatimit të të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve në kujdesin shëndetësor në mënyrën si vijon: rregullimi i procedurave për ankesa të qytetarëve; definimi i konceptit të dëmit dhe mundësimi i parashtrimit të kërkesave për dëmshpërblim nga ana e qytetarëve; themelimi i komisionit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmit të shkaktura gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor; përcaktimi i obaligimit të sigurimit të institucioneve shëndetësore ndaj përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përcaktimi i procedurave për kompensimin e dëmit dhe pagesën e dëmshpërblimit.

Mbështetja institucionale sigurohet dhe udhëheqet me zbatimin e politikave të kujdesit shëndetësor të cilat në këtë Projektligj i ndërmarrin Minsitria e Shëndetësisë, institucionet shëndetësore, punëtorët shëndetësor dhe qytetarët. Mbështetja juridike konsiston në ushtrimin e rregulloreve të obligimeve dhe përgjegjësi në punë, obligimet për sigurimin e

institucioneve shëndetësore ndaj përgjegjësive civile për dëmin e shkaktuar gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në to, si dhe në dispozitat ndëshkuese në rast të mospërbushjes së dispozitave të këtij Projektligji.

Me qëllim të rumbullaksimit të infrastrukturës ligjore e cila del nga ky Projektligj, Ministria e Shëndetësisë duhet të nxjerrë udhëzime administrative si vijon:

- menaxhimin dhe kujdesin për të dhënat personale të qytetarëve nga ana e institucionit shëndetësor;
- komisioni për vlerësime dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj shëndetit të qytetarëve gjatë trajtimit mjekësor dhe udhëzimin administrativ

Vlerësimin dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj shëndetit të qytetarëve gjatë trajtimit mjekësor dhe udhëzimin administrativ, fondi i ministrisë së shëndetësisë për kompensimin e dëmeve të shkaktuara ndaj shëndetit të qytetarëve gjatë trajtimit mjekësor që Ministria e Shëndetësisë duhet ta nxjerrë së bashku me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Duke përfunduar, mbështes bindjen që diskutimi dhe propozimi juaj do të plotësojë fushat e veprimit të këtij Projektligji në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministreshë ju falemnderit.

Hap debatin për diskutim në parim të Projektligjit. Me kënaqësi po filloj prej grupit më të vogël. Urdhëroni Nafije.

NAFIJE GAŞ:

Saim başkan, derli millet ve kirlerim,

Kolegë deputetë, shumë të nderuar dhe shumë të rrespektuar,

Si kryetare e Komisionit të shëndetësisë i jap përkrahje miratimit të Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, si një ligj shumë i rëndësishëm për popullsinë e Kosovës që ndihmon në rumbullaksimin e gjithë lëmisë së mbrojtjes shëndetësore.

Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor synon të rregullojë këtë fushë shumë të rëndësishme duke rrespektuar në mënyrë të plotë të drejtat e njeriut pa bërë asnjë dallim në kuadër të sistemit të kujdesit shëndetësor.

Nga vështrimi i parë, mund të konkludohet se ky Projektligj e plotëson formën e parashtrimit; se është i harmonizuar me rregullativën ligjore të aprovuar deri tash nga ky Kuvend dhe në fazën deri në shqyrtimin e dytë do të bëhen shqyrtime dhe përmirësime të nevojshme duke inkorporuar specifikat kosovare, duke rrespektuar denjëtetin e qytetarit dhe duke rrespektuar traditën, kulturën dhe mentalitetin kosovar, por duke inkorporuar edhe tëa rriturat evropiane në këtë lëmi, krejt këtë në funksion të ofrimit të ndihmës dhe kujdesit shëndetësor që është në interes të qytetarëve dhe në interes të mjedisit dhe të Kosovës në përgjithësi.

Tërheq vërejtjen për një lëshim, që besoj se do të evitohet në ndërkohë. Në nenin 7, paragrafi 6, thuhet se “në rast se rregullativat operative të institucionit shëndetësor me shtretë nuk e përcaktojnë ndryshe, qytetari ka të drejtë që të përdorë veshjen e tij si dhe pajisjet personale”,

ndërsa unë konsideroj se në të gjitha institucionet shëndetësore, si për personelin, ashtu edhe për pacientët duhet të përcaktohet qartë veshja e përshtatshme përkatësisht veshja unike e spitalit, që do të plotësonte kriteret e veshjes funksionale dhe të pastërt dhe që do ta identifikonte qartë institucionin shëndetësor, e jo që nëpër institucionet tona shëndetësore secili të sillet me rroba të tij të pastra apo të papastërta, me këpucë apo çizme, me që kërcasin apo jo, e tjera – e tjera, e gjithashtu edhe mjetet personale që i bart patienti duhet të përcaktohen qartë se cilat janë ato që të mos pengohen patientët tjerë apo personeli. Këtë mendoj për radio e kasetofon, lap-top e mjete tjera apo edhe mjete të mprehta në dhomën e patientit e të ngjashme.

Pra, në fund e kam edhe një lavdëratë për sponsoruesin, sepse për herë të parë na vjen një tekst i rregulluar shumëmirë gjuhësisht dhe i lektoruar. Pra këtë herë na kanë kursyer edhe neve si Komision që të mos humbasim kohë me përmirësime gjuhësore. Prandaj, përkrah që ky Projektligj të miratohet në parim. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju falemnderit edhe për korrigjim sepse Nafija nuk është shefe e grupit parlamentar, por në emër të Komisionit e ka prioritetin. E ka fjalën Naim Jerliu, besoj në emër të Lidhjes Demokratike. Le të përgatitet Zylfije Hundozi.

NAIM JERLIU:

I nderuar zoti kryetar, e nderuar zonja ministre, kolegë deputetë, Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor trivon nga ligji për shëndetësi i Kosovës si ligj bazik për shëndetësinë dhe ky ligj synon krijimin e bazës për rrespektimin e konventave relevante ndërkombëtare në lëminë e të drejtave të njeriut, në këtë rast duke rrespektuar të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit në sistemin e kujdesit shëndetësor.

Ky Projektligj, përmes katër kapitujve të vetë, mund të thuhet se bën përpjekje t'i adresojë në mënyrë sa më të gjerë problemet që kanë të bëjnë si me të drejtat ashtu edhe me përgjegjësitë e qytetarit në kujdesin shëndetësor.

Megjithatë, duke qenë se fusha e cila trajtohet është tejet e ndieshme, sigurisht se ka vend që të përiqemi për një përfshirje edhe më të gjerë dhe më të duhur të kësaj problematike në shqyrtimin e mëtejshëm – në leximin e dytë.

Duke qenë se deri më tash ka patur një mungesë të legjislacionit të kësaj fushe dhe trajtimit të problematikës me të cilën merret Projektligji, sigurisht se miratimi i këtij ligji do të jetë shumë i rëndësishëm për procesin do të thojë të transformimit të mëtejshëm të sistemit shëndetësor në Kosovë dhe duke patur parasysh gjendjen e rëndë në të cilën gjendet sot shëndetësia kosovare, ky Projektligj dhe miratimi i tij do të jetë mjaft sfidues për t'u vënë në jetë dhe për t'u zbatuar si nga ana e institucioneve ashtu edhe personelit të kësaj fushe, por edhe nga vetë qytetarët të cilët për herë të parë me këtë ligj do të kenë mundësinë më të mirë të realizimit të të drejtave të tyre në sektorin shëndetësor.

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK të theksoj se ky Projektligj i plotëson kushtet për miratimin e tij në parim në shqyrtimin e parë dhe se do të kontribuojmë që në procesin e shqyrtimit të mëtejshëm të amendamentohet dhe të bëhet sa më komplet dhe më i aplikueshëm që të jetë e mundur. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Naim ju falemndeit. Proferoresha Zylfije, le të bëhet gati doktor Sejdullah Hoxha.

ZYLFJE HUNDOZI:

Të falemnderit zotni kretar. Kolegë të nderuar, Gjer më tani, kësaj lëmie të kujdesit shëndetësor nuk i është dhënë rëndësi. Legjislacioni i cili ka ekzistuar edhe pse nuk ka qenë gjithpërfshirës si ky Projektligj që kemi sot, rallherë është përdorur. Qytetarët rrallë janë ankuar për dëmet që i kanë pësuar nga shërbimet joadekuate mjekësore dhe për rastet e vdekjes e vetmja ankesë ka qenë konstatimi: zoti e ka dhënë dhe zoti e ka marrë.

Nga ana tjetër, edhe vetë qytetarët, duke mos i përfillur rregullat e punës në institucionet shëndetësore, me sjelljet e tyre joadekuate, e kanë penguar punën e personelit shëndetësor.

Shumë shpesh, gjatë ekzaminimit dhe marrjes në pyetje, vetë pacientët nuk i kanë treguar të gjitha ankesat e pranishme, i kanë mëshetur simptomat dhe sëmundjet e mëparshme, sëmundjet trashëguese dhe kështu vetë kanë penguar shërimin e tyre. Këto veprime shpesh janë bërë për shkak të paragjyimit se personi i sëmurë është më pak i vlefshëm e ndonjëherë i kanë testuar aftësitë e mjekut për gjetjen e sëmundjes pa ia treguar të vërtetën.

Miratimi në Parlament dhe zbatimi në praktikë i këtij Projektligji, do të ndihmojë në përmirësimin e kujdesit shëndetësor në përgjithësi.

Ne si Grup Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i kemi edhe disa vërejtje.

Kapitulli për të drejtat në denjëtetin njerëzor është i shkurtër dhe i përgjithësuar. Kjo është dashur të jetë esenca dhe burimi i këtij Projektligji. Çka i mbetet njeriut kur i humbet denjëtetin, a ka diçka më të rëndësishme.

Te e drejta e vendimit personal. Thuhet se qytetari mund të japë pëlqimin gojarisht, me shkrim ose me sjellje, e cila e nënkupton pëlqimin. Cilat janë ato sjellje që e zëvendësojnë të folurit dhe pëlqimin me shkrim? Te një veprim serioz, siç është pëlqimi për operacion ose trajtim psikiatrik nuk mund të ketë improvizime.

Te caktimi i nivelit të dëmshpërblimeve. Thuhet se komisioni nuk guxon ta caktojë dëmshpërreblimin vlera e të cilit e tejkalon vlerën e 15 pagave minimale mujore në Kosovë. Nëse dëmtimi është i rëndë dhe e ka bërë personin të paaftë për punë dhe jetë të pavarur, atëherë kjo shumë është qesharake dhe nuk do të jetë stimuluese që qytetarët e dëmtuar të ankohen ndonjëherë.

Dhe, te pjesa ku flitet për të drejtën e largimit nga institucioni, përdoret shprehja “aftësi e veprimit”. Kjo është përdorur edhe në Ligjin për familjen, por kjo shprehje nuk është adekuate, sepse njeriu mund të ketë aftësi fizike të punës, por të jetë në nivel të debilit ose idiotit, domethënë të mos ketë aftësi kualitative në të menduar. Prandaj, shprehja adekuate do të ishte “aftësia psiko-fizike e qytetarit për të vendosur drejt për veprimet e veta”.

Në përgjithësi ky Projektligj është punuar mirë dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim dhe në Komisionin përkatës do ta japim kontributin tonë për përmirësim të duhura. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Profesor Sejduallah Hoxha, le të bëhet gati doktoreshë Fetije Këpuska.

SEJDULLAH HOXHA:

Të falemnderit zotni kryetar. E nderuara ministre, të nderuara zonja dhe zotrinj, Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit në kujdesin shëndetësor paraqet një domosdoshmëri i cili së bashku me ligjet tjera të cilat janë aprovuar nga shëndetësia do të plotësojë dhe sadokudo do ta pasurojë legjislacionin edhe ashtu të varfër të shëndetësisë kosovare.

Shikuar në tërësi, Projektligji i propozuar paraqet një bazë të mirë që në procedurë të mëtejshme parlamentare, me amendamente, do të plotësohet ashtu që të bëhet sa më funksional dhe i aplikueshëm në praktikë, duke siguruar rrespektimin e plotë të të drejtave të njeriut në kuadër të sistemit të kujdesit shëndetësor.

Propozuesi i Projektligjit, gjatë hartimit, është kujdesur që ky Projektligj të jetë i qëndrueshëm dhe konpatibil, me standarde ndërkombëtare që është mëse e nevojshme.

Në të njëjtën kohë, propozuesi i Projektligjit në memorandumin shpjegues në pikën 5 thuhet: “Nuk është bërë ndonjë paralogaritje paraprake e shpenzimeve të cilat do të shkaktoheshin lidhur me këtë Projektligj”, kështu që edhe gjatë punës nëpër komisione duhet të kihet parasysh se kur kemi njohurit se për shembull vetëm për kokë të banorit për shëndetësin kosovare përafërsisht ndahen 27 deri 30 euro, ndërsa nëse dojmë të jemë kompatibil me Evropën – për kokë të banorit ndahen afër 3.000 euro, atëherë s’di sa do të jetë i aplikueshëm ky ligj.

Mirëpo, i bindur se nga ky Projektligj më së tepërmi do të fitojnë qytetarët dhe shëndetësia e Kosovës, unë personalisht dhe Grupi Parlamentar i PDK do ta përkrahim këtë ligj me shpresë se me amendamente do të përmirësohet dhe do të jetë më i begatshëm. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Doktor Fetije Këpuska, le të bëhet gati Nurishahe Hulaj.

FETIJE KËPUSKA:

Falemnderit zoti kryetar. Minsitra të nderuar, kolegë deputetë, E kam lexuar me vëmendje këtë Projektligj, të cilin në parim e përkrah me disa sygjerime. Qëllimi i ligjit është i definuar dhe i qartë, ofrimi i trajtimit dhe i mbrojtjes adekuate shëndetësore të qytetarëve.

Në pjesën hyrëse është theksuar me të drejtë se miratimi i këtij ligji është i domosdoshëm pasi që çështjet nga kjo lëmi duhet përfshirë brenda kontekstit ligjor. Me ligj janë përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve, por edhe të institucioneve përkatëse në kujdesin e plotë dhe adekuat shëndetësor.

Mendoj se Projektligji ka përfshirë në mënyrë të plotë parimet kryesore, mënyrën e organizimit dhe realizimin e mbrojtjes shëndetësore me të drejta dhe përgjegjësi të të gjithëve që përbëjnë këtë strukturë.

Mbrojtja shëndetësore e qytetarëve, në kuptimi në këtë dokumenti parqet një gamë të aktiviteteve, të masave dhe të veprimeve si të qytetarëve ashtu edhe të subjekteve të institucioneve përaktëse.

Me qëllim të ruajtjes dhe të avancimit të shëndetit, mendoj po ashtu se Projektligji u ofron të gjithë qytetarëve trajtim të barabartë. Është një ligj i qasjes së barabartë për të gjithë qytetarët, prandaj edhe nuk ka asnjë element diskriminimi në asnjë bazë.

Megjithatë, kam një përshtypje sikur Projektligji i prezentuar është i ndarë preraz, pothuaj kirurgjikisht në dy kapituj apo pjesë të pavarura e të shkëputura. Fjalën e kam për kapitullin Realizimi i të drejtave të qytetarëve dhe kapitullin vijues Përgjegjësia e qytetarëve në mbrojtjen shëndetësore. Mendoj se ka shumë aspekte e forma ndërlidhëse në mes këtyre dy kapitujve, ka shumë relacione të ndërvarura të pakuptueshme në mes të të drejtave dhe përgjegjësive dhe nuk janë evidentuar në këtë ligj.

Po ashtu mendoj se duhet theksuar më shumë në linjen e përbashkët të një ndërlidhjeje më të madhe në të gjitha subjektet e institucioneve në këtë rrafsh e që kanë emërues e qëllim të përbashkët – ruajtjen dhe avancimin e shëndetit të qytetarëve. Kështu sikur janë prezentaur ato sikur janë të pavarura, sikur nuk kanë ndërlidhje me subjektet dhe strukturat e institucioneve tjera që së bashku përbëjnë një sistem unik, të pandashëm shëndetësor. Fitohet përshtypja sikur secili mirret vetëm me veten, në punën e vet dhe sikur nuk i intersojnë hallkat tjera.

Prandaj, qytetari nuk guxon të trajtohet vetëm nga aspekti i të sëmuarit, por në tërë kompleksitetin dhe integritetin e tij.

Kam edhe një sygjërim. Në rast se pacientit i shkaktohet dëmi i shëndetit si pasojë e veprimit joadekuat të qëllimshëm apo nga neglizhenca e pakujdesia e skajshme nga personeli mjekësor, pos kompensimit adekuat material duhet paraparë edhe përgjegjësinë penale të personit dhe të institucionit që ka dëmtaur shëndetin e pacientit.

Sygjerimi, pyetja apo dilema ime e fundit ka të bëjë me mundësinë teorike që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë në përkujdesjen shëndetësore. Ky është rrafshi teorik, pra mundësia teorike, por çfarë është baza reale faktike e qytetarëve në këtë aspekt, kur dihet gjendja e katandosur materiale e shumicës së qytetarëve. Ata – pra qytetarët, janë teoretikisht të barabartë por këtë barazi realisht nuk mund ta realizojnë për arsye materiale. Dihet se një numër i madh i pacientëve objektivisht janë të privuar nga mundësia e shfrytëzimit të kujdesit shëndetësor sidomos nga shërbimet specialistike kur dihet se ato janë të kushtueshme ndërkaq qytetarët janë në gjendje shumë të vështirë materiale. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Nurishahe Hulaj dhe le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

NURISHAHE HULAJ:

Falemnderit i nderuari kryetar i Kuvendit, e nderuara Kryesi e Kuvendit, të nderuar deputetë, Për reformat e filluara në shëndetësi, ky Projektligj është i domosdoshëm dhe plotëson infrastrukturën ligjore shëndetësore e cila është ende e papërkryer duke ditur se ligji për shëndetësi është i aprovuar ka gati pesë muaj dhe ende s'është nënshkruar nga sekretari special.

Për të qenë i zbatueshëm ky Projektligj, i cili është shumë i rëndësishëm për të drejtat e qytetarëve për ta shfrytëzuar shërbimin shëndetësor, janë shumë të rëndësishme edhe pakot minimale të ligjeve të tjera dhe mendoj se duhet të shtohet aktiviteti procedues edhe i ligjeve të tjera për shëndetësi, meqenëse këto ligje e vëjnë edhe në korelacion zbatueshmërinë e ligjit për të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore dhe përgjegjësitë e qytetarit ndaj institucionit shëndetësor, pastaj këto ligje mund ti theksoj, sikur është ai për sigurimin e fondeve shëndetësore, që ne këtu në këtë ligj nuk e kemi hasë, ligji për praksën private që është shumë i rëndësishëm, sepse qytetari ka të drejtë të drejtohet për të drejtën e tij edhe në praksën private, ligji për sëmundjet ngjithëse gjegjësisht në kuadër të shëndetit publik – mendoj se me një avancim të tyre për procedim më të shtuar këto ligje do ta plotësojnë infrastrukturën edhe të këtij ligji dhe zbatueshmërinë më të shpejt të tij që është i domosdoshëm për qytetarin e Kosovës.

Një gjë tjetër, që nuk e kam vërejtur në këtë ligj, e që është shumë me rëndësi, është mungesa e grupit punues. Nuk i kemi emrat e grupit punues që kanë punuar në këtë ligj, por janë cekur disa parametra që janë konsultuar disa personel të ministrisë, që mendoj se nuk është transparente dhe mendoj se është dashur të jetë grupi punues sikur që ka qenë procedura edhe në ligjet tjera.

Po ashtu, një gjë që e kam vërejtur në këtë ligj është se institucioni i cili ofron të drejtën qytetarit për të shfrytëzuar shërbimet shëndetësore është paraqitur në mënyrë të përgjithësuar. Mendoj se këtu kam përshtypjen se është paraqitur vetëm në institucionin sekondar ku bëhen intervenimet për qytetarin gjegjësisht për pacientin pa u cekur nivelet e shërbimeve shëndetësore gjegjësisht të institucioneve shëndetësore të cilat i kemi në strategjinë dhe reformën shëndetësore, siç është niveli parësor, dytësor dhe tretësor.

Po ashtu, kam vërejtur se nuk është transparente edhe vlerësimi i shërimit të pacientëve – e drejta për shërim në vendet tjera jashtë Kosovës. Mendoj se këtu duhet vlerësuar edhe një parallogari buxhetore, por mendoj se në amendamentimin e ardhshëm do të plotësohet kjo pjesë deficitare e këtij ligji.

Prej kapitujve që janë paraqitur në ligj, e që janë gjithsej 4 kapituj, më i rëndësishmi se është kapitulli, sikur që unë vlerësova, i katërtë që trajton zbatimin e të drejtave të qytetarëve për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore, i cili parashihet në ligj që më 15 janar do të jetë në zbatueshmëri. Por, në ligjin e përgjithshëm të shëndetësisë parashihet që më 1 janar do të fillojë zbatimi edhe i ligjit për fondet shëndetësore dhe ai mendoj do ta plotësojë këtë dhe ligji do të startojë më 15 janar 2005 dhe do të jetë i zbatueshëm për qytetarin.

Duhet të theksoj këtu edhe një çështje se qytetari ka të drejtë edhe nga ana farmaceutike dhe ajo stomatologjike preventive që të ketë të drejtë të shfrytëzimit të këtyre shërbimeve, sidomos për listën esenciale të barnave të cilën qytetari ka të drejtë ta shfrytëzojë. Ajo çka shkruan në listën esenciale, duhet ofruar qytetarit për ta shfrytëzuar komplet pakon e asaj liste esenciale, të cilën mendoj ende nuk e kanë të plotë. Kaq, ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra, Parimisht pajtohem me diskutuesit paraprak por më lejoni që për këtë propozimligj t'i dhë edhe disa sygjerime, gjegjësisht vlerësime të mia nga këndi i së drejtës së qytetarit për mbrojtje shëndetësore.

Pasi që ligji për shëndetësi në Kosovë nuk po zbatohet si duhet dhe sa duhet, është dhe ishte e domosdoshme miratimi i Projektligjit për të drejtat e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, në të cilin do të krijohet një bazë juridike i rrespektimit të konventave ndërkombëtare për mbrojtje shëndetësore të qytetarëve.

Vlerësoj se e drejta në mbrojtjen shëndetësore është një ndër drejtat themelore, me rëndësi të posaçme njerëzore, e garantuar – siç u cek më parë edhe nga të drejtat ndërkombëtare por jo edhe e realizueshme aq sa duhet në Kosovë.

Qytetari, si pjesëtar i familjes dhe i shoqërisë, ka një rëndësi të madhe në sistemin e kujdesit shëndetësor, por në jetën e përditshme mungojnë rregullat dhe etika e mbrojtjes së shëndetit goftë atij individual apo institucional. Një kategori e qytetarëve janë të penguar apo të pamundësuar dhe nuk mund të marrin pjesë në mbrojtjen e shërbimit të nevojshëm shëndetësor për shkaqe të arsyeshme të shumta dhe në veçanti theksoj: – për shkak të participimit; dy – hartimit të listave të pritjes; tre – kompletimi i dokumentave të udhëtimit, pasaportave, vizave dhe formave të tjera; njoftësisë dhe familjarizmit.

Në praktikën e mbrojtjes shëndetësore, qytetari, ndonëse ka të drejtë, ai nuk mund të zgjedhë mjekun e dëshiruar apo institucionin e dëshiruar, nga se qytetari edhe pse deklarohet për shërim shëndetësor, mjekët – jo në të gjitha rastet, por në raste të theksuara, menjëherë atë e udhëzojnë në ambulanca të tyre private dhe këtu shkelet e drejta e mbrojtjes shëndetësore institucionale.

Në këtë propozimligj nuk janë përcaktuar të drejtat e komunikimit, vizitat e pacientëve në parburgime, vuajtjet e dënimit – të cilët si të sëmurë shërohen në institucione shëndetësore dhe e drejta e tyre për largim nga këto institucione. Qytetarit me aftësi të kufizuara duhet t'i kushtohet një kujdes më e madhe në përcjellje dhe kujdesin e shtuar.

Propozimligji nuk përcakton procedurat se si të mbrohen të drejtat në mbrojtjen shëndetësore kur është përcaktuar prioriteti dhe ai pikërisht nga mjekët nuk rrespektohet kujt t'i drejtohet pacienti dhe si ta realizojë të drejtën që veç është prioritare.

Vlerësoj se në rastet e sëmundjeve të rrezikshme për popullatën nuk ka nevojë dhe arsye të mirret pëlqimi paraprak i veprimt në mbrojtjen shëndetësore.

Propozimligji nuk definon mbrojtjen e të drejtave të anëtarit të familjes në mbrojtje shëndetësore dhe as të punëkërkesve të evidentuar në zyret komunale të punësimit, që sot në Kosovë është numër i madh i tyre që tërësisht janë të pambrojtur shëndetësore.

Vlerësoj se kompensimi i dëmit në mbrojtjen shëndetësore duhet orientuar edhe në barnatore, të cilat japin apo shesin barna jashtë afateve përdoruese, jo në cilësi dhe kualitet dhe me etiketa fallco.

Ky ligj duhet të aplikohet edhe në institucionet shtetërore publike dhe ato private. E drejta e mbrojtjes në gjyq për trajtim joadekuat dhe joprofesional, duhet të inkorporohet në këtë ligj.

Megjithkëto vërejtje, mendoj se ky ligj duhet të shkojë në këtë fazë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mungojnë dy kartela. 63 deputetë janë të pranishëm. Lus deputetët që mos ta lëshojnë sallën në momentin e vendimmarrjes. Kështu ngjau që dy deputetë, pak më parë, e lëshuan mbledhjen.

Ftoj deputetët që propozimin ta përkrahim në parim.

Kush është për? Ju falemnderit.

Po shihet që s'ka asnjë votë kundër.

Megjithatë, a ka ka ndokush kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For Të gjithë – Svi - All

Kundër – Protiv – Against.....00

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për avokatinë.

Projektligji i propozuar nga Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kushtetutë, iu është shpërndarë deputetëve më 13 korrik, prandaj janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Ftoj deputeten Nekibe Kelmendi që në emër të Komisionit legjislativ ta paraqesë propozimin e Komisionit funksional. Urdhëroni...

NEKIBE KELMENDI:

Siç e tha edhe kryetari i Parlamentit, sponsorues i këtij ligji është Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe kornizë kushtetuese, bashkë me Odën e avokatëve dhe komunitetin e juristëve.

Avokatia është shërbim i pavarur, i cili siguron dhënien e ndihmës juridike-profesionale qytetarëve dhe subjekteve të tjera juridike në drejtim të realizimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe të interesave të bazuara në ligj.

Veprimtaria profesionale e avokatëve nuk përqëndrohet vetëm në mbrojtjen e interesave të klientëve të tyre. Ata janë vetëm pjesë e drejtësisë në shoqërinë demokratike.

Në shpjegimin e nocionit të avokaturës në të drejtën gjermane, avokatia kategorizohet si organ i pavarur i drejtësisë. Për arsye të përgjegjësive së madhe të punës së tyre, ata i nënshtrohen një rregullative të posaçme për ndryshim nga entitetet tjera tregtare dhe ekonomi në shoqëri. Kjo rregullativë ka funksion të dyfishtë. Në njërin anë, ajo siguron ruajtjen e rendit juridik në shoqëri përmes mbikëqyrjes së punës së avokatëve dhe në anën tjetër përpjeket për ruajtjen e ekzistencës ekonomike të avokatëve duke rregulluar dhe siguruar konkurrencën e arsyeshme në mes të avokatëve. Instanca rregullative e cila i rregullon këto vlera në rajonin e Kosovës, që u formua në bazë të ligjit mbi avokaturën të vitit 1973 dhe e cila ende vepron në bazë të këtij ligji, në të gjitha shtetet tjera demokratike avokatët gjithashtu janë të organizuar në formë të Odës së Avokatëve të Kosovës. Oda e Avokatëve angazhohet në mbrojtjen e rolit të avokatëve në shoqëri dhe në ruajtjen e pavarësisë së profesionit, në ruajtjen dhe mbrojtjen e denjëtit të pushtetit gjyqësor dhe në garantimin e së drejtës së qytetarëve për t’iu drejtuar drejtësisë dhe sidomos shërbimeve të ndihmës gjyqësore dhe juridike. Oda e avokatëve përmes ligjit, në shumë shtete demokratike rregullon dhe kontrollon veprimtarinë profesionale të avokatëve. Kodi i etikës së avokatëve sanksionon veprimtarinë etike të avokatëve. Kjo komponentë është shumë me rëndësi për çdo shoqëri demokratike nga se në këtë mënyrë rritet prestigji i avokatëve dhe sigurohet besimi tek qytetarët dhe profesionistët juridik. Qytetarët, në këtë mënyrë, binden për nevojshmërinë dhe profesionalitetin e avokatëve duke iu besuar atyre për përfaqësimin e interesave të tyre legjitime para institucioneve. Inkuadrimi i institucioneve në zgjidhjen e problemeve në mes individëve dhe entiteteve të tjera është çështje problematike, sidomos për të ashtuquajtuat demokracitë e reja, në të cilat institucionet shtetërore ende nuk e kanë arritur shkallën e mjaftueshme të zhvillimit dhe stabilitetit ose janë në ndërtim e sipër.

Avokatia në Kosovë.- Njëra ndër çështjet themelore për funksionimin efikas dhe të drejtë të profesionit të avokaturës është ekzistimi i bazës ligjore për të. Mementalisht, në Kosovë është ende i aplikueshëm ligji mbi avokaturën i vitit 1973. Me këtë rast duhet t’ju njoftoj se ky ligj nuk ka pushuar me masat që i merrte Serbia atëherë gjatë rrënimit të autonomisë së Kosovës, kështu që Oda e Avokatëve të Kosovës ka qenë autonome dhe ka funksionuar gjatë tërë kohës si institucion apo institucion i vetëm i Kosovës.

Ligji mbi avokaturën nuk ka pësuar asnjë ndryshim gjer më tani në mënyrë që t’i përshtatet rrethanave të reja në Kosovë. Andaj, shumë pjesë të këtij ligji janë të pazbatueshme duke patur parasysh ndryshimet e gjertanishme të sistemit ekonomik, politik dhe juridik.

Ky ligj, gjithashtu, nuk është në pajtueshmëri të plotë me vlerat e përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane lidhur me profesionin e avokatit dhe të drejtat themelore të njeriut.

Për shkak të pazbatueshmërisë së këtij ligji, në rrethana të reja të krijuar anë Kosovë, janë shfaqur deformime, komercializime dhe keqpërdorime të shumta në kuadër të ushtrimit të profesionit së avokatit.

Oda e Avokatëve, në vitet e fundit, ka marrë ankesa të shumta nga institucionet, organizatat, individët dhe vetë avokatët mbi problemet dhe dukuritë negative në profesionin e avokaturës. Kjo gjendje duhet të sanohet sa më shpejt me qëllim të denjëtit dhe besueshmërisë së këtij profesioni me qëllim të nxitjes së profesionalitetit, moralit, etikës, disiplinës në profesionin e avokaturës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut.

Prandaj, është mëse e nevojshme të nxirret një ligj i ri, modern – i cili është në pajtueshmëri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Është e rëndësishme të theksohet se Oda e Avokatëve të Kosovës është pjesëmarrëse aktive në përgatitjen e këtij Projektligji. Ky Projektligj është produkt i bashkëpunimit të Odës së Avokatëve, Grupit Parlamentar për kornizë kushtetuese, drejtësi dhe Grupit të ekspertëve ligjor të Institutit ligjor të Kosovës. Projektligji është li harmonizuar me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në këtë lëmi.

Fusha rregullative e Projektligjit.- Në kreun e parë janë të përcaktuara parimet themelore të avokaturës. Për shkak të rëndësisë së posaçme që ka avokatura në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe forcimit të shtetit ligjor, ushtrimi i profesionit të avokatit, në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare, ajo është e organizuar si një veprimtari private, e lirë dhe e pavarur. Liria e ushtrimit të këtij profesioni garantohet me pavarësinë e tij në punë, ndërkaq pavarësia me organizimin e avokatëve në Odën e Avokatëve dhe garantimin e vetëadministrimit të kësaj organizate.

Ky Projektligj, në kreun e dytë, sanksionon monopolin e avokatëve në dhënien e ndihmës juridike me qëllim të garantimit të mbrojtjes së interesave të klientëve dhe të garantimit të institucionalizimit të së drejtës për qasje të barabartë në drejtësi.

Dispozitat mbi kushtet e regjistrimit, kanë për qëllim rritjen e kualitetit dhe profesionalitetit në punë, ruajtjen e prestigjit të avokatit në shoqëri dhe mbrojtjen e interesave legjitime të kërkuesit të këshillës juridike. Me qëllim të mënjanimin të keqpërdorimeve pas regjistrimit të avokatit, janë paraparë edhe kriteret me të cilat shuhet e drejta për ushtrimin e profesionit të avokatit.

Më tutje parashikohen me saktësi dhe qartësi edhe elemente bazë të të drejtave dhe të detyrimeve të avokatëve. Këtu janë përfshirë të gjitha kriteret e përcaktuara me standardet ndërkombëtare dhe nga Këshilli i Evropës.

Ndër të tjera, është sanksionuar transparencë në punë, shmangia e interesave konfliktuoze, ruajtja e sekretit profesional, mosdiskriminimi në kryerjen e detyrës si dhe dhënie e ndihmës juridike personave që nuk kanë të ardhura, pra - ndihma falas juridike, ose që kanë të ardhura të pamjaftueshme për realizimin e së drejtës së përfaqësimit.

Të drejtat e avokatëve - me qëllim të ushtrimit efikas të profesionit të tyre - janë parashikuar gjithashtu. Kjo paraqet një domosdoshmëri të veçantë nëse marrim parasysh faktin se institucionet publike vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë janë në ndërtim e sipër dhe nuk kanë krijuar ende kapacitetin e duhur në drejtim të efikasitetit në punë.

Projektligji parashikon rregullimn e çështjeve që lidhen me shkaqet dhe motivet për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve, të cilët shkelin ligjin dhe rregullat e etikës profesionale, llojet e masave disiplinore, organin kompetent dhe procedurat përkatëse për marrjen e këtyre masave.

Të drejtë ankese kanë të gjithë subjektet juridike - përderisa të drejtën për iniciimin e procedurës disiplinore, e mban organi disiplinor i Odës së Avokatëve. E drejta e subjekteve juridike për iniciimin e procedurës gjyqësore kundër avokatëve mbetet e paprekur nga dispozitat e këtij Projektligji.

Dispozitat tjera të këtij Projektligji, përmbajnë një numër të konsiderueshëm rregullash që parashikojnë mënyrën e organizimit të veprimtarisë së avokatëve, kompetencat e Odës së Avokatëve dhe organizimin e brendshëm të saj. Në të njëjtën kohë rregullohet raporti në mes Odës dhe avokatëve brendapërbrenda saj.

Me qëllim të përmbushjes së detyrave të avokatisë, është paraparë edhe monitorimi i veprimtarisë së avokatëve nga ana e strukturave publike, duke mos cenuar vetëorganizimin dhe vetëqeverisjen e avokatisë si parim i njohur ndërkombëtar.

Së fundi, rregullohet edhe çështja e përfaqësimit të avokatëve të huaj, sikur edhe në ligjin e përparshëm, vetëm avokatët e regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës kanë të drejtë për dhënien e ndihmës juridike në Kosovë. Përjashtim bëhet këtu, në rastet e lidhura me të drejtën ndërkombëtare dhe rastet e paneleve ndërkombëtare ose të përziera në Kosovë. Praktika juridike ka treguar se këto raste janë shumë komplekse dhe klientët, për shkak të pjesëmarrjes ndërkombëtare në gjykim, gjykatësit ose prokurorët ndërkombëtar – preferojnë të kenë qasje në mbrojtës të huaj. Me qëllim të garantimit të qasjes së barabartë në drejtësi, në pajtim me normat ndërkombëtare edhe këtyre klientëve duhet t'u hapet mundësia e angazhimit të përfaqësimit nga një avokat i besuar i klientit dhe sipas kërkesës së tij të jetë e mundur që ai të jetë avokat i huaj. Megjithatë, kjo kërkesë duhet të jetë e arsyer dhe të vlerësohet nga paneli si e domosdoshme për garantimin e një procedure të drejtë. Oda e avokatëve duhet të njoftohet për autorizimin e këtij avokati.

Projektligji, me qëllim, nuk bën fjalë për profesionin e noterit, nga se ky profesion, për shkak të natyrës publike të tij duhet të rregullohet me një ligj të veçantë.

Projektligji i shmanget me qëllim edhe rregullimit të detajeve, nga se ato do të rregullohen me statut ose me rregullore të veçantë të Odës së Avokatëve.

Zoti kryetar – kryesues!

Po çka po tij unë ç'po ndodh pas shpinës sime. Kjo është ajo, i kam sytë përpara jo mbrapa.

Më lejoni, zoti kryesues, që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të shpreh qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me këtë Projektligj.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim – e mbështet këtë ligj dhe propozon që i njëjti të miratohet në lexim të parë. Mirëpo, ka disa rezerva, sidomos në kreun e tetë të këtij ligji, sepse kreu i tetë është në kundërshtim me parimet për rolin e avokatëve, parime këto që janë të miratuara në Kubë – në Konferencën e Kombeve të Bashkuara – Havanë të Kubës në vitin 1990 në të cilat shprehimisht thuhet se “Profesionin e avokatit mund ta ushtrojë në vendin e vet vetëm shtetasi i atij vendi”. Kjo bjen në kundërshtim me këtë sygjerim të sponsoruesve të ligjit dhe besoj se këto vërejtje të Grupit Parlamentar të LDK do të mirren parasysh dhe në procedurë e sipër do të bëhen edhe amendamente. Ju falemdërit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemdërit. Kam një lutje nga teknika...

(Ndërprerje)

Gani Koci është paraqitur për debat. Urdhëroni Gani. Le t'i kyçet mikrofoni Gani Kocit, ju lutem.

GANI KOCI:

Falemnderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë,
Në parim Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah nismën për miratimin e këtij Projektligji që rregullon çështjet e avokatisë. Edhe pse u tha edhe nga diskutuesit tjerë më parë këtu se për një ligj tjetër, se përmbajtja e tij, fillimi i tij, hyrja e tij nuk thotë se cilët ishin ata ekspertë që e punuan këtë ligj, por në përgjithësi oda e avokatëve, pastaj komuniteti i juristëve e të tjera – e të tjera, që tregon se me një lehtësi shumë të madhe është futur ky Projektligj në procedurë, duke patur parasysh edhe datën se kur i është drejtuar Kuvendit...

Gjatë leximit të këtij Projektligji dhe krahasuar me ligjin që rregullon të njëjtat çështje të shtetit kroat, del se nuk është as një përkthim i mirë dhe nuk është as një përshtatje e mirë të ligjit kroat.

Sikur të ishte bërë një përkthim shumë i mirë i atij ligji, prej të cilit ka patur pikënisjen, vërtetë këtu do t'na dilte një ligj mjaft i mirë e që do ta rregullonte këtë çështje. Prandaj, propozuesit e këtij Projektligji këtë çështje është dashur ta kenë parasysh.

Ligji ngarkohet me shumë çështje, të cilat nuk janë çështje që do të duhej të ngarkonin këtë ligj, por do t'ishin çështje statutare, siç është rregullimi i odës së avokatëve, pastaj procedurat, vendimet e tyre, organet e tyre gjë që zë një kaptinë diku prej 7-8 neneve dhe nuk është me ligjin prej të cilit kanë marrë bazën propozuesit.

Sa i përket kushteve të regjistrimit, në nenin 6 – si vërejtje e veçantë, pika f) thuhet se nuk mund të regjistrohen ata gjyqtar... ata që dojnë të bëhen avokat e që kanë qenë gjyqtar dhe janë pezulluar nga puna. Nëse është kështu, atëherë të gjithë gjyqtarët që kanë punuar deri në vitin 1991 e të cilit në 91-shin kanë qenë të suspenduar, atëherë nuk mund të ushtrojnë këtë profesion të avokatit.

Konsideroj se këtij neni do të duhej t'i shtohet edhe një paragraf tjetër: që nuk mund ta ushtrojnë veprimtarinë e avokatit të gjithë ata gjyqtar që kanë shpall aktgjykime politike.

Se është një përkthim i dobët, unë dua ta lexoj vetëm nenin 21. “Avokatët që veprojnë në Kosovë janë të obliguar anëtarësohen në dhomën e avokatëve të Kosovës”; “Dhoma e avokatëve është e obliguar, organizatë profesionale, me të drejtë vetëqeverisëse me cilësinë e personit juridik” që është krejtësisht e pakuptimt.

Çështje tjetër dhe si vërejtje e Grupit Parlamentar është rreth procedurave disiplinore dhe masave disiplinore që mund të ndërmerren ndaj avokatëve. Unë konsideroj se çështjet e masave disiplinore duhet të rregullohen me statutin e odës së avokatëve dhe si masë mund të jetë edhe ajo gjë, ndëshkimi ose dënimi edhe me të holla por nuk do të duhej të ishte si pjesë e këtij Projektligji, ndërsa këtij Projektligji krejtësisht i mungon pjesa e dispozitave ndëshkimore ndaj avokatëve që shkelin ligjet, që shkelin procedurat, që shkelin obligimet që i kanë si avokat.

Megjithatë, ne në procedurën e mëtejme do ta japim kontributin tonë në përmirësimin e këtyre ligjeve, por le të jetë si vërejtje se ata që përkthejnë dhe marrin të gatshme le t'i marrin ashtu siç janë, vetëm le t'ua ndryshojnë emrat e vendeve prej nga i marrin.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Bajram Kosumi, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi. Dje më është bërë vërejtje se ju kam lën gjatë me folë, prandaj juristët i lus të jenë më të shkurtër. Urdhëroni Bajram.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuari kryetar, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës shpreh kënaqësinë që Projektligji për avokatinë është në procedurë në Kuvend. Mendoj se çështjet themelore janë të definuara qartë në këtë Projektligj, ndërsa vërejtjet eventuale - si ato që kanë të bëjnë me nenin 8, ku flitet për betimin e nuk përcaktohet se cili rend kushtetues dhe juridik do ta mbrojnë avokatët, ose nenin 6 që duhet të qartësohen më saktësisht kushtet për regjistrimin në regjistrin e avokatëve – deputetët dhe Grupi ynë do t'i bëjmë në procedurën e amendamentimit të Projektligjit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Shumë falemnderit. Ftoj deputetët të kthehen në sallë, sepse vetëm edhe një diskutues është. E ka fjalën Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,
Duke përkrahur në parim propozimligjin mbi avokatët më lejoni që në shqyrtim të parë t'i jap disa sygerime.

Shqyrtimi i Projektligjit mbi avokatët në Kosovë është edhe një sukses i punës së Kuvendit nga se shërbimi i avokatit në sistemin e tërësisëshëm të drejtësisë është shumë i rëndësishëm, ndonëse jo çdoherë, në mbrojtjen e të të drejtave dhe të së vërtetës dhe jo çdoherë si organ i pavarur profesional.

Andaj, miratimi i këtij propozimligji mbi avokatin duhet të ketë një qëllim të caktuar, të sanksionojë rregullat dhe mbikëqyrjen e punës së avokatit. Dhe, së dyti, të heqë format e organizimit të avokatëve sipas ligjeve diskriminuese të ish-jugosllavisë sepse avokatët njëherit ende veprojnë sipas këtyre ligjeve.

Në veçanti, me këtë propozimligj duhet të arrihet sanksionimi i kodit të etikës së avokatit sepse ata deri më tani – një pjesë e tyre – kanë shqyrtuar dhe shqyrtojnë çështjet nga kënde të tjera dhe jo në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve. Ndonëse profesioni i avokatit është i lirë dhe i pavarur, kjo nuk do të thotë se ai mund të veprojë lirisht dhe me përpjegjësi nga se ai së pari duhet t'i përmbahet rendit juridik, kushtetutës dhe etikës së avokatit.

Vlerësoj se propozimligji nuk i konkretizon sa duhet dallimet mes punës së avokatit dhe këshillimeve profesionale, ekspertëve gjyqësor, mjekësor, ekonomik, financiar, teknik e tjera.

Pika 5 e nenit 3 është në kundërshtim të plotë me nenin 4. Më lejoni vetëm ta citoj pikën 5. “Profesorët dhe docentët e përhershëm të lëndëve juridike në fakultetin e Kosovës – pra juridik – nuk mund t'i japin ndihmë juridike, përveç asaj në formë të këshillave apo ekspertizave juridike”. Me këtë kufizohet e drejta e veprimit dhe e drejta e dhënies së ndihmës.

E dyta. Mendoj se kushtet për t'u regjistruar avokati duhet përmirësuar fjala “rezident” që përsëritet shumë në ligjet tona – por “banor i përhershëm i Kosovës”.

Betimi i avokatit duhet të jipet pra para Kuvendit të Kosovës, siç e dhënë gjyqtarët, fatqësisht s'e ka dhënë asnjë dhe jo para kryetarit të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Është e padrejtë që në kategorinë e juristëve dhe të këtyre të drejtave, në nenin 12, të rangohen cilësitë e tyre. Avokati që kryen shërbimin në kundërshtim me interesat kombëtare, të merren masa që t'i merret e drejta e ushtrimit të avokaturës. Sikur që çdo punë apo shërbim që vlenë dhe ka vlerën e vet, edhe punët në shërbimin e avokatit duhet të jenë të kategorizuara dhe të publikuara publikisht dhe përafërsisht të njëjta, si për shembull – sa kushton një lutje, një ankesë, një kundërshtim, një parashtrim, një padi, një mbrojtje, një përfaqësim, një këshillim, një kontratë – që oscilon me vlera shumë të ndryshme prej avokati në avokat. Avokati duhet të obligohet që klientit të vet t'ia kthejë dokumentacionin e dorëzuar pasi që në praktikë kjo nuk ndodhë te disa raste dhe klientët humbin shumë kohë dhe humbin dokumentacionet me vlerë shumë të madhe.

Propozimligji nuk definon cilët janë kriteret e përcaktimit të klientit të varfër dhe si angazhohet avokati falas në këto procedura mbrojtëse apo forma tjera.

Vlerësoj se anëtarësimi i obliguar në odën e avokatëve është i paarsyshëm, sepse në këtë Kuvend shumëherë në oda të caktuara nuk është obligim anëtarësimi.

Mendoj se propozimligji mbi avokatët, disa pjesë të paarsyeshme të saj, duhet eliminuar dhe përcaktuar vetëm me statut, siç është çështja e komisionit disiplinor, revizionit, përkatimit e tjera.

Me këtë propozimligj mbi avokatët nuk është përcaktuar procedura e mbrojtjes së të dyshuarit nga avokati i huaj dhe me këtë vlerësoj se kreu i tetë duhet krejtësisht të hiqet nga ky propozimligj, sepse arsyetimi u dha edhe nga zonja Nekibe.

Mendoj se dhoma e avokatëve brenda 3 muaj është e obliguar ta hartojë statutin dhe jo tetë muaj sepse tetë muaj është afat bukur i gjatë.

Përkarshi këtyre vërejtjeve, vlerësoj se me amendamentet që do të jipen për këtë propozimligj ky ligj do të begatohet. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. As tash nuk mund të vendosim, as nuk mund të vazhdojmë sepse çdo pikë ka votimin. Prandaj, edhe një herë i ftoj deputetët të kthehen në sallë dhe në të njëjtën kohë përgjegjësia le të shihet sa e madhe është e OSBE-së me këto sisteme të këtilla dhe sa është përgjegjësia e deputetëve dhe ndaj kujt është përgjegjësia.

Tash kemi kuorum. Ju lutem ju ftoj ta aprovojmë një parim Projektligjin.

Kush është për? Ju falemnderit.

S'ka nevojë OSBE-a me i numëruar votat, sepse numërohen saktësisht dhe nuk është detyrë e juaja. Këtë po e them për shkak të dokumentacionit që duhet të jetë në histori dhe do të shohim përbërjet e ardhshme a do të lejojnë sjellje të këtilla. Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A ka abstenime?

Ka punë më të mëdha bashkësia ndërkombëtare se me i numëruar votat këtu!?

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForTë gjithë – Svi - All
Kundër – Protiv – Against.....00
Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 00

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese për emërimin e gjykatësve dhe të prokurorëve.

Unë kam informatën që propozimi i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve. Në qoftë se ndokush ndien nevojë të veçantë për debat për propozimin mund të lejohet. Informatat i kam se nuk ka nevojë, prandaj ju ftoj të votojmë.

Kush është që të aprovohet propozimi i Komisionit funksional? Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Le të numërohen votat kundër, ju lutem. 5 vota janë kundër. Ju falemnderit.

A ka abstenime? Janë 3 abstenime dhe Hydajeti në kryesi abstenoj, prandaj konsideroj se aprovohet propozimi i Komisionit funksional.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Vecina - Majority
Kundër – Protiv – Against.....05
Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 03

HYDAJET HYSENI:

Më lejoni që të reagoj së paku në mënyrën më të matur të mundshme kundër kësaj mënyre të apostrofimit dhe të veçimit të një deputeti pse ai abstenon. Është e drejtë e deputetit si voton dhe nuk shoh asnjë arsye që në raste të tilla të përmenden emra. Meqë m'u përmend emri, unë due edhe të arsyetoj pse atëherë abstenoj. Po i them shkurt dhe telegrafikisht. Sepse, nuk janë rrespektuar as afatet. Sepse, këshilli gjyqësor dhe prokurorial po vazhdon praktikën për të mos e informuar Kuvendin me të gjitha informatat që kemi kërkuar në fillim, sepse edhe vlerësimet pastaj që ka dhënë dhe rekomandimet Kuvendi nuk janë rrespektuar dhe mendoj se nuk është në nderin e Kuvendit që lejon një praktikë të tillë. Le të jetë kjo së paku vetëm si një tërheqje e vërejtjes që në të ardhmen të korrigjohen praktika të tilla. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet të falemnderit. Kësaj radhe s'ka patur asnjë prapavijë, por ishin dy abstenime, dhe unë ju pash afër meje dhe thash le t'ju numërojnë, sepse juve s'ju llogarisin atëherë. Unë po e pranoj vërejtjen, por kjo është e vërteta.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryetarit dhe të një anëtari të Komisionit rregullativ të prokurimit publik, si dhe kryetarit dhe të anëtarëve të Agjencionit për Prokurim Publik.

Në seancën e sotme do të vazhdojmë me procedimin e propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të një anëtari të Komisionit rregullativ për prokurim publik, pasi që anëtarët tjerë janë emëruar në seancën e kaluar.

Për kryetar të Komisionit janë propozuar dy kandidatë.

Votimi bëhet sipas radhës së propozuar. Nëse kalon i pari, votimi i të dytit është i paobjekt.

Për anëtar të Komisionit rregullativ të prokurimit publik në vend të zotit Bejtush Isufi, Qeveria ka propozuar kandidatin e ri zotin Ramadan Gashi.

Miratimi bëhet me votim.

Urdhëro, në emër të grupit, apo jo?

GANI KOCI:

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, duhet të tërheq vërejtjen për mënyrën se si do të votohet për një çështje të tillë. Ne kemi patur edhe më herët propozime nga Qeveria për miratimin e vendimeve të Qeverisë, ky është një vendim i Qeverisë dhe dihet se kemi një Qeveri të marrëveshjes dhe të gjitha ato marrëveshje janë bërë në mes të ministrisë dhe Qeverisë në përgjithësi dhe ne ose duhet t'i votojmë në paket qysh kemi pasë edhe raste të tjera ose Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nuk merr pjesë në procesin e votimit. Prandaj, nuk e numërojmë këtë si votim. Është tërheqje e vërejtjes. Kjo ka qenë ndodh edhe në mbledhjet e kaluar për këtë çështje, prandaj ose duhet të votohet si vendim i Qeverisë në paket ose ne për veç e veç nuk marrim pjesë në procesin e votimit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë s'po e shoh të arsyeshme. Ju lutem. Ju falemnderit zoti Koci. Procedojmë më tutje.

Së pari, kush është për propozimin e Qeverisë për zëvendësimin e këtyre dy emrave që i lexova. Le të numërohen votat...Shumica absolute janë për.

A ka votë kundër? Numëroni votat kundër. Nuk ka votë kundër.

A ka abstenim? Nuk ka as abstenim.

Prandaj, konsideroj se është aprovuar propozimi i Qeverisë për kandidatin në fjalë.

Kalojmë në pjesën e dytë – tash për kryetar të Bordit.

Emrat unë s'i kam para veti. Nuk kam qenë në seancën e mëparshme. Ju lutem, kush janë kandidaatë...

- Sejdi Rexhepi kryetar, dhe
- Iljaz Duli kryetar.

Kush është që Sejdi Rexhepi të jetë kryetar?

(Ndërhyerje – pa kyçje të mikrofonit: Nuk e ke kuorumin, o kryetar!)

Ne nuk mund të votojmë dhe të vendosim pa kuorum, ju lutem. Të shohim për pikat tjera të rendit të ditës, ose kërkoj sqarim – mendim juridik nëse ndokush ka për këtë.

Nuk mund të vazhdohet. Lutem deputetët që të kthehen për pikën e ardhshme. Urdhëro Naim.

NAIM MALOKU:

Të falemnderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë që kemi mbetur në sallë, për shkak të rëndësisë së madhe që kanë për procesin e vetëfeksionimit të Qeverisë në sferën e investimeve dhe për shkak të faktit se kjo është seancë e fundit para pushimeve dhe rëndësisë së madhe që këto dy pika të votohen, unë lus përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK dhe atë të PDK që të mirren vesh dhe t'na mundësojnë, t'ia mundësojnë këtij Kuvendi që t'i kalojë këto dy pika të rendit të ditës, thash për shkak të rëndësisë së madhe që është për funksionimin e mëtejshëm të Qeverisë në këto sfera, pra sferën e mbarëvajtjes së financimeve dhe investimeve në Kosovë, dhe për shkak të faktit se do t'ishte hera e tretë që për shkak të mosmarrëveshjeve, sipas mendimit tim shumë banale dhe jo të mirë e jokorrekte, sjelljeve jokorrekte të ndërpritet në këtë mënyrë tri herë seanca e Kuvendit. Falemnderit zoti kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Naim, të falemnderit. Do të jap një pushim. Lojërat politike gjithmonë janë normale në parlament. Kjo është ajo që unë kam insistuar gjithmonë. Nuk mund të instalohet dhuna e pakicës në institucione demokratike. Por plotësisht e përkah atë që shumica të ketë tolerancë maksimale, në qoftë se janë rëndësitë vendimarrëse ose vendimtare për Kosovën. Prandaj, nuk mbetet kurgjo tjetër vetëm të japim pauzë 30 minutëshe dhe lus pastaj që të kthehemi pas 30 minutave në sallë. Ju falemnderit.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Mendoj se tani kemi kuorum pune dhe jo edhe për vendimmarrje ende, por për të punuar propozoj një mendim që ndoshta mund të aprovohet. Komisioni i parë, apo grupi i parë, apo bordi i parë është vendosur në Parlament. Prandaj, ai bord ose ai komision le të mirren vesh për kryesues të përkohshëm deri në vendimmarrje të plotë të Parlamentit, në mënyrë që mos ta lëmë në vakum juridik Qeverinë ose Kosovën.

Këtu s'kemi nevojë të votojmë, sepse as nuk kemi kuorum, por të vazhdojmë me debatin për pikat tjera që i kemi në Parlament, sepse nuk ka konsensus. Meqë nuk ka konsensus, prapë nuk po dua askush të dalë prej sallës dhe të vazhdojmë për atë që mund të ndërtojmë konsensus pune, ju lutem.

A pajtoheni. Fatmir, jo për debat. Urdhëro.

FATMIR SEJDIU:

Jo debat, por pikërisht është çështja se të gjitha çështjet - me përjashtim të informatës për kërkimin e personave të zhdukur, gati të gjitha janë për vendimmarrje. Këtu është problemi.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po krijohet kuorumi në ndërkohë. Por unë s'po e qes në votim, thash të aprovohet ajo që thash dhe të vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

Tani kemi – Shqyrtimi i informatës për kërkimin e personave të pagjetur dhe të kidnapuar, ju ma keni bërë të zhdukur dhe po protestojnë me të drejtë, prandaj fjalën e ka kryetarja e Komisionit Flora Brovina. Urdhëroni Flora.

FLORA BROVINA:

Të premtën, kur ne përfunduam seancën, në Merdar arritën 23 kufoma nga varrezat masive në Petrovo-Sello, një vendbanim në kufi me Rumuninë. Të gjithë ishin domethënë të ekzekutuar dhe kufoma të marrura dhe të varrosura për së dyti në këtë varrezë masive.

Sot, në Mitrovicë, po varrosen 8 kufoma, gjithashtu që kanë qenë të zhdukur dhe pastaj u gjetën pesë vjet më vonë.

Pesë vjet pas përfundimit të luftës, problemi i personave të rrëmbyer dhe të pagjetur gjatë luftës vjen e rëndohet gjithnjë e më shumë. Sepse procesi i kthimit nga varrezat masive të gjetura në Beograd dhe gjetja e tyre në përgjithësi po ngecë, ndërsa procesi i eskumimit dhe identifikimit si dhe rivarrimi i kufomave të gjetura po shkon shumë ngadalë, është që edhe nmë tutje po kërkohet gati i njëjti numër i personave të pagjetur.

Familjet e tyre dhe gjithë populli i Kosovës është në ankth dhe pritje të çfarëdo lajmi tjetër.

Rezoluta e miratuar në Kuvendin e Kosovës më 10 prill të vitit të kaluar nga ana e institucioneve tona nuk po zbatohet në përpikëri dhe ashtu siç duhet. Tanimë është dorëzuar edhe peticioini me 260 mijë nënshkrime, ku qytetarët solidarizohen me familjarët dhe kërkojnë kthimin të pakusht të kufomave të zbuluara në varrezat masive në Serbi, e jo siç po veprohet deri më tani kur ata kthehen sipas dëshirës dhe momentit politik të Serbisë nga 10, 20 dhe nganjëherë kthehen një nga një personat kur në një familje mungojnë edhe nga dhjetë e më shumë. Kjo shkakton traumë të veçantë te këto familje.

Komisioni për personat e rrëmbyer dhe të pagjetur gjatë luftës ka patur shumë takime me familjarët dhe në seancat e përjavshme ka diskutuar për problemet e mëdha të familjeve që kanë për personat e zhdukur gjatë luftës. Gjithashtu kemi kontaktuar me organet vendore dhe institucionet ndërkombëtare që janë përgjegjëse për këtë çështje. Kemi kërkuar edhe nga Kuvendi disa herë me radhë gjatë këtij viti që në njërin nga seancat të shqyrtohet dhe jetë në rend dite çështja e personave të pagjetur gjatë luftës, të cilët u zhdukën dhe janë popull civil. Kemi kërkuar që të shohim se çka po ndodhë me fati ne tyre dhe me fatin e familjeve të tyre, në mënyrë që të mund t'ua lehtësojmë dhembjen e madhe këtyre familjeve. Arsyet për një debatë kanë qenë të shumta. Së pari të shohim a po zbatohet dhe si po zbatohet Rezoluta e aprovuar në këtë Kuvend. Të shohim çka ndodhi me legjislacion. Vërtetë ne para disa kohësh patëm në kuadër të ligjit për mbrojtjen e dëshmorëve dhe viktikmave të luftës një pasus ku flitet edhe për familjet e personave të zhdukur, por në këtë ligj ishte e pamjaftueshme mbrojtja e tyre edhe sipas konventave ndërkombëtare.

Çështja e mbrojtjes institucionale, pra e familjeve mbetet gjithnjë problem aktual. Statusi juridik i personave të zhdukur nuk është zgjidhur. Komisioni ynë shpreh brengosje të thellë për procesin e ngadalshëm të identifikimit të kufomave të gjetura në varrezat masive në Serbi, numri i të cilëve tanimë është shumë i madh. Domethënë 934 kufoma janë gjetur dhe vetëm 8% prej tyre janë kthyer në Kosovë, edhe pse dihet se të gjithëve iu është marrë analiza për ADN dhe është kryer kjo analizë. Një numër mjaft i madh – afër 700 kufoma ndodhen në morgun e Rahovecit, një morg i improvizuar që vazhdon edhe më tutje të jetë.

Pse po ndodhë kjo? Po ashtu, ngritja e aktpadive kundër kryerësve të krimeve, nuk po shkon si duhet. Deri më sot nuk u dënua askush për krimet ndaj personave civil. Çështja e personave të zhdukur gjatë luftës është dhe mbetet pjesë e rezervuar e kompetencave të UNMIK-ut dhe kjo është shumë e padrejtë ndaj popullit të Kosovës dhe e paparë në asnjë vend tjetër. Kështu, institucionet vendore privohen nga e drejta për të ditur për çdo gjë për qytetarët e vet, që të marrin pjesë në eskumimin, në identifikime, në pranimin e kufomave, në procesin e informimit të familjeve dhe të tjera. Kjo shkelje e të drejtave të një populli, aq më tepër kur zyra e UNMIK-ut për personat e zhdukur deri më sot nuk u tregua e suksesshme. Ajo nuk mund të lavdërohet për asnjë rezultat dhe kjo mjafton. Edhe pse ishte i paraparë ndërtimi i institutit mjeko-ligjor në Prishtinë, afër Prishtinës, asgjë rreth ndërtimit të këtij instituti nuk është bërë deri më tani dhe instituti ka qenë dashur të fillojë punën në pranverë të këtij viti dhe punët ende s'kanë filluar rreth ndërtimit. Mjetet për këtë institucion janë ndarë nga Qeveria Zvicrane dhe nga ajo e Kosovës, ndërsa pajisjet janë siguruar nga Qeveria Amerikane si donacion. Ato madje edhe kanë arritur, por në mungesë të ndërtimit të institucionit, ato po improvizohen dhe domethënë do të përdoren në institutin mjeko-ligjor të improvizuar në Rahovec.

Kush duhet të përgjigjet dhe deri kur duhet të pritët përgjegjja për këtë dhembje kaq të madhe të Kosovës, për ata që u rrëmbyen gjatë luftës dhe nuk gjenden, ose që janë gjetur si grumbull eshtrash në varrezat masive dhe presin identifikimin? Para sa muajsh filluan edhe bisedimet teknike për çështjen më të dhembshme të Kosovës - për personat e rrëmbyer dhe të pagjetur.

Komisioni parlamentar ishte inisiator dhe tërë kohën insistoi që kjo çështje të jetë në agjendë si pikë e parë, domethënë të fillimit të bisedimeve me Serbinë. Arritëm që vërtetë kjo kështu të jetë, por ne nuk ishim për biseda teknike. Ne ishim për biseda të mirëfillta, ku faktori vendor ose në bisedime do të ishim të drejtpërdrejtë dhe do të merrnim pjesë si palë e barabartë me palën serbe dhe jo të jemi në bisht të punës ose pjesë përcjellëse e kësaj. Pra, Komisioni parlamentar pati shumë vërejtje për nivelin e organizimit të këtyre bisedimeve. Ne ishim për bisedime, por jo në këtë nivel për këtë çështje.

Mënyra e përgatitjes së këtyre bisedimeve, gjithashtu nuk ishte në bazë të punës që ne përgatitëm dhe që kishim arritur deri te to. Ka mjaft materiale që dëshmojnë se duhet të përgatiteshim më mirë. Nuk u parashtruan as kushte rreth kthimit të kufomave të gjetura tanimë në varrezat masive në Batajnicë, prandaj me të drejtë themi se ato edhe më tutje mbahen të burgosura pasi ndodhen në kompetenca të Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë së bashku me dokumentacionin origjinal të procesit të eskumimit dhe të përshkrimit të varrezave masive nga ana e ekspertëve ndërkombëtar dhe atyre serb, ku nuk ishin prezent ekspertët shqiptar dhe asociacionet vendore – ato që merren me çështje humanitare, e që në këto raste gjithnjë do të duhej të marrin pjesë.

As në këtë aspekt nuk u zbatua Rezoluta e aprovuar në këtë Kuvend, pikërisht pika numër 4.

Qeveria duhet të formonte paraprakisht dhe ne insistuam që ajo të formojë një strategji për bisedime. Së pari të fillojnë bisedimet në mes Qeverisë dhe të UNMIK-ut; Cili është roli ynë në këto bisedime.

Në anën tjetër, Kuvendi duhej paraprakisht të mbante një seancë pikërisht në lidhje me bisedimet para se të fillonin bisedimet dhe të bisedohej për strategjinë e bisedimeve dhe si mund t'i ndihmojmë këto bisedime.

Çështja e të rrëmbyerve dhe të të zhdukurve gjatë luftës duhet të jetë një çështje transparente dhe reale si për institucionet vendore ashtu edhe për ato ndërkombëtare.

Komisini ynë, pasi pati një debat të gjerë, rekomandon për Qeverinë dhe institucionet vendore:

Nën një – zbatimin me përpikëri të Rezolutës, të miratuar më 10. 04. 2003 në këtë Kuvend, domethënë të zbatohet kjo nga ana e Qeverisë, kryeministrit, Komisionit ndërministror për personat e pagjetur, grupit për bisedime, nga Presidenca dhe nga institucionet tjera vendore.

Të zbatohet secila pikë e Rezolutës, e në veçanti pika numër 4 gjatë bisedimeve.

Të insistohet që zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur të jetë transparente me institucionet tona dhe që kompetencat e kësaj zyre të kalojnë tek institucionet vendore dhe ato t'i përgjigjen Parlamentit dhe Qeverisë për punën.

Që ekspertët vendor patjetër të marrin pjesë në eskumime, në identifikime dhe në dorëzimin e kufomave e jo që të ftohen ose të lajmërohen formalisht dhe pas kohës.

Në bazë të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara dhe në bazë të Konventës së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar familjet kanë të drejtë të dijnë çdogjë për fatin e më të dashurve të tyre. Nëse kanë vdekur ta dijnë shkakun e vdekjes; kush e bëri krimin dhe ku ndodhen varret e tyre.

Pra, insistojmë në zbatimin e kësaj të drejteje.

Qeveria duhet të marrë nismën për ngritjen e aktakuzës kundër Serbisë për gjenocid kundër Serbisë dhe Millosheviqit e bashkëpunëtorëve të tij. Dëshmitë për këtë akuzë ndodhen në Beograd ku u bënë edhe përpjekjet për të zhdukur njerëzit e rrëmbyer duke i hudhur në lum ose duke i djegur. Këto dëshmi gjithashtu besoj se keni mund edhe ju t'i keni pasi që kemi fakte se 37 veta të gjallë janë zhdukur në Batajnicë, përveç atyre që janë dërguar të vdekur pasi janë ekzekutuar në Kosovë.

Të insistohet që familjarët të bëjnë kallzime penale në kuadër të prokurorive komunale dhe për të gjitha rastet që kanë dëshmi dhe argumente.

Është qëndrim i Komisionit dhe familjarëve që grupi për bisedime – pra Qeverisë, çështjen e personave të rrëmbyer dhe të zhdukur ta trajtojë si çështje humanitare dhe juridike, e jo të lejohet që bisedimet të shantazhohen nga Serbia dhe për këto bisedime palët të kenë përfitime politike.

Mbështesim kërkesën e qytetarëve të nënshkruar me peticion dhe insistojmë në zbardhjen e fatit të të rrëmbyerve dhe të pagjetur pa kusht meqë ata u rrëmbyen në formë institucionale nga policia dhe ushtria serbe. Ka mjaft argumente se këto institucione kanë mbajtur edhe evidenca për rrëmbimin, krimin, varrimin dhe zhvarrimin e kufomave. Kjo edhe për arsye se

në Batajnicë, të gjitha rastet, thash edhe më parë që është kryer ADN dhe ato pra janë identifikuar dhe mund të kthehen.

Insistojmë tek institucionet vendore që të realizojnë mbrojtjen institucionale të familjeve të të rëmbyerve dhe të pagjeturve dhe po ashtu do të punojmë që në ligj të përfshihet në mënyrë të denjë mbrojtja e tyre institucionale.

Të rregullohet statusi juridik i personave të rrëmbyer dhe të pagjetur gjatë luftës.

Kërkojmë sqarime lidhur me ngecjen e fillimit të punimeve të institutit mjeko-ligjor në Prishtinë, i cili është dashur të kryhet, e që mjejtet sikur që thash janë ndarë dhe ka arritur edhe pajisja.

Kërkojmë që të dijmë pse u sabotua dhe a u sabotua ndërtimi i këtij institucioni.

Insistojmë në zbatimin e standardeve të praktikës së suksesshme në zbulimin, ekzaminimin dhe identifikimin e eshtrave të zbuluara.

Çështja rreth dokumentacionit, është një problem në vete. Insistojmë në lëshimin e dokumentacionit komplementar në lidhje me rrethanat e rrëmbimit dhe të zhdukjes, për shkakun e vdekjes kur kjo është e mundur dhe kush e shkaktoi vdekjen, kohën e ekzekutimit dhe kohën e eskumimit si dhe konditat tjera. Këtë dokumentacion, përveç tjerash duhet ta lëshojë në bazë të dosjes zyra e Qeverisë për personat e rrëmbyer dhe të pagjetur, e cila – për fat të keq – ende nuk është kompletuar dhe nuk është e organizuar në mënyrë profesionale.

Insistojmë që institucionet vendore të informohen me kohë dhe të jenë pjesë e procesit të riatdhesimit të kufomave të gjetura në Serbi, të informimit të familjeve dhe varrimit me mbikëqyrje dhe përkujdesje institucionale.

Zyra për personat e zhdukur pranë Qeverisë të jetë e kualifikuar dhe kompetente që t'i dalë ballë punës, jo si deri më tani, ta improvizojë punën rreth kërkimit dhe gjetjes së personave të rrëmbyer e të pagjetur.

Insistojmë të zbatohet pika 10 e Rezolutës me përpikëri, domethënë të formohet arkivi i posaçëm për persona të rrëmbyer e të zhdukur dhe të pagjetur gjatë luftës.

Të punohet në ndërtimin e kompleksit memorial ku do të ruhen dokumentet, fuktografitë, do të mbahen rrobat e gjësendet tjera të njerëzve të rrëmbyer dhe të pagjetur. Këtë e themi nga fakti se shumë nga këto fakte tanimë janë varrosur bashkë me kufomat e gjetura e të varrosura, për fat të keq.

Kërkojmë ndihmë nga bashkësia ndërkombëtare, nga Kombet e Bashkuara, nga Bashkimi Evropian, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtetet e Kuinitit që të bëjnë më shumë presion tek ata që duhet të zbardhin fatin e personave të rrëmbyer dhe të pagjetur gjatë luftës në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYETAR I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju Falemnderit shumë. Sanije Alijaj, le të bëhet gati Berat Luzha, meqë është kryesisht Komisioni, mendoj të përqëndroheni më tepër në ndonjë faktografi ose të ndonjë rekomandimi, sepse si Komision besoj informata është e tij. Urdhëro Sanije.

SANIJE ALIAJ:

I nderuar kryetar, i nderuar ministër, zonja dhe zotrinj deputetë,
Duke u bazuar në informatën që deputetët e kanë në dispozicion për këtë pikë të rendit të ditës dhe duke u nisur nga puna që ka bërë Komisioni parlamentar për personat e humbur dhe të kidnapuar do të bëj përpjekje që t'i theksoj disa çështje që janë me rëndësi për familjarët, për institucionet e Kosovës dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Problemi i personave të rrëmbyer dhe të pagjetur mbetet një nga çështjet më të rënda të pazgjidhura për të drejtat e njeriut në Kosovë. Edhe pse kaluan pesë vite të prezencës ndërkombëtare në Kosovë, fati i 3.500 personave të të gjitha bashkësive mbetet ende i panjohur.

Vuajtjet e familjeve të prekura për mosgjatjen e më të dashurve të tyre, dështimi për ta adresuar këtë çështje – paraqet pengesë të madhe për pajtimin e komuniteteve dhe brezave të ardhshëm, si dhe masë të madhe të ndikimit negativ në besimin ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe institucioneve vendore.

Themelimi i zyrës së UNMIK-ut, komisionit parlamentar, komisionit qeveritar dhe zyrës pranë Qeverisë për të zhdukurit është një zhvillim pozitiv në këtë drejtim. Por, edhe përkundër kësaj, procesi i ngadalshëm i identifikimit – është i pakuptimt dhe lidhur me këtë duhet kërkuar nga Kombet e Bashkuara, nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të kontribuojnë në përshejtimin e këtij procesi, sepse kjo çështje – shumë e rëndësishme për institucionet dhe qytetarët e Kosovës – është standard me rëndësi që duhet plotësuar.

Komisioni ka mbajtur takime të rregullta dhe të hapura çdo javë, e sipas kërkesës edhe më shpesh, me asociacionet e familjeve, me institucionet vendore dhe ndërkombëtare që mirren me këtë problematikë. Ka organizuar takime pune me familjarët pothuaj në të gjitha komunat e Kosovës ku janë shtruar në mënyrë thelbësore dhe parimore të gjitha çështjet.

Rezoluta, e miratuar në Parlamentin e Kosovës obligon institucionet vendore dhe ndërkombëtare t'i qasen seriozisht dhe me urgjencë kësaj çështjeje, si dhe dorëzimi i petitionit me mbi 236 mijë nënshkrime për pengjet e pagjetura, ku qytetarët solidarizohen me familjarët dhe kërkojnë kthimin e pakusht të kufomave të zbuluara në varrezat masive në Serbi, dërguar institucioneve vendore e ndërkombëtare të vendosjes – janë dy dokumente të fuqishme, por edhe përkundër kësaj edhe më tej fati i personave të zhdukur nuk është ndërkombëtarizuar, por ka mbet problem në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë pozicion, vështirë që kjo çështje të përmbillet shpejt.

Mendoj se kompetent për ndërkombëtarizimin e fatit të të zhdukurve gjatë luftës në Kosovë është zyra e UNMIK-ut për personat e zhdukur, e cila duhet të jetë transparente dhe të bashkëpunojë me institucionet vendore për të gjitha çështjet.

Për ndryshe, nuk mund të arsyetohet funksionimi i saj, kur në Kosovë kthehen çdo tre muaj nga 20 deri në 30 kufoma të identifikuar, e që familjarët i shkatërron fizikisht dhe shpirtërisht në ankthin e pritjes. Ata kanë të drejtë mos ta përjetojnë Merdarin në vazhdimsi si vend të tmerrit.

Mendoj se pas këtij debati, Qeveria duhet të bëjë një strategji për bisedime - duke u bazuar në Rezolutën e miratuar në Parlamentin e Kosovës - e cila duhet miratuar në Parlament. Ky dokument duhet të jetë bazë e grupit për bisedime për të zhdukurit gjatë luftës.

Të formohet një grup ekspertësh pranë zyrës së Qeverisë që grumbullon fakte dhe të dhëna për krimin e dyfishtë - që asociacionet e familjes i kanë në numër të madh – të kryer ndaj qytetarëve të pafajshëm dhe pasojave të familjes. Ky grup, në bazë të këtyre fakteve të ngrisë kallzime penale kundër kriminelëve për gjenocidin e kryer në Kosovë dhe të lëshojë dokumente adekuate për rrethanat, kohën, shkakun e vdekjes dhe kush e ka shkaktuar krimin.

Mendoj se Qeveria duhet të dalë me projekte konkrete për ndërtimin e institutit të mjekësisë ligjore në Fushë-Kosovë, i cili, ndër të tjera, do të përshejtonte identifikimin e 700 kufomave që ndodhen në morgun e Rahovecit. Se, për ndryshe, me çka mund të arsyetohet insistimi për zbardhjen e fatit të pengjeve të pagjetura që mbahen në Serbi për realizimin e qëllimeve politike....

(Ndërprerje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, Sanies le t'i vazhdohet, por koha le të përkufizohet për mos ta zgjatur të tjerët. Urdhëroni zonja Sanie.

SANIE ALIJAJ:

Të falemnderit. ... kurse ngeçë procesi i identifikimit në Kosovë.

Qeveria ka filluar nismën e rregullimit ligjor të përkujdesjes institucionale të familjeve që kanë të zhdukur, por kjo nënkupton që së pari Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale të formojë grupin punues, i cili do të përgatisë projektligjin për caktimin e statusit të luftëtarit dhe kategorive tjera të shoqërisë, e pastaj të caktojë kriteret në bazë të cilave një person do të trajtohet pjesëtar i luftës, i familjes së dëshmorit, i zhdukur ose viktimë civile; të caktojë burimet, institucionet që lëshojnë dëshmi përkatëse për personat që i plotësojnë këto kushte e pastaj në pako të miratohennë Parlament.

Në fund, edhe një herë po potencoj: çështja e të zhdukurve duhet të mirret shumë seriozisht nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe të detyrohet Qeveria e Serbisë të bëjë identifikimin dhe t'i kthejë pa kusht të të zhdukurit, duke u nisur:

Nën një – duke e bërë ndërkombtarizimin e kësaj çështjeje, bazuar në Deklaratën finale të miratuar në Konferencën ndërkombëtare të mbajtu më 1 shkurt 2003 në Gjenevë dhe në Rezolutën e miratuar në Parlamentin e Kosovës, mbajtur më 10 prill 2003.

- Grupi për bisedime të përgatisë mirë, dhe çështjet e shtruara gjatë bisedimeve t'i argumentojë me fakte.

Tre - Shumë shpejt të miratohet infrastruktura ligjore për përkujdesje institucionale familjeve që kanë pengje të pagjetura.

Nëse çështjet e shtruara në informatë dhe debati i bërë në Parlament fillon të merret seriozisht nga institucionet vendore e ndërkombëtare pak u dalim hakut familjeve që edhe pas pesë viteve të Kosovës në liri nuk dijnë çka është liria. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Berat Luzha, le të bëhet gati Mevlyde Saraçi.

BERAT LUZHA:

Zoti kryetar, kjo pikë e rendit të ditës nuk do të duhej të lëhej në ditën e fundit para pushimeve vjetore dhe aq më pak nga 19 pika të rendit të ditës kjo pikë të jetë e 19-ta.

Problemi shumë i madh, i cili që mëse pesë vjet po e mban në ankth Kosovën është moszgjetja dhe mosndriçimi i fatit të njerëzve tanë të kidnapuar gjatë luftës. Ky problem po krijon tensione në shoqëri aq më tepër kur po shihet se zgjidhja e tij nuk është marrë seriozisht nga askush, as nga institucionet tona dhe as nga ato ndërkombëtare.

Si fushë e rezervuar, ky problem bie në kompetenca të UNMIK-ut, por zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur më së paku mirret me zbardhjen e fatit personave të kidnapuar gjatë luftës. Kjo zyrë tash për tash pret se çka do t'i sjellë Beogradi, kurse Beogradi bën pazare me eshtrat e më të dashurve tanë, pra me fatin e personave të pagjetur.

Kthimi në grupe të vogla i personave të vrarë e të identifikuar dhe moszbulimi i varrezave masive në Serbi e në Kosovë është edhe një fakt se dikush nuk është i interesuar që ky problem të mbyllet shpejt. Në këtë drejtim, edhe ne – institucionet vendore, Kuvendi e Qeveria, edhe pse me pamundësi reale, duhet të jemi më këmbëngulës në mënyrë që çështja e personave të pagjetur të zë vend më mëritor në angazhimet tona.

Në këto kushte dhe të papërgatitur, dialogu me Serbinë për këtë problem do të jetë pa rezultate dhe problemi do t'na mbetet edhe më tej i pazgjidhur dhe pa synime që të zgjidhet për një kohë të shkurtër.

Është e nevojshme që në kuadër të Qeverisë të formohet zyra për personat e kidnapuar gjatë luftës e të pagjetur në mënyrë që kompetencat të barten nga përgjegjësitë e UNMIK-ut dhe në këtë mënyrë zyra e UNMIK-ut të jetë vetëm si mbikëqyrëse dhe ndërmjetësuese në mes autoriteteve të Prishtinës dhe të Beogradit.

Çështje tjetër me rëndësi do të ishte nxjerrja e një ligji të veçantë, i cili jo vetëm që do të zgjidhte disa probleme nga kjo fushë, por edhe do t'i obligonte institucionet tona për një qasje më të drejtë në këtë aspekt. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mevlyde Saraçi, le të bëhet gati Bajram Kosumi.

MEVLYDE SARAÇI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputetë,
Mua më vjen keq, se edhe unë si anëtare e Komisionit, e katërta me radhë e mora fjalën, dhe konsideroj se secili anëtar – deputetë në Kuvendin e Kosovës njësoj mendon dhe ndoshta edhe më mirë do të ketë qasje, por me kompetencë them se ky Kuvend na ka dhënë përkrahje e autorizim neve anëtarëve të Komisionit që të punojmë dhe gjithmonë ka qenë i gatshëm prej kryetarit dhe të të gjithëve që të na ofrojë të gjitha mundësitë të jemi sa më të suksesshëm.

Pikërisht për këtë edhe e mora fjalën e të them edhe publikisht dhe për qytetarët e Kosovës e posaçërisht edhe për familjet e tyre se ky Parlament, me datën 10 prill 2003 ka aprovuar një Rezolutë nga e cila shumica e pikave janë realizuar dhe po realizohen dita më ditë.

Statusi i padefinuar i Kosovës gjithësesi po reflektohet edhe në vonesë të zbardhjeve të fatit të personave të zhdukur për shkak të mungesës së kompetencave si edhe në shumë fusha të tjera. Ne jemi të vetëdijshëm se edhe pesë vite pas luftës nuk janë zbuluar mbi 3.500 persona, por edhe të vetëdijshëm se nuk jemi palë e barabart me Serbinë në bisedime. Pikërisht, kompetencat të cilat i kanë mbetur UNMIK-ut për këtë çështje kaq të rëndësishme, po kushtëzohen me çështje politike dhe po lejojnë që Ministria e Drejtësisë e Serbisë për interesa të veta ta vonojë këtë çështje. Unë nuk mund ta akuzoj asnjë institucion të Kosovës, duke filluar nga presidenti i Kosovës, kryetari i Parlamentit dhe ky Parlament dhe Qeveria e Kosovës sepse përditë janë duke bërë përpjekje të vazhdueshme që të përshpejtohet ky proces.

Unë e mora si hap të parë Rezolutën, e pastaj themelimin e Komisionit dhe i kemi pasë të gjitha mundësitë e kushtet të veprojme. Unë do ta jepja një kritikë edhe për Komisionin tonë, por edhe komisionin qeveritar - që deri më sot nuk e ka penguar as UNMIK-u, as bashkësia ndërkombëtare ta ketë një listë të konsoliduar dhe të saktë të numrit të të zhdukurve. Prandaj, në kuadër të këtij diskutimi, duhet t'i qesim edhe të metat tona si deputetë, edhe si anëtarë të komisionit qeveritar, si komision ndërministror por edhe të nivelit të komunave, të cilët më shumë punojnë në nivele komunale, në nivele të ngushta dhe nuk bashkëpunojnë. Konkretisht, jam e interesuar që në ligjin të cilin e kemi procedura dhe aprovuar në lexim të parë gjithësesi të vendosen dy-tri nene me të cilat do të saktësohet statusi i personave të zhdukur apo të humbur – siç po kërkojnë familjarët – dhe të drejtat e tyre. Unë konsideroj se në përbërjen e ardhshme të Parlamentit të Kosovës duhet të mirret një vendim që ky komision, i cili ka punuar dy vite me radhë dhe nuk ka pasë kompetenca të mjaftueshme t'i kryejë të gjitha detyrat – të shndërrohet në një zyrë ekzekutive, pra në nivel të Qeverisë, jo nga deputetët, dhe ata dalëngadalë apo sa të jetë mundësia më shpejt t'i marrin kompetencat nga zyra e UNMIK-ut dhe t'i bëjnë transparente të gjitha aktivitetet e tyre në bashkëpunim me komunat dhe me asociacionet e familjarëve. Unë ndiej dhembje të madhe për të gjithë ata njerëz që edhe pas vite pas luftës ende nuk janë kthyer, por gjithashtu i siguroj të gjithë familjarët se ky Parlament dhe institucionet e Kosovës – si Presidenca dhe Qeveria – janë me ta dhe po bëjnë përpjekje dhe do të bëjnë përpjekje që gjithësesi të kthehen sa më parë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit shumë. Bajram Kosumi, le të bëhet gati Smajl Latifi.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuari kryetar, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e çmon shumë punën e Komisionit për persona të rrëmbyer e të pagjetur që ka bërë në këtë çështje, për informatën që e ka hartuar për Kuvendin e Kosovës dhe për konkluzionet që i ka sjell aty.

Në anën tjetër, ne kuptojmë po ashtu vullnetin e deputetëve për të shprehur mendimet e tyre për këtë çështje, sepse me të vërtetë kjo është një prej çështjeve ose kryeçështja më e dhembshme në Kosovë, por duhet të kihet parasysh se kjo çështje është aq njerëzore, aq e dhembshme sa që nuk lejon asnjë lloj qoftë të politizimit, qoftë edhe të zgjidhjes së çështjeve tjera në kuadër të këtij problemi. Ato mund t'i diskutojmë herave tjera, a ka bërë mirë apo keq një zyre a një komision dhe zgjidhim herave tjera. Unë jam i sigurt se

deputetët e Kuvendit të Kosovës njësoj e ndjejnë këtë çështje. Jam i sigurt, po ashtu se të gjithëve njësoj na dhimben familjet, njerëzit e tjera e tjera, do të thotë në ndërgjegjen tonë njësoj e ndjejmë këtë problem.

Prandaj, Grupi ynë propozon që të mos debatohet shumë në këtë çështje, por të qiten në votim konkluzionet e propozuara nga Komisioni dhe të votohen ato konkluzione dhe ta përfundojmë debatin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Vazhdimisht po shtohet lista e deputetëve për debat. Unë ju kisha lutur, dhe Bajrami e tha atë që mendova. Nuk ka deputet në sallë që nuk e ndjen si problemin më të rëndësishëm të qytetarëve të Kosovës dhe të institucioneve të saja. Unë nuk do t'ua ndaloj debatin, dhe unë e kuptoj nevojën e shprehjes së dhembjes dhe të ndjenjes të secilit deputet, por me të vërtetë dje Ramushi më së miri u shpreh – në momentet kur dhembja është e përgjithshme, kur ndjenja është e përgjithshme – nuk e besoj se ka vend për diçka tjetër – marketing politik ose tjetër. Smajl ta kam dhënë fjalën. Urdhëro, pastaj për të tjerët vendosim si të dojnë deputetët, nuk kam tjetër propozim.

SMAJL LATIFI:

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e fatit të persoanve të rrëmbyer nga forcat serbe gjatë luftës çlirimtare të popullit të Kosovës për liri vazhdon t'i mbajë në ankth të vazhdueshëm familjet tona për gati gjashtë vjet.

Faktori ndërkombëtar jo vetëm që nuk ka ushtruar presion tek Serbia për zbardhjen e fatit të tyre dhe kthimin e tyre në atdhe të gjallë apo të dekur në trojet e veta në Kosovë, përkundrazi i ka bërë lëshime Serbisë duke e avancuar dhe forcuar pozitën e saj ndërkombëtare.

Këshilli i Sigurimit i OKB mban peng këtë çështje të mpreht të pazgjidhur. Ky organ dhe mekanizmi i tij – misioni i UNMIK-ut është përgjegjësi kryesor pse nuk zgjidhet kjo çështje. Çështja e të rrëmbyerve nuk trajtohet – mjerisht – nga rrafshi human, ashtu siç mendokn dikush por trajtohet në aspektin politik. Ndërkombëtarët, për shkaqe politike nuk i bëjnë presion, nuk e ndëshkojnë Serbinë, nuk i vendosin kushte asaj lidhur me këtë çështje, si dhe për çështje të tjera. UNMIK-u po për shkaqe politike, sipas mandatit që ka, vendos kushte të shumta për Kosovën, të përmbledhura në planin – standardet për Kosovën. Pra, siç ka imponuar edhe bisedimet me Serbinë për çështjen e pengjeve.

Ne, pa vendosur kushte, e pranuar kushtin e bisedimeve për ta realizuar me sukses procesin e zbardhjes së fatit të mijërave të të rrëmbyerve shqiptar nga forcat kriminale gjenocidiste dhe shtetërore serbe.

Kur flasim për këtë çështje të ndjeshme, nuk mund të harrojmë faktin se disa faje duhet t'u faturohen edhe bartësve të institucioneve vendore, akterëve kryesor politik, por edhe ne deputetëve, të cilët vazhdojmë ende me një politikë të mosangazhimit konkret, pra me politikë pasive shterrepe.

Neve na faturohet një lloj papërgjegjësie, na faturohet papërgjegjësia, mungesa e angazhimit dhe një lloj indiference e zakonshme. Ky qëndrim yni politik, dhe sjelljet tona po dëshmojnë se nuk jemi të denjë sa duhet ndaj qytetarëve tanë, ndaj shqetësimeve serioze, se nuk e ndjejmë sa duhet ankthin e qindra-mijëra familjeve shqiptare që presin me shpresë se kurë dhe si do të kthehen më të dashurit e tyre.

Si pasojë e këtyre sjelljeve të papërgjegjshme, ky problem i mpreht e i ndjeshëm u thellua edhe më shumë qoftë për atë se presioni nuk adresohet në Këshillin e Sigurimit të OKB, në UNMIK, qoftë për atë se ky problem fatkeqësisht u mbeti dhe vazhdon ende t'u mbesë në barrë familjarëve.

Është turp për ne që jemi këtu e sillemi sikur shumë gjëra janë në rregull e mjaftohemi me rezoluta formale, edhe pse e dijmë fort mirë se ne vazhdojmë t'i hutojmë njerëzit tanë – popullin tanë dhe nuk e adresojmë përgjegjësinë sa duhet dhe aty ku duhet. Ky është realiteti i cili pasqyron në njëfarë mënyre edhe mjerimin tonë politik, sjelljen tonë të papërgjegjshme. Mund të them se shumë na kanë duruar njerëzit që edhe pas gjithë këtyre gjërave, pas gjithë këtij mosangazhimi politik na lejojnë që të vijmë të lirshëm këtu në Parlament, në Qeveri, në Presidencë e tjera.

Kthimi i menjëhershëm dhe i pakusht i pengjeve në atdhe është kushti që mund ta vendosim ne në Këshill të Sigurimit në OKB – në UNMIK, ndryshe nuk kemi pse të vazhdojmë bshkëpunimin me UNMIK-un. Kundër bisedimeve me Serbinë për çështje të tilla ne duhet të jemi gjithnjë dhe duhet të jemi po ashtu edhe kundër kthimit në grupe të vogla të pengjeve. Pengjet dihet fare mirë se në ç'rrethana u morën, nga kush u morën, nga kush u vranë apo u masakruan. Dihet fare mirë edhe shkaku i vdekjes së tyre. Dihet fare mirë edhe zhdukja e përkohshme e tyre dhe dërgimi i tyre në Serbi pse u bë. Pra për ta zhdukur krimin dhe për ta fshehur atë. Mirëpo, dihet fare mirë se konstatimi i vdekjes së tyre nga ekspertët mjeko-ligjor serb pse paraqitet dhe përgatitet sikur ata nuk qenkan vrarë e masakruar apo rrëmbyer nga serbët. Por, edhe UNMIK-u pse pajtohet me këto konstatime antihumane dihet fare mirë...

(Ndërprerje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ia kam përmendur emrin, ka të drejtë replike, lëshojani mikrofonin Smajlit. Vazhdo Smajl.

SMAJL LATIFI:

Nuk dëshiroj të replikoj me kryetarin, por është po ashtu e çuditshme se ne ende nuk e ngrisim zërin sa duhet kundër këtyre vrasjeve, krimeve të dyfishta, trefishta që vazhdojnë të bëhen kundër familjeve tona, kundër të gjithë neve. Po pra, ne ende heshtim dhe vetëm heshtim si mumje dhe nuk e adresojmë krimin dhe kriminelët në mënyrë të organizuar dhe institucionale. Ne edhe këtë ua lëmë familjeve që kanë humbur më të dashurit e tyre dhe nuk kujdesemi edhe pas 5-6 vjetëve që të bëjmë qoftë edhe një padi - qoftë edhe për një kriminel - në mënyrë të organizuar dhe institucionale. Ky është turp. Ne asnjë kusht nuk e kemi vendosur për ta zgjidhur këtë çështje, ndërkaq të gjitha kushtet që na imponuan të tjerët po i pranojmë. Ne asnjë hap nuk e hodhëm konkret për ta zgjidhur këtë çështje si edhe të tjerat por pranuan ecjen pas të gjithë të tjerëve. Ne këtë çështje e trajtojmë gabim, nuk e shtrojmë drejt – që është e keqja – edhe kërkojmë që përmes negociatave me Serbinë si të pabarabartë ta zgjidhim dhe harrojmë se ajo – Serbia – njeh dhe pranon vetëm një gjuhë krejtësisht tjetër të komunikimit. Prandaj, duhet të ketë kujdes edhe Qeveria e Kosovës në të ardhmen lidhur me këtë çështje. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Para se ta përfundoj, do t'ju lutja për mirëkuptim. Do ta marrë fjalën edhe profesor Shefki Sejdiu, i fundit dhe mund t'na mësoj për shkak të përvojës dhe besoj se profesori s' do ta zgjasë shumë. Këta tjerët, mos t'ma zënë për të madhe, apo në qoftë se insiston ndokush e ndien nevojë të veçantë, po por mendoj se me këtë duhet ta përmbyllim.

SHEFKI SEJDIU:

Ju falemnderit. Natyrisht se unë do të jam shumë-shumë i shkurtër.

Do të dëshiroja këtu që në çdo nivel të thuhet edhe këto që po i diskutojmë dhe që po kërkojmë janë jo vetëm çështje humanitare, juridike por edhe politike, sepse janë marrë si shqiptarë. Tjetër, pjesa më e madhe e tyre janë marrë jashtë hapësirës dhe kohës kur është bërë luftë. Të theksohen. Tre, që në mesin e të rrëmbyerve ka patur edhe dhunime seksuale e tjera. Këto janë të rëndësishme sidomos për botën e civilizuar jashtë hapësirës ballkanike. Sidomos jashtë hapësirës shqiptare, këto janë shumë të rënda.

Tjetër, edhe një dhe e kreu. Të ketë standarde të barabarta për hulumtimin e të pagjeturve, sepse në Evropë dënohen ashpër vetëm për një tentim dhunimi seksual – ashpër - shumë ashpër, por edhe në Kosovë vetëm për një tentim dhunimi në thojza “dënohen”. Pra, ata që punojnë rreth këtij problemi duhet t'i kenë gjithërë parasysh këto gjëra. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Ne kemi kuorum për çdo vendim, por ju lutem për shkak të mënyrës si është proceduar. Kërkesa në Kryesi dhe në materiale që e keni – është informatë, dhe në rend dite është vendosur si informatë. Nuk mund të themi të nxjerrim deklaratë ose konkluzë sepse ka edhe mendime shtesë të anëtarëve të Komisionit. Prandaj, në qoftë se Komisioni e sheh të arsyeshme që kjo të shndërrohet në një dokument, atëherë mbi bazën e debatit që është zhvilluar dhe vendimeve që ka Komisioni na duhet një tekst unik që është në emër të Komisionit. Me këtë unë mendoj se e kam përkrahjen tuaj, sepse ndryshe nuk mund të procedojmë. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës – është shqyrtimi i vendimit të panelit për Ligjin për shëndetësi.

Ligji për shëndetësi është miratuar në Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 19 shkurt 2004.

Koalicioni “Kthimi” ka parashtruar kundërshtim për të sfiduar disa dispozita të këtij ligji mbi bazën e dyshimit të cenimit të të drejtave dhe interesave të komunitetit.

Në pajtim me rregullat e procedurave, sipas Kornizës kushtetuese dhe Rregullores së punës, paneli i posaçëm ka marrë vendimin me të cilin i rekomandon Kuvendit që të miratojë Ligjin për shëndetësi me ndryshimet sipas tekstit të propozuar.

Vendimi i panelit dhe materialet tjera iu janë shpërndarë me kohë deputetëve.

Sipas kreut 9.1.48 të Kornizës së atëhershme kushtetuese Kuvendi me shumicë votash mund të vendosë:

- Për të miratuar rekomandimin e bërë nga paneli i posaçëm, ose për ta

refuzuar rekomandimin e panelit me ç'rast ligji mbetet ashtu siç është miratuar më parë në Kuvend.

Vetëm një sqarim para deputetëve. Gjithmonë, për hirë të dokumentacionit, para shqyrtimit të çdo ligji komisionet mbi të cilat rëndësi të veçantë ka Komisioni për interesin e komuniteteve – ka vlerësuar profesionalisht që Ligji nuk cenon të drejtat e komuniteteve. Kjo është me rëndësi për hirë të shantazheve që vazhdimisht këto tri vite janë bërë që Kosova të mbetet pa ligje dhe një institucion i caktuar të shpallet në fund siç po ngjanë i pasuksesshëm për diçka. Megjithatë, është interes yni që shëndetësia të funksionojë mbi baza ligjore. Prandaj, lus ata të Komisionit ose të grupeve parlamentare për mendim. E dij që profesor Alushi si mjek dhe Sejda mund të sqarojnë. Urdhëroni profesor.

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar,

Grupi Palamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës qëllimin e panelit e ka kuptuar si institucion apo mekanizëm që - eventualisht nëse është bërë ndonjë gabim jashtëzakonisht i madh që i cenon të drejtat e minoriteteve – ta shqyrtojë një çështje.

Nën dy, Grupi ynë shpreh keqardhjen dhe kundërshtimin për vonesën e shqyrtimit dhe shpalljeve të ligjeve në Kuvend.

Siç e thatë ju, zoti kryetar, Ligji për shëndetësi në Kuvendin e Kosovës është votuar më 19 shkurt. Mendoj se prej 19 shkurtit e deri më 30 korrik është një bllokadë shumë e gjatë që t'na i bëhet një ligji kaq të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Dhe lusim që, ju në komunikim me zyrën e përfaqësuesit special që të gjendeni mënyrë që ligjet që votohen në Kuvendin e Kosovës që shpallja e tyre të mos zgjatë në asnjë rrethanë më tepër se disa javë, por jo më shumë se një muaj.

Ne me shumë kujdes e kemi shqyrtuar rekomandimin e këtij paneli dhe nga 7 rekomandime ne kemi vërejtje në sqarimet lidhur me ato që jipen në pikën 1 dhe 7 dhe konsiderojmë se është mosnjohje totale e realitetit në Kosovë nëse jipet një sqarim çfarë është dhënë këtu, siç ka të bëjë me çështjen e banorit dhe qytetarit të Kosovës, si dhe në pikën e rekomandimit numër 7 ku plotësisht është e pakuptimt kur institucionet ndërkombëtare kanë themeluar Tribunalin e Hagës për krime lufte në këtë territor dhe aktorët e krimeve të luftës në Kosovë janë në Gjykatën e Hagës, sikur është presidenti i Serbisë dhe i ish-jugosllavisë.

Prandaj, rezervat tona qëndrojnë në këto dy rekomandime:

- Grupi ynë konsideron se gjendja në shëndetësinë e Kosovës është jashtëzakonisht e rëndë, është e papranueshme kjo gjendje për Grupin parlamentar të LDK dhe ne jemi shumë të interesuar që Kosova ta ketë ligjin për shëndetësi sa më parë. Ju falemnderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Profesor Sejduallah Hoxha. Urdhëroni.

SEJDULLAH HOXHA:

Të falemnderit kryetar. Ne edhe si Komision parlamentar në të kaluarën kemi qenë mjaft unik ngaqë kemi ditur se aprovimi i ligjit për shëndetësi është me rëndësi të posaçme nacionale dhe kombëtare dhe jemi përpjekur që ta prezentojmë një ligj sa më kualitativ.

Natyrisht, këtë të drejtë nuk e ka shfrytëzuar edhe koalicioni “Kthimi” i cili që nga fillimi i punës së Komisionit nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje të Komisionit dhe me vërejtjet dhe sygjerimet e veta të participojë në punën e Komisionit dhe të shprehë qëndrimet dhe dëshirat e tyre.

Përkundrejt asaj se kjo nuk është e drejtë, nuk është obligim yni që ne të japim vlerësime tona lidhur me vendimin e panelit, ne në vazhdimsi jemi mbledh disa herë si Komision gjatë këtyre ditëve dhe përkundrejt asaj se nuk pajtohemi me vlerësimet e panelit nga se, si e thatë edhe ju kryetar, nuk shkelen interesat vitale të komunitetit në asnjë paragraf, në asnjë pikë, në asnjë presje – megjithatë me qëllim që Kosova ta ketë një ligj për shkak të gjendjes ashtu siç është në shëndetësi, ne i propozojmë deputetëve, i propozojmë edhe Parlamentit që përkundrejt asaj se vendimet e panelit nuk qëndrojnë – ky ligj të aprovohet nga se në esencë asgjë nuk humb nga vlera e tij.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë do të thoja debat nuk kemi hapur. Ju lutem, vetëm po zgjatet lista. Dy grupet më të mëdha parlamentare dhe kisha dashur mendimin edhe të Aleancës. Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI.

Falemnderit kryetar. Më lejoni që fillimisht të shfaq keqardhjen tonë që përfaqësuesi special po i bllokoi ligjet kaq gjatë. Së dyti, të shfaq keqardhjen që zyrat ligjore të përfaqësuesit special po veprojnë në kundërshtim me Kornizën kushtetuese duke krijuar panele të posaçme në çdo kundërshtim të Koalicionit “Kthimi” dhe e cila është në fakt në kundërshtim me Kornizën kushtetuese.

Sa i përket panelit për Ligjin për shëndetësi, ne nuk përkrahim vendimin numër 1 të këtij paneli; ne nuk jemi banor të Kosovës – ne jemi popull i Kosovës, jemi qytetarë të Kosovës dhe nuk mund të mos them e të mos kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të rishikojë nënshkrimin e përfaqësuesit të saj, nuk është herë e parë që po ndodh kështu, është hera e dytë, të shikojë që nënshkrimi i Qeverisë si sponsorues i ligjit të mos vëhet kudo.

Po ashtu, pikën 7 nuk e pranojmë. Ne sygjerojmë që vendimet e panelit të votohen një nga një dhe atëherë do të votojmë për pikën 2, 3, 4, 5, 6. Nëse qitet të votohet në tërësi ne do të votojmë kundër. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edhe zoti Gani Sadik, në emër të Grupit tjetër parlamentar dhe fund.

GANI SADIK:

Të Falemnderit zoti kryetar. Unë prita Sadudini t'i thotë disa fjalë në emër të komuniteteve pasi është nënkryetar. Unë kisha pas dëshirë ti me folë. A kam leje të flas unë? Ju lutem, ne mbledhje kemi mbajt. Në atë mbledhje kemi qenë 10 vetë. 9 jemi kanë për dhe një kundër. Domethënë interesat e komuniteteve nuk i cenon ky ligj dhe ne mbetemi ashtu siç e kemi votuar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Unë ju ftoj që me vërejtjet e shprehura në 1-shin dhe 7-shin ta aprovojme atë që është e mundshme dhe të shpallet ligji.

Kush është për, ju lutem? Ju falemnderit shumë.
A ka votë kundër? Numëroni mirë, ju lutem votat. Katër vota kundër.
A ka abstenime? Janë 3 abstenime. Ju falemnderit.

Kalojmë në pikë tjetër të rendit të ditës. Nuk po dua t'ua mohoj të drejtën. Ju lutem, grupet parlamentare me seriozitet e kanë shqyrtuar këtë çështje që është e ndieshme për interesin e shëndetësisë së Kosovës dhe kalojmë në pyetjen tjetër.

Shqyrtimi i vendimit të panelit për Ligjin kundër diskriminimit.

Konstatime hyrëse. Ligji kundër diskriminimit është miratuar në Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 19 shkurt 2004.

Koalicioni "Kthimi" ka parashtruar kundërshtimin për të sfiduar disa dispozita të këtij ligji mbi bazën e dyshimit të cenimit të të drejtave dhe interesave të komunitetit.

Në pajtim me rregullat e procedurave, sipas Kornizës së atëhershme kushtetuese dhe Rregullores së punës, paneli i posaçëm ka marrë vendim me të cilin i rekomandon Kuvendit që të miratojë Ligjin kundër diskriminimit me ndryshimet sipas tekstit të propozuar.

Vendimi i panelit dhe materialet tjera iu janë shpërndarë me kohë deputetëve, për të miratuar rekomandimet e bëra nga paneli i posaçëm ose për të refuzuar rekomandimet e panelit, me ç'rast ligji mbetet ashtu siç është miratuar.

Dëshiroj mendimin e grupeve parlamentare. Urdhëroni. E ka fjalën profesor Gashi.

ALUSH GASHI:

I nderuari zoti kryetar,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka marrë pjesë në inicimin e hartimit të këtij ligji, e ka mbështetur në të gjitha fazat dhe rekomandimet e panelit lidhur me këtë çështje për ne janë të pranueshme.

Vërejtja e Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me panel dhe me shpalljen e këtij ligji është se ky ligj, kaq i rëndësishëm për proceset tona, vonohet kaq gjatë në zyrën e përfaqësuesit special, prandaj kërkesa jonë e fuqishme është, zoti kryetar, që ju të arrini një marrëveshje me zyrën e përfaqësuesit special që ligjet tona mos të vonohen më tepër se një muaj. Ju e keni votën tonë. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Në emër të PDK, zoti Hydajet Hyseni. Urdhëroni Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, zonja e zotrinj deputetë,

Mua m'u kërkua që të kërkohet që deputetëve t'u jipet fjala, por s'kisha si të kërkohet kur mua nuk m'u dha fjala edhe pse si anëtar i Kryesisë e kisha të drejtën për ta marrë fjalën edhe në rastin e parë.

Më lejoni ta shfrytëzoj rastin që t'i shkrij këto cilësi...

(Reagim – pa kyçje të mikrofonit)

Po, por megjithatë do t'më lejosh që të vazhdoj. Prandaj më lejoni që t'i shkrij këto cilësi dhe t'i referohem të dy paneleve.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet, fjalën e keni në emër të Grupit Parlamentar, për panelin e parë tjetërkush ka folë, mos e keqpërdor foltoren, të lutem. Urdhëroni.

HYDAJET HYSENI:

Unë do të dëshiroja shumë që ky Kuvend të ishte në gjendje që të përkrahë panele kur janë të drejta dhe janë në interes vërtetë të të drejtave të komuniteteve. Edhe unë kam besim se kemi pjekurinë dhe përgjegjësinë që ta bëjmë këtë. Për fat të keq, nuk po na jipet mundësia. Kjo puna e ligjeve me panele e ç'panele është bërë si ura e shejt: ndreq e prish – prish e ndreq.

Ne sot e miratuar Ligjin për mbrojtjen e qytetarëve, pikërisht në aspektin shëndetësor në mëngjes, kurse sot tash na vjen me sygjerim që të miratohet ndryshimi dhe heqja gjithkund – vëni re – gjithkund e shprehjes “qytetar”. Arsyetimi është banal. Po e marr vetëm si ilustrim.

E njëjta gjë ndodh edhe me Projektligjin ose me Ligjin kundër diskriminimit. Është e qartë – jo të gjithë duan që ne të ndërtojmë vërtetë ura. Prandaj, nuk ka pjesëmarrje në hartimin e ligjeve, nuk ka pjesëmarrje në shqyrtim, nuk ka asnjë përpjekje për të harmonizuar qëndrimet me rastin e amendamentimit, as në komisione, as në Kryesi dhe as në procedurën e mëtejshme.

Ka një përpjekje për t'i injoruar të gjitha këto dhe për t'u turrur drejt e te paneli, si një çelës magjik që bën çudira, për t'i thirrur pastaj disa të tjerë sipas asaj hajde drejt e na ndreq. Prandaj edhe ndodhë që paneli ta konsiderojë veten si ulen dy-tre vetë dikund dhe ndajnë fetfa. Kuvendi pastaj duhet t'i rregullojë ato, përndryshe shantazhohen, nuk promovohen ligjet, nuk shpallen ligjet.

Dhe, çka propozohet? Çka hiqet? Në shqyrtimin e mëparshëm u dhanë dy shembuj eklatant - hiqet shprehja “qytetar”. Dhe unë do të dëshiroja që të dij qëndrimin, ta zëmë të përfaqësuesit ndërkombëtar – a ndodh në vendin e tij që të hapet debati për të hequr fjalën “qytetar” ose fjalën “nacional” ose siç është në këtë ligjin kundër diskriminimit që në të vërtetë asnjë kërkesë nuk ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve. Është politikë dhe puropolitikë dhe politikë e keqe. Lexoni ju lutem vetëm përfundimin e kërkesave të Grupit “Povratka”.

Përmenden atje “lugeter”, “fantazma” dhe i referohen historisë së një populli shumicë. Përmendet Serbia e Mali i zi si kontura e vetme për zgjidhjen e çështjeve të tjera, dhe kjo nuk qenka cenim i të drejtave të shumicës së tjera. Çka do të ndodhte nëse ne do të nisnim tani për të kontestuar panelin nga ky aspekt i cenimit të të drejtave të njeriut, ose të drejtave të komuniteteve të tjera. Dhe, merrneni me mend – e bën këtë ata që thirren në shëndetësinë, të cilëve u pengouka a është qytetar apo është banor, por jo a është pacient. U pengouka a është edhe familje e dëshmorëve, sepse si mjek që janë ata nuk mund të mirren me çështje të tilla. Merrneni me mend ku mbetet këtu betimi i Hipokratit, e të tjera.

Për të mos u zgjatur më shumë, zonja e zotrinj më lejoni vetëm të theksoj një fakt, duke kërkuar falje që ndoshta po i shtrijë të dyjat. Në dokumentin e Rambujesë fjala e parë është qytetarët e Kosovës e të tjera e të tjera. Edhe vetë satrapi Millosheviq përmendte shprehjen qytetar të Kosovës. Kush po dëshiron të shkojë përtej atyre dhe këtë ta bëjë në emër të gjoja të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. Po diskreditohet në këtë mënyrë edhe paneli, edhe ata që qëndrojnë pas panelit e të tjera. Prandaj, ne po vëhemi në një situatë të pamundshme. E njëjta gjë ndodh me diskriminimin. Më lejoni vetëm një ilustrim. Ky ligj ka një mangësi, për mendimin tim, thelbësore. Gjithkund ku është në shqip e anglisht, është fjala “trajtim”, në serbisht është “postupanje” – “postupanje” e vendos në pozitë të përmbysur të gjithë komunitetin sepse është fjala për komunitetin. Mirëpo, as kontestuesit, as paneli nuk është fokusuar në çështje të tilla për të korrigjuar, sepse vërtetë është difekt, por është ndalur në çështje që janë politike po po u cenojkan të drejtat e përfaqësuesit special, pse qenka një autoritet të cilit po u deshka t’i bëhen ankesa dhe u pengouka dikujt pse paska një autoritet ku do të bëhen ankesa nëse ka shkelje të të drejtave të komuniteteve e tjera.

Kjo, zonja e zotërinj dhe më lejoni ta përfundoj me këtë, ta kujton atë anekdotën sipas së cilës atij që i kishin humbur qetë kishte dalur për t’i lypur dhe kur i thanë eja se kanë ardhur qetë në shtëpi u përgjigjej: e di, e di po do të rri të vazhdoj t’i lypj gjithë natën e gjithë ditën sesa të lavroj nesër. S’duan të lavrojnë disa. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet, të falemnderit. Nuk ka më tepër se me thënë që plotësisht i ke me të drejtë kur ti diskuton gjithmonë për panelet. Duhet ta përjashtoj vetëm atë për Rambuje që përmendet një emër dhe këtë të fundit këtu tash, por unë po mundohem me ruajt unitetin e Parlamentit. Në emër të Grupit Parlamentar del deputeti që është profesionist për këtë dhe ju tentoni me çdo kusht të dilni me mendim tjetër. Vota kundër është shprehje e individualitetit. Unë po ju kërkoj falje, nuk është çështje që dikujt t’i cenohet e drejta. Megjithatë, grupet parlamentare marrin vendime dhe ato e marrin përgjegjësinë për funksionimin e jetës në Kosovë. Në emër të Aleancës, Bajram ti e ke fjalën. Ti e kërkon fjalën. Hydajet, kërkon replikë! Pse po unë s’thash kurgjë të keqe. Kyçjani Hydajetit mikrofonin për shkak të replikës, ju lutem.

HYDAJET HYSENI:

Unë e falënderoj kryetarin që s’ka thënë asgjë të keqe kundër meje, nuk e thotë kurrë, por as unë s’e kam ndërmend të them asgjë të keqe për kryetarin, as s’e kam ndërmend madje të konfrontohem, por dua vetëm të sqaroj: fjalën e kam kërkuar në cilësinë e anëtarit të Kryesisë. Fjalën e kam kërkuar edhe në cilësinë e deputetit dhe kam të drejtë ta bëj këtë në të dyjat. Në rastin e dytë, u morëm vesh që ta marr fjalën edhe në cilësinë e përfaqësuesit të Grupit, prandaj tri herë kam të drejtë. Mendoj se vetëm duhet kjo të kihet parasysh. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. E ka fjalën zoti Kosumi, pastaj Hasan Meta.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuari kryetar,
Grupi i Aleancës përkrah vendimin e panelit dhe ne do ta votojmë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Dhe i fundit Hasan Meta. Smajl parzit e morët fjalën.

HASAN META:

Zoti kryetar, falemnderit. Unë realisht pajtohem me mendimet e përparshme që nëse ka arsye të përmirësohet ligji paneli të krijohet dhe ne nuk jemi kundër asaj nëse është bërë ndonjë gabim diku. Por, dua të them diçka tjetër. Nëse në muajin shkurt janë aprovuar ligjet dhe përfaqësuesi special nuk i nënshkruan ligjet për disa muaj, sidomos kur janë të një rëndësie të posaçme siç ishte ai i shëndetësisë, do të thotë se UNMIK-u nuk është këtu për konsolidim të gjendjes në Kosovë por është për një keqësim të gjendjes në Kosovë, për fat të keq.

Në anën tjetër, nëse bazohemi gjithnjë në panelet e “Kthimit” i cili e saboton Kuvendin që 6 muaj dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk don të japë kontributin e vet për konsolidimin e gjendjes në Kosovë dhe të jenë qytetarë të Kosovës por ndoshta duan të janë diçka tjetër, dhe me siguri duan, unë besoj se është një neglizhencë e paraqitur nga institucionet e Kosovës dhe lus Qeverinë që të ketë kujdes për njerëzit që i punësojnë në këto institucione – mos janë edhe ata të Serbisë apo të “Kthimit”. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Ju lutem, kush është për propozimin e të tre grupeve parlamentare, për aprovim të panelit me vërejtjet substanciale që janë shprehur me këtë rast. Ju falemnderit.

A ka ndonjë votë kundër? Janë 5 vota kundër.

A ka abstenime? 1 abstenim. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – ForShumica – Vecina - Majority

Kundër – Protiv – Against..... 05

Abstenim – Uzdržano – Abstained..... 01

Dhe, unë do t'ju falënderoja për ndihmën dhe kontributin shumë të madh që kemi dhënë bashkërisht për këto vite. Shihemi menjëherë në fillim të shtatorit, besoj me 1 shtator. Ju dëshiroj pushim të këndshëm që e keni merituar.

Seanca përfundoi punën në orën 13,05.

E transkriptoi RT-fq.1-145, Zyra E04,tel.038-211-860, rtullari@hotmail.com